

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

---

**Çështje të sigurisë - 14**



# ÇËSHTJE TË SIGURISË

## *Security Issues*

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Nr. 14, dhjetor 2009

**Bordi botues:****Kryetar**

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim

**Anëtarë**

Dr. Arshi Çela

Dr. Arjan Starova

Arjan Dyrmishi

Ambasador Pëllumb Qazimi (Gjen. R)

**Konsulentë**

Geron Kamberi – M.A. në Studime Europiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

**Redaktor përgjegjës**

Mariola Qesaraku – M.A. në Studime

Bashkëkohore Europiane

**Ndihmoi në përgatitje**

Ermela Hoxha

Elira Hroni

Jerina Xhaferri

Alban Lauka

Orhan Ceka

---

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare të  
**Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** në Bruksel  
dhe **Fondacionit Friedrich Ebert**, Tiranë

## PËRMBAJTJA

<b>Enri Hide</b>	
Terrorizmi ndërkombëtar dhe siguria europiane .....	7
<b>Barry J. Ryan</b>	
Zhvillimi i axhendës së sigurisë së BE-së: Sigurimi i Shqipërisë dhe i Malit të Zi .....	30
<b>Ilir Kalemaj</b>	
Ligjërata e BE-së në politikën elektorale: Kërcënimi i perceptuar i krimit të organizuar shqiptar dhe europianizimi i elitës shqiptare .....	61
<b>Florina Cristiana (Cris) Matei</b>	
Lufta ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar: Qasje të përbashkëta të Europës Juglindore .....	84
<b>Michael Healey</b>	
“Njeriu ushtarak”, shoqëria dhe teoria e marrëdhënieve civilo-ushtarake: Një përmbledhje teorike .....	111
<b>Jonida Hoxha</b>	
Krimi i organizuar në Ballkan si një kërcënim serioz i sigurisë në Bashkimin Europian .....	122
<b>Eduart Bala</b>	
Reformimi dhe kontrolli i shërbimeve të inteligjencës në demokracitë e reja .....	136
<b>English summary</b> .....	177



ENRI HIDE

## TERRORIZMI NDËRKOMBËTAR DHE SIGURIA EUROPIANE

Terrorizmi nuk përbën një fenomen të ri dhe sidomos vendet europiane nuk janë të pavetëdijshme për aktivitetin terrorist. Për të mos shkuar larg në kohë, mjafton të përmendim se ato kanë qenë strehë e një sërë organizatash terroriste të brendshme në të kaluarën. Por terrorizmi i “ekstremitetit të majtë”, që shkaktonte dhimbje koke të vazhdueshme për kancelaritë politike dhe diplomatike të shteteve të Europës Perëndimore gjatë viteve ’70-’80, nuk ka shfaqur shenja ringjalljeje, përveç disa organizatave terroriste të majta në Greqinë e muajve të fundit, dhuna e të cilave u rishfaq në skenën politike pas trazirave të thuajse një viti më parë në kryeqytetin e vendit. Kjo do të thotë që kjo kategori dhune thuajse është neutralizuar. Nga ana tjetër në Europë gjatë shekullit të njëzetë (sidomos pas Luftës së Dytë Botërore) janë shfaqur edhe forma dhune të konsideruara (nga shtetet përkatëse) terroriste të ushtruara nga grupime separatiste ose nacionalçlirimtare, si baskët në Spanjë dhe IRA (Ushtria Republikane Irlandeze).

Megjithatë, sulmet terroriste në Madrid (11 mars 2004) dhe në Londër (më 7 korrik 2005) kanë nxjerrë në pah një kërcënim me natyrë sa të vjetër aq dhe të re dhe me kapacitete goditëse në çdo cep të globit, duke i çuar çështjet europiane të sigurisë drejt monopateve të reja. Strukturat institucionale europiane e kanë pranuar faktin e ndërkombëtarizimit të dhunës terroriste, prandaj ato kanë forcuar koordinimin mes tyre. Por, duke qenë se mjedisi i sigurisë nuk mund të përcaktohet qartësisht, “*armiku*” mbetet një fenomen abstrakt që përfshin ndonjëherë edhe refugjatët ekonomikë që shkelin tokën europiane (ose të paktën këtë pretendojnë forca dhe struktura të caktuara të sigurisë).

Bota (sidomos ajo perëndimore) sapo kaloi përpara pak ditësh një tjetër përvjetor të sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001, por shoku i paprecedentë i tyre ka kontribuar dhe vazhdon të kontribuojë në rritjen e ndërgjegjësimit mbi kërcënimin që përbën terrorizmi. Ajo datë shënoi fillimin e një etape që do të shndërrohej në një betejë afatgjatë<sup>1</sup> kundër terrorizmit sepse provoi se terrorizmi përdoret edhe si “taktikë” dhe nuk i drejtohet një armiku specifik, por të gjithëve. Në të njëjtën kohë terrorizmi ka treguar që politikant antiterror janë të tejkaluara e të pamjaftueshme për të parandaluar rreziqe ekzistuese ose potenciale, duke shkaktuar debate të gjera mbi çështjet e sigurisë kombëtare. Detyra e parandalimit të një sulmi është jashtëzakonisht e vështirë dhe për t’ia dalë mbanë kërkon një tërësi elementesh.

Për të përshkruar mjedisin ndërkombëtar shpeshherë përdorim terma si: i pasigurt, i paqartë, dinamik, i paqëndrueshëm, i paparashikueshëm, i panjohur, i trazuar, asimetrik dhe/ose kompleks.<sup>2</sup> Për të kuptuar kërcënimet dhe sfidat e reja që vijnë nga brezi i ri i terroristëve kërkohet një “*mentalitet i ri*” - një mënyrë e re të menduari. Por, megjithëse një shumësi aktorësh ndërkombëtarë që formulojnë, artikulojnë, hartojnë ose implementojnë politika antiterror e kuptojnë këtë analogji, ata vazhdojnë të ecin nëpër shtigje që jo gjithnjë garantojnë mbrojtje nga kërcënimet terroriste të shfaqura rishtazi.

Fenomeni i terrorizmit ka treguar historikisht një kapacitet dhe aftësi të admirueshme për t’u riformësuar dhe rishfaqur aty ku pritet më pak dhe kur pritet më pak.<sup>3</sup> Vështirë se mund të vlerësohet e të matet empirikisht gama e formave të

<sup>1</sup> Literatura në anglisht përdor thujse gjithnjë termin “*struggle*” [betejë] për ta diferencuar atë prej termit “*war*” [luftë], sepse kjo e fundit mbart një kuptim shumë më të thellë për marrëdhëniet ndërkombëtare në përgjithësi dhe për studimet e sigurisë në veçanti.

<sup>2</sup> Shih Kathleen Mahoney, “*Huntington Revisited: Is Conservative Realism still Essential for the Military Ethic?*”, Ese të vitit 2001, National Defense University Press, Uashington, f. 45.

<sup>3</sup> Shih një nga tekstet më klasike të debatit në lidhje me raportin që ka krijuar terrorizmi me demokracinë, në Paul Wilkinson, “*Terrorism versus Democracy, The Liberal State Response*”, Frank Cass, Londër 2002.



ndryshme që merr ky fenomen dhe larmia e pasojave që shkakton. Terrorizmi mund të përshkruhet si “një mënyrë e veçantë dhune”, duke lejuar kësisoj qasje të ndryshme përkufizimi sipas llojit dhe vendit të shfaqjes dhe aktivitetit të tij.<sup>4</sup> Fakti që terrorizmi është një fenomen i pakuptueshëm e bën mjaft të vështirë - thuajse të pamundur - gjetjen e një përkufizimi të pranuar nga të gjithë anëtarët e komunitetit ndërkombëtar. Megjithatë duhet përmendur se pak terma në ligjërimin politik bashkëkohor kanë rezultuar kaq të vështirë për t’u përkufizuar sa terrorizmi. Për më tepër, terrorizmi bashkëkohor përfshin një gamë aktorësh joshtetërorë që lidhin cilësitë/aftësitë e organizimit në rrjet me një numër organizatash. Këto entitete transnacionale përbëjnë kërcënime sigurie jo vetëm për shtetet-kombe por edhe për sigurinë kolektive globale. Brenda këtij koncepti çështja e sigurisë merr vlerë dominuese karshi të drejtave të njeriut ndërsa mbetet një koncept subjektiv që nuk përkufizohet lehtësisht dhe universalisht nga të gjithë.

Pjesa e fundit e shekullit të njëzetë dëshmoi ndryshimin gradual të dhunës politike dhe të sjelljes, qëllimeve, tendencave, synimeve e orientimit politik të terrorizmit. Shfaqja e terroristëve që i përkasin një besimi të caktuar fetar ose të terroristëve që e përdorin besimin fetar si mjet për të justifikuar veprimet e tyre parashtruan koncepte dhe qasje të reja. Vitet e fundit janë shfaqur një sërë iniciativash kundër përdorimit të fesë si justifikim për akte dhune. Brenda këtyre qasjeve të reja radhiten edhe Konferencat e Kongreset Ndërkombëtare midis liderëve fetarë që shpallin botërisht besimin dhe bindjen e tyre ndaj paqes e tolerancës për të bindur besimtarët e tyre t’u shmangen akteve të dhunshme e të distancohen prej tyre.

Shembuj të këtyre iniciativave janë:

- Në Sevillje të Spanjës, Rabini i Parë i Izraelit, *Yona Metzger*, duke iu drejtuar me një fjalim Kongresit Ndërkombëtar të Imamëve dhe Rabinëve për Paqe, bëri thirrje për krijimin

---

<sup>4</sup> Shih Paul Wilkinson, “*International terrorism: the changing threat and the EU’s response*”, Institute for Security Studies, Chaillot Papers, Nr. 84, Tetor 2005, f. 9.

e një trupe botërore me përfaqësues nga grupe të mëdha fetare. Ai bëri thirrje për formimin e “Kombeve të Bashkuara të besimeve dhe grupeve fetare”<sup>5</sup> [...] “Liderët fetarë shfaqën shumë bindje të përbashkëta se ata mund të jenë në gjendje të arrijnë marrëveshje aty ku diplomatët kanë dështuar”<sup>6</sup>.

- Në një prej konferencave të viteve të fundit të Patriarkatit Ekumenik, Deklarata përmendte se: “Ne ndjejmë keqardhje për ata që predikojnë dhunën ndaj besimeve të tjera fetare dhe ndaj komuniteteve të tjera etnike. Besojmë në shenjtërinë e jetës njerëzore dhe i kundërvihemi me forcë atyre që dhunojnë dhe shpërfillin vlerat njerëzore themeltare. Nuk pranojmë asnjë veprim që dëmton parimet bazë të besimeve tona përmes interpretimit të gënjeshtërt dhe nacionalizmit të verbër. Dhe së fundi nuk mund të pranojmë në asnjë mënyrë që një veprim i dhunshëm në një konflikt të armatosur t’i atribuohet vullnetit të Zotit. Justifikime të tilla nuk do të çojnë kurrsesi drejt paqes. Kërkojmë themelimin e rendit ligjor që të respektojë të drejtat thelbësore njerëzore në të gjitha vendet ... dhe mbrojtjen aktive të minoriteteve...”<sup>7</sup>
- Edhe Papa Benedikti i 16-të, pas zgjedhjes së tij në prill 2005 bëri thirrje për dialog midis feve.<sup>8</sup>
- Në një takim të sponsorizuar nga presidenca austriake e Bashkimit Europian, më shumë sesa 130 liderë fetarë nga i gjithë kontinenti ranë dakord se teologët islamikë në Europë duhet të bëjnë më shumë për të qartësuar se feja e tyre nuk bie ndesh me vlerat perëndimore. Deklarata e myslimanëve dhe imamëve europianë u kërkoi qeverive europiane të promovonin programe pune për komunitetin e tyre mysliman për t’i integruar në shoqëri.<sup>9</sup> “Kjo konferencë imamësh europianë synonte të forconte zërat e moderuar që mbeten ndonjëherë jashtë debateve mbi myslimanët nga

<sup>5</sup> Shih rubrikat informative të kanalit BBC, 20 Mars 2006.

<sup>6</sup> Shih Renwick McLean, “Imams in Spain Say Muslims and Jews Must Confront Extremism”, The New York Times, 26 March 2006.

<sup>7</sup> “Declaration, Peace and Tolerance II”, Konferencë Ndërkombëtare e financuar nga Patriarkati Ekumenik dhe Fondacioni “Thirrja e Ndërgjegjes”, 7-9 Nëntor 2005, Stamboll, Turqi.

<sup>8</sup> Shërbimi Katolik i Lajmeve, 23 Mars 2006.

<sup>9</sup> Shih Associated Press, Vjenë, 10 Prill 2006.

predikuesit radikalë antiperëndimorë shkrimet e predikimet e të cilëve në internet frymëzojnë grupe të vegjël ekstremistësh myslimanë në Europë”. Deklarata e Konferencës u bënte thirrje teologëve myslimanë të tregonin se si u përshtatej Islami vlerave perëndimore. *“Myslimanët mund të integrohen dhe të marrin pjesë aktive në shoqëritë europiane: ky mbetet qëllimi ynë. Pikërisht këtu identifikohet rreziku kryesor. Europa mbetet pika jonë e referencës, megjithëse jemi myslimanë”*.<sup>10</sup>

Ndonëse deklaratat e liderëve fetarë kanë shtrirje universale dhe ushtrojnë influencë universale, komunikimi i tyre humbet në mungesë të besimtarëve që kanë vullnetin të dëgjojnë. Megjithatë, iniciativat e sipërpërmendura kanë rëndësi jetike për besimtarët, sidomos për myslimanët që jetojnë në Europë. Pjesë e rritjes së shqetësimeve për integrimin e tyre i përket liderëve fetarë që kanë rol thelbësor. Kështu për shembull, në Danimarkë karikaturat që skicojnë Profetin Muhamed shkaktuan turbullira masive në vendet myslimane që i konsideruan ato sakrilegj të besimit të tyre.<sup>11</sup> Rasti në fjalë tregoi padijen jashtëzakonisht të madhe të të dyja palëve (Perëndimit dhe Islamit), çka shkaktoi trazira dhe shumë probleme ndërkombëtare që mund të mos zgjidhen me lehtësi në të ardhmen.<sup>12</sup>

Një prej problemeve më serioze që kanë lidhje me fenomenin e terrorizmit në Europë ka të bëjë me sigurizimin e tij përmes akteve të ligjërimit politik të elitës politike dhe asaj intelektuale europiane, duke e shndërruar atë nga një problem me të cilin dikur përballeshin teknicienët e burokratët e degëve përkatëse të ekzekutivit, legjislativit apo gjyqësorit, në çështje kyçe të sigurisë së jetës së qytetarëve europianë. Madje procesi i sigurizimit të këtij fenomeni lidhet ngushtësisht me sigurizimin e migracionit dhe lidhjen e tij,

---

<sup>10</sup> Shih Heneghan Tom, “*Imams vow to preach values of Islam*”, The Washington Post, 10 prill 2006. Gjithashtu shih Murphy Brian, “*European Muslims see social, political integration*”, Associated Press, 8 Prill 2006.

<sup>11</sup> Shih gazetat evropiane të periudhës shkurt-maj 2006.

<sup>12</sup> Ministrat e Punëve të Jashtme të Libanit, Italisë, Libisë dhe Suedisë janë dorëhequr ose larguar nga posti i tyre si pasojë e menaxhimit të keq të çështjes së karikaturave të Profetit. Shih Associated Press, 22 mars 2006.

sidomos kur buron nga rajone si Lindja e Mesme në veçanti dhe Afrika më në përgjithësi, me ushtrimin e dhunës ekstreme terroriste dhe futjen e tij në Europë përmes emigrantëve - por kjo e fundit nuk rezulton aspak e vërtetë, siç dëshmojnë rastet e sulmeve terroriste në Spanjë (Madrid) dhe Britani (Londër), çka nxjerr në pah përdorimin e tij në formë dukshëm propagandistike nga elitat duke mos e orientuar vëmendjen e opinionit publik në drejtimin real të problematikës së rrënjëve dhe arsyeve të fenomenit të terrorizmit.

## Konteksti i terrorizmit europian

Brenda Bashkimit Europian kanë ekzistuar (ose vazhdojnë të ekzistojnë) grupe të ndryshme separatiste që kanë përdorur hera-herës (ose që vazhdojnë ende të përdorin) dhunë terroriste, duke sjellë probleme të shumta por të përbrendësuar me natyrë sigurie. Në rajonet Baske të Spanjës dhe Francës, si dhe në ato të Irlandës së Veriut veprojnë organizata separatiste që kanë përdorur shpeshherë dhunë në shkallë të gjerë. Terrorizmi “i ekstremit të majtë” që gjatë viteve ’70-’80 përbënte një shqetësim mjaft serioz nuk ka shfaqur ndonjë simptomë thelbësore ringjalljeje. Duke marrë parasysh çrrënjosjen e organizatave të fundit terroriste në Greqi, kjo kategori dhune thuajse është neutralizuar. Megjithatë edhe pse aktiviteti i brendshëm terrorist rishfaqet hera-herës, mungesa e një ombrelle ideologjike koherente nuk i pajis këto grupe me themelet e duhura mbi të cilat të lulëzojnë dhe rriten. Në të njëjtën kohë mungesa e një ombrelle ideologjike me koherencën e të kaluarës bën që grupi që ato kanë përcaktuar si objektiv për të sulmuar të jetë më gjithëpërfshirës dhe më pak i qartë. Pikërisht këto elementë të fundit i bëjnë këto grupe më të rrezikshëm sesa paraardhësit e tyre. Shembuj të aktiviteteve të fundit të kësaj sjelljeje specifike janë regjistruar në Greqi dhe në Itali, ku janë realizuar sulme të ndryshme terroriste.<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup> Shih Raportin Vjetor të Europol-it, 2005: (File no. 1423 – 39r2 # 166073) Hagë, 22 mars 2006, ff. 13-14.

*Modus operandi* i këtyre organizatave përfshin këto lloje veprimesh: shpërthime që shkaktojnë dëme të vogla, bomba dhe sulme vdekjeprurëse me objektiv të mirëpërcaktuar. Karakteristikat e llojit të ri të grupeve (apo organizatave) terroriste mund të përmbliidhen si vijon:

- nuk marrin gjithnjë përgjegjësinë për sulmet e tyre
- nuk ka gjithmonë një motiv të qartë pas sulmeve
- objektivat mbeten brenda një grupit të njohur objektivash që përfshijnë forcat policore, infrastrukturën qeveritare, bankat etj.
- përdorin armë dhe eksplozivë që gjenden me lehtësi në tregun e zi.

Fakti se midis forcave europiane të sigurisë është rritur shkalla e urgjencës dhe gatishmërisë ndaj këtij fenomeni të ri, kurse agjencitë europiane të sigurisë kanë zhvilluar bashkëpunimin mes tyre, tregon se grupet e reja të terrorit kanë shumë pengesa për të mbijetuar në planin afatgjatë. Gjithsesi, në ndonjë moment në të ardhmen globalizmi dhe zhvillimet politike do të sigurojnë padyshim kuadrin për rishfaqjen e ripërtërirë të terrorizmit të vjetër ose shfaqjen e ndonjë forme të re terrorizmi, si ka ndodhur gjithnjë në histori. Ky pohim (që disa mund ta konsideronin të guximshëm...) përforcohet edhe nga fakti se dhuna historike në Europë ka treguar një jetëgjatësi apo qëndrueshmëri të admirueshme.

## Politika antiterror e Bashkimit Europian

*“Më 21 shtator 2001 Bashkimi Europian përshpejtoi zhvillimin dhe implementimin e masave të përgatitura përpara ngjarjeve të 11 shtatorit”*.<sup>14</sup> Komisioni Europian miratoi një sërë dokumentesh që paraqesin masat e reja për luftën kundër terrorizmit. Midis tyre mund të përmendim: forcimin e bashkëpunimit policor dhe juridik; zhvillimin e instrumenteve ligjore ndërkombëtare; ndërprerjen e të gjitha formave të financimit të terrorizmit;

---

<sup>14</sup> Shih Doron Zimmermann, ‘The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal’, *Studies in Conflict and Terrorism*, vëll. 29, nr. 2, mars 2006, f. 123.

forcimin e sigurisë ajrore; koordinimin e veprimit global të Bashkimit Europian (ku edhe Këshilli Europian afirmoi dhe një herë “vendosmërinë e tij për të vepruar në harmoni me njëritjetrin në të gjitha rrethanat”, duke shtuar “solidaritetin dhe bashkëpunimin e tij me Shtetet e Bashkuara”).<sup>15</sup>

U miratuan gjithashtu një sërë iniciativash të rëndësishme ligjore ku përfshihen:

- Një vendim kuadër mbi Urdhërarrestin Europian,
- Vendimi për implementimin e masave specifike për bashkëpunim policor e juridik për të luftuar terrorizmin,
- Vendimi kuadër për krijimin e Grupeve të Përbashkëta Hetimore,
- Vendimi që themeloi Eurojust-in,
- Vendimi kuadër për luftën kundër terrorizmit,
- Qëndrimi i përbashkët mbi aplikimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin,
- Vendimet dhe rregullat kuadër mbi pastrimin e parave, identifikimin, gjurmimin, ngrirjen dhe konfiskimin e mjeteve dhe të ardhura të krimit.<sup>16</sup>

Njohja e faktit se terrorizmi i ri është forcuar - dhe është kësaj në gjendje të rrezikojë themelet e paqes botërore - ka rritur koordinimin e mëtejshëm midis trupave legislative europiane. “Pas goditjeve terroriste në Londër dhe sidomos në Madrid, Këshilli Europian ra dakord mbi një grup objektivash strategjike që kanë orientuar që prej atij momenti luftën e Bashkimit Europian kundër terrorizmit. Kryefjala e këtyre objektivave strategjike është parandalimi, gatishmëria dhe reagimi ndaj sulmeve. Këto arrihen përmes: reduktimit të aksesit të terroristëve në resurse ekonomike dhe financiare; maksimalizimit të kapacitetit brenda strukturave të BE-së dhe shteteve-anëtare për të zbuluar, hetuar dhe ndjekur penalisht terroristët si dhe

<sup>15</sup> Shih Raportin Shtesë të Bashkimit Evropian për Komisionin e themeluar bazuar në Paragrafin 6 zë Rezolutës Nr. 1373 (2001) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara që mund të gjendet nën këtë numër procedural: S/2002/928 (Nju-Jork, 2002), ff. 409 - ose në: European Commission, Commission Staff Working Paper (2002), 1-11SEC (2002) 231.

<sup>16</sup> Shih Bures Oldrich, “EU Counterterrorism Policy: A Paper Tiger?”, Terrorism and Political Violence, vëll. 18, nr. 1, 2006, f. 72.

*për të parandaluar sulme terroriste; si dhe përmes forcimit të kapaciteteve të shteteve anëtare për t'u përballur me pasojat e një sulmi terrorist.*"<sup>17</sup>

Brenda këtij koncepti Bashkimi Europian themeloi strategji të përbashkëta me Shtetet e Bashkuara, duke rritur koordinimin mes tyre, duke miratuar politika të ngjashme si dhe duke mbajtur qëndrime të përbashkëta. Por Europa e ka zgjeruar edhe më tej rrjetin e bashkëpunimit dhe koordinimit duke themeluar dhe mbajtur një listë "organizatash terroriste". Lista shtrihet përtej asaj të Kombeve të Bashkuara (që përfshin Al-Kaeda-n dhe talebanët) dhe përfshin organizatën terroriste egjiptiane Al-Gama'a al-Islamija, organizatat turke të PKK-së dhe DHKP/C-së si dhe Monopatin e Shndritshëm të Perusë. Bashkimi Europian dhe Shtetet e Bashkuara rrisin koordinimin e tyre në procesin e identifikimit të këtyre grupeve, gjë që dëshmohet nga mbështetja amerikane për angazhim kundër lëvizjes terroriste baske të ETA-s.<sup>18</sup> Themelimi i procedurave të përbashkëta strategjike u mundëson aleatëve të krijojnë politika të përbashkëta sigurie duke miratuar qëndrime të përbashkëta. Të njëjtat politika aplikohen si nga shtetet e reja anëtare ashtu dhe nga vendet që dëshirojnë të integrohen në Bashkimin Europian.

## Zgjerimi i Europës

Më 1 maj 2004, BE u zgjerua nga 15 në 25 shtete, kurse në 2007 asaj iu bashkuan Bullgaria e Rumania. Fundi i këtij procesi të gjatë ndryshimesh e reformash të mundimshme i tregoi rrugën edhe vendeve të Ballkanit që kanë orientim të fortë europian dhe, sidomos për këto të fundit, interesi për të mënjnauar çfarëdolloj pengese në rrugën e tyre shfaqet edhe në aspektin e izolimit të Ballkanit nga penetrimi i terrorizmit me natyrë fetare radikale islamike. Ndërkaq po zgjerohet dialogu politik midis vendeve të BE-së dhe rajonit të Ballkanit

<sup>17</sup> "New EU Measures Against Terrorism", 29.10.2004.

<http://www.europaworld.org/week198/neweu291004.htm>

<sup>18</sup> Shih Kennedy Graham, "The Security Council and Counterterrorism: Global and Regional Approaches to an Elusive Public Good", Terrorism and Political Violence, vëll. 17, nr. 1, Routledge, f. 52.

duke krijuar kuadrin për reformat e nevojshme.<sup>19</sup> Por nuk duhen harruar dobësitë e tyre strukturore dhe situata e dobët e sigurisë, të cilat prekin në mënyrë kuptimplotë progresin e tyre drejt BE-së për shkak të dhunës që shfaqet herë pas here. Tensionet midis grupeve të ndryshme etnike, kërcënimet me natyrë etnike, dhuna dhe shkatërrimi i pasurisë dhe i trashëgimisë kulturore të njëri-tjetrit sigurisht që nuk pajtohen me vlerat dhe normat europiane. Sfidat me të cilat përballen vendet e Europës Juglindore “...jo vetëm që janë të përbashkëta por kanë edhe një dimension ndërkuftar. Kthimi i refugjatëve, problemet infrastrukturore dhe zhvillimi ekonomik si dhe lufta kundër krimit të organizuar janë shembuj që tregojnë nevojën e forcimit të bashkëpunimit midis këtyre vendeve.”<sup>20</sup> Pranimi gjithnjë e më shumë i nevojës për rajone të qëndrueshme dhe të sigurta, si në rastin e vendeve të Europës Juglindore lidhet gjithashtu me zgjerimin e aktivitetit kriminal në tërësi në Europë. Nuk duhet harruar pa përmendur se “... në të kaluarën Bashkimi European në tërësi dhe anëtarët që e përbëjnë atë në veçantë preferonin t’i vendosnin konceptualisht dhe ligjërisht aktet terroriste nën ombrellën e krimeve serioze e të organizuara.”<sup>21</sup> Por sistemi mjaft i zhvilluar e i integruar i transportit dhe i komunikimeve që ka krijuar Europa mund të ofrojë kushte mjaft të favorshme për trafikantët e armëve, narkotikëve dhe qenieve njerëzore. Organizatat kriminale tradicionale i janë përgjigjur pozitivisht këtyre zhvillimeve dhe kanë zgjeruar bashkëpunimin me organizata kriminale në vende të Europës Lindore që më parë ishin relativisht të izoluar. “Si shembull i këtij ndryshimi mund të shërbejnë grupet kriminale italiane që kanë braktisur përgjithësisht antipatinë për rivalët e tyre shqiptarë në anën tjetër të Adriatikut dhe që po bashkëpunojnë në drejtim të trafiqeve të ndryshme të shtrira tashmë në të gjithë Europën Jugore. Një shembull i përgjithshëm i këtij lloji

---

<sup>19</sup> Shih Edward P. Joseph, “Back to the Balkans”, Foreign Affairs, vëll. 84, nr. 1, janar 2005, f. 111.

<sup>20</sup> Shih Raportin e Komisionit Evropian mbi “Procesin e Stabilizim-Asocimit të Evropës Juglindore dhe Ballkanit Perëndimor”, i disponueshëm edhe për vitin 2008 në faqet përkatëse të ministrive të punëve të jashtme të vendeve të rajonit dhe në atë të Komisionit Evropian, ibid., f. 19.

<sup>21</sup> Shih Doron Zimmermann, ibid., f.123.



*pragmatizmi kriminal është prirja në rritje për të përdorur armët dhe bimët narkotike si elementë kyçë të operacioneve trafikuese transnacionale.*"<sup>22</sup> Kësisoj, krimi i organizuar dhe zgjerimi i aktiviteteve të tij po bëhen një çështje shqetësimi serioz që gjithnjë e më shpesh po konsiderohet subjekt i sigurisë kombëtare për vendet e BE-së.

Edhe më alarmues është fakti se midis shumë problemeve aktuale "...qëndron ai i dallimit të zbehtë midis terroristëve dhe grupeve kriminale, sidomos për sa i përket 'luftëtarëve të shndërruar në kriminelë'".<sup>23</sup> Ky dallim i zbehtë u vërejt gjatë luftërave ballkanike ku një sërë të ashtuquajturish "luftëtarë të lirisë" u shndërruan në pjesëtarë të krimit të organizuar dhe kur përfitimet e operacioneve trafikuese u bënë dukshëm motivi i tyre parësor i sjelljes së supozuar ideologjike. Kështu, sasi të mëdha armësh të braktisura nga arsenalet e sistemeve të vjetra u shpërndanë në të gjithë botën përmes trafikut të armëve të cilin administratat e dobëta dhe të korruptuara të këtyre vendeve nuk mund ta ndalonin. [Kështu për shembull, një numër i madh armësh të prodhimit shqiptar janë gjetur në shumë prej konflikteve të Afrikës.]

Marrëdhënia simbiotike midis krimit të organizuar dhe organizatave terroriste në Europën Juglindore ka qenë përfituese për të dyja palët.<sup>24</sup> Aleancat dhe marrëveshjet tregtare mund të sjellin përfitime të dypalëshe që kanë zëvendësuar gradualisht ideologjitë si motiv kryesor operacionesh. Duke e çuar edhe më tej këtë argument do të biem dakord me atë që John P. Sullivan nënkuptonte kur përmend se: "Qasjet

---

<sup>22</sup> Shih Glenn E. Curtis, Tara Karacan, "The Nexus among terrorists, narcotics traffickers, weapons proliferators, and organized crime networks in Western Europe", Studim i përgatitur nga Federal Research Division, Libraria e Kongresit Amerikan bazuar në një marrëveshje midis agjencive përkatëse me Qeverinë e Shteteve të Bashkuara, që mund të gjendet në Librarinë e Kongresit, Uashington, botuar në dhjetor 2002.

<sup>23</sup> Shih Glen E. Curtis, Tara Karacan, *ibid.*, f. 4.

<sup>24</sup> Për më shumë mbi këtë marrëdhënie dhe mbi krimin transnacional në përgjithësi shih: Jeanne Giraldo dhe Harold Trikunas, "Krimi Transnacional" në Alan Collins (ed.) "Probleme Bashkëkohore të Sigurisë", Kapitulli 19, Oxford University Press, 2006 (përkthyer shqip nga UET Press, Tiranë, 2009).

*tradicionale të sigurisë dhe inteligjencës bënë ndarjen midis inteligjencës kundër krimit dhe atyre kundër sigurisë kombëtare, por edhe midis problemeve të brendshme e atyre ndërkombëtare. Terrorizmi modern i shfrytëzon këto lidhje për të operuar në shkallë globale. Ekstremistët transnacionalë që operojnë përgjatë kufijve kapërcejnë jo vetëm kufijtë fizikë por edhe ato midis sigurisë kombëtare dhe imponimit të ligjit kundër kriminelëve. Këta fanatikë po përziejnë radikalizmin politik e atë fetar me sipërmarrje kriminale duke sfiduar rendin ligjor dhe duke shfrytëzuar lidhjet midis krimit dhe luftës.”<sup>25</sup>*

Operacionet e gjera antikrim dhe antiterror humbasin dallueshmërinë praktike kur kanë akses në mbështetjen popullore ose kur kanë kapacitetin për të angazhuar një numër të gjerë individësh në jetët e tyre të përditshme. Në këtë mënyrë ato shndërrohen në aktivitete me bazë popullore, një fakt që krijon gjithnjë e më shumë ndërlikime për cilindo institucion ligjor ose rendvënës që përpiqet të funksionojë me efikasitet. Ndërsa ideologjia mbetet motivi kryesor, përfshirja e drejtpërdrejtë në operacione kriminale u mohon këtyre organizatave “pastërtinë” e qëllimeve të tyre politike. Në mënyrë të ngjashme, çdo lëvizje terroriste ose çlirimtare që e alternon sjelljen e saj duke u angazhuar në operacione kriminale mund të sjellë ndryshime edhe në sjelljen e institucioneve të komunitetit ndërkombëtar. Në fakt vërehet një lloj diversifikimi në qasjet e komunitetit ndërkombëtar i cili bën të rriten kritikant në lidhje me kërkesat për autonomi. Kjo shprehje mospëlqimi për aktivitetin e tyre është hapi i parë që duhet ndjekur për të ndryshuar politikat që u mundësuan këtyre organizatave në të kaluarën realizimin e operacioneve të tyre.

Ndërkaq, forcimi i lidhjeve të organizatave tradicionale separatiste, si ETA dhe IRA, me krimin e organizuar është raportuar si nga mediat europiane ashtu dhe nga forcat policore.<sup>26</sup>

---

<sup>25</sup> Shih John P. Sullivan, ‘*Terrorism early Warning and Co-Production of Counterterrorism Intelligence*’, Los Angeles Terrorism Early Warning Group, Canadian Association for Security and Intelligence Studies, CASIS 20<sup>th</sup> Anniversary International Conference, Montreal, Kebek, Kanada, 21 tetor 2005.

<sup>26</sup> Shih Paolo Chiariello dhe Gian Antonio Orighi, “*ETA and Camorra Crime Syndicate*”, Panorama (Milano), 3 tetor 2002, FBIS, Dokumenti Nr. EUP20020927000203.

## Raste studimore

Sidomos në rastin e ETA-s, qeveria spanjolle ka rezultuar tepër e pasuksesshme për t'u përballur si me organizatën ashtu dhe me kërkesat e saj. Siç tregon sulmi terrorist i 11 marsit 2004, votuesit spanjollë në vend të përkrahnin qeverinë dhe shpejtësinë me të cilën ajo akuzoi ETA-n për sulmin, zgjodhën të votojnë kundër partisë në pushtet dhe të sjellin opozitën në qeveri. Fakti se u provua thujse menjëherë se ETA nuk ishte përgjegjëse për sulmin terrorist krijoi një lloj “ekuilibri” në perceptimin e opinionit publik midis pranisë së ETA-s dhe shfaqjes së një lloji tjetër [të ndryshëm] terroristësh në shoqëritë dhe vendet europiane.<sup>27</sup> Megjithatë, sulmi terrorist në Madrid pati një “...efekt të papritur anësor, zhdukjen [thujse] të dhunës së brendshme politike të vetë Spanjës, të ushtruar nga ETA”.<sup>28</sup> Ky “efekt dytësor” vijoi me vendimin e ETA-s për të “...deklaruar një armëpushim të përhershëm, i shpallur në 24 mars 2006”, duke sjellë “një përfundim dramatik të fushatës dhjetëra vjeçare të dhunës të një prej lëvizjeve të fundit separatiste të armatosura e aktive të Europës Perëndimore”.<sup>29</sup> Ky vendim besohet se i ka rrënjët në faktin se pas sulmeve terroriste të 11 marsit 2004 në Madrid pati një “...zmbropsje popullore ndaj terrorizmit”, gjë që e bëri të paimagjinueshëm përdorimin e dhunës si instrument strategjik

---

<sup>27</sup> Hetimi në Spanjë vazhdon ende, ndërsa arrestimet dhe gjyqet e shumta nuk kanë arritur ende t'u japin përgjigje një sërë pyetjesh vendimtare. Të dhënat statistikore të shpërthimeve në Stacionin Atocha në Madrid flasin për 13 bomba të vendosura në 4 trena. 10 prej tyre shpërthyen brenda 4 minutash. Dy bomba u shpërthyen nga policia në mënyrë të kontrolluar. Një bombë nuk u identifikua menjëherë dhe u çaktivizua më vonë. Të gjithë trenat ishin në të njëjtin binar. Kapaciteti i plotë i trenave ishte 6000 njerëz. Viktimat ishin 191 ndërsa të plagosurit dhe të lënduarit që mbërritën në spitale ishin 1.430. Përgjegjësia për sulmin u morr përsipër (midis të tjerëve) nga organizata terroriste islamike “Al Qaeda në Europë”. Të dhënat u paraqitën nga Alejandro Lopez Carresi në Konferencën Ndërkombëtare “Terrorizmi, Siguria Globale dhe Ligji”, Los Anxhelos, 1-2 qershor 2005.

<sup>28</sup> Shih Giles Tremlett, “Terrorism: Al-Qaeda attacks on Spain’s undermined public support for ETA”, *The Guardian*, 13 mars 2006.

<sup>29</sup> Shih Paul Haven, “Terrorism: ETA Announces Permanent Cease Fire”, *The Washington Post*, 23 mars 2006.

dhe politik. Në gjyqin e mbajtur në Spanjë për 29 individët e akuzuar si pjesëmarrës në bombë vëniet e Madridit u paraqitën mbi 1500 faqe raporte dhe përfundimi ishte se ai u organizua nga një celulë islame lokale e frymëzuar, por jo e ndihmuar, nga Al-Kaeda.<sup>30</sup>

Nëse atëherë supozojmë se në Europë, pas vitit 2001 [ose më mirë të themi pas vitit 2004 kur SHBA dhe disa aleatë të tyre perëndimorë sulmuan Irakun] është shfaqur “një formë e re terrorizmi”, atëherë na duhet të deklarojmë se ai ka këto karakteristika dhe këtë profil:

- Njerëz të mirintegruar në kulturën dhe në komunitetet lokale
- Diskretë (pra të padallueshëm nga njëri-tjetri) dhe që nuk bien në sy
- Që flasin rrjedhshëm gjuhën e vendit ku jetojnë
- Liderët e grupeve [ose celulave] të tyre janë të miredukuar
- Dhe kanë lidhje të zbehta [dhe jo konstante] me krimin e vogël

Sulmi terrorist në Madrid nuk tronditi vetëm popullin spanjoll por të gjithë Europën, duke vënë në alarm të gjithë kontinentin. “*Deri në ato momente europianët e konsideronin Al-Kaedan një kërcënim të largët që prekte drejtpërdrejt vetëm Shtetet e Bashkuara dhe vendet me shumicë myslimane*”.<sup>31</sup> Rasti spanjoll i Madridit dhe ai anglez i Londrës shpalosën një sërë çështjesh shqetësuese, si shfaqja e rrjeteve terroriste në tokën europiane dhe mundësia që ato të godisnin edhe kryeqytete të tjerë [si më parë Stambollin, apo kërcënimet për sulme në Gjermani dhe Itali]. Kjo u përkeqësua nga fakti se organizatorët e sulmit nuk ishin të importuar dhe se ata nuk lidheshin me asnjë rrjet të huaj.<sup>32</sup> Mundësia e ekzistencës së “*celulave të fjetura*” nëpër

<sup>30</sup> Shih “Spanish Judge charges 29 with 2004 bombings”, Agjencia informative *Reuters*, 11 prill 2006.

<sup>31</sup> Shih Javier Jordan, Nicola Horsburgh, “*Mapping Jihadist Terrorism in Spain*”, *Studies in Conflict and Terrorism*, vëll. 28, nr. 3, maj-qershor 2005, f. 169.

<sup>32</sup> Shih Paul Haven, ‘Madrid bombings show No al-Qaeda Ties’, Associated Press, 9 mars 2006. Gjithashtu shih Javier Jordan dhe Robert Wesley, ‘*The Madrid Attacks: Results of Investigations Two Years Later*’, *The Terrorism Monitor*, vëll. 4, nr. 5 dhe 9, mars 2006.

kryeqytetet europiane dhe çështja e emigracionit të jashtëligjshëm si shkak i pasigurisë që po lindte u bënë çështjet më të debatueshme. Shumica e kryeqyteteve europiane kaloi në alarm të kuq dhe vuri menjëherë e kryesisht në pikëpyetje politikat pranimit të emigrantëve të jashtëligjshëm si burim i mundshëm penetrimi terrorist.

Çështja e emigrantëve që shndërrohen në terroristë hapi çështjen e emigracionit të jashtëligjshëm, azilkërkuesve dhe refugjatëve nga vendet e treta drejt Europës. Agjencitë e sigurisë kanë shfaqur shqetësimet e tyre të mëdha në lidhje me mundësinë që një numër i konsiderueshëm prej tyre të përdoret nga organizatat terroriste, si kanë treguar një sërë rastesh në Gjermani, Spanjë, Itali dhe Angli. Vëmendje e veçantë nga forcat europiane të sigurisë i kushtohet emigrantëve nga ish-vendet socialiste të Bashkimit Sovjetik si dhe atyre që vijnë nga Azia, Lindja e Mesme dhe rajoni i Kaukazit. Ndonëse shumica e emigrantëve të jashtëligjshëm kanë për qëllim vetëm krijimin e një jete më të mirë e më të sigurt për vete e për familjarët e tyre, ekzistojnë vërtetë një pakicë prej tyre që mund të precipitojnë drejt aktiviteteve që prodhojnë shqetësime sigurie. Terrorizmi i frymëzuar nga mësimet e Al-Kaedas nuk u përballua me efikasitet pasi shumica e debateve vërtiteshin rreth hyrjes së ekstremistëve e jo rreth mundësisë që vetë Europa të ushqente veprimtaritë e tyre.

U desh një tjetër sulm terrorist që të kuptohej se personat e përfshirë nuk ishin të “importuar” nga ndonjë rrjet terrorist i jashtëm, porse pjesë e shoqërisë europiane. Në 7 korrik 2005 Londra u godit nga një sulm terrorist dhe një tronditje e jashtëzakonshme politiko-psikologjike. Pak ditë më pas, më 21 korrik 2005, kërcënime të tjera shkaktuan panik dhe risollën në sipërfaqe problemin e terrorizmit në Europë. Prof. Wilkinson, duke nxjerrë në pah çështjen e sigurisë dhe gatishmërinë e Shërbimeve Britanike të Sigurisë përmend se: *“Duke vepruar mbi bazën e inteligjencës së grumbulluar nga burime të brendshme dhe nga miq e aleatë të jashtëm ata ia kanë dalë mbanë të shmangin ose çrrënjosin të paktën pesë komplete të mëdha që lidhen me Al-Kaedan në Mbretërinë e Bashkuar. Por fatkeqësisht ata nuk*

*kishin të dhëna për celulën që organizoi në 7 korrik vrasjen e 52 njerëzve dhe plagosjen e mbi 700 të tjerëve. Inteligjenca është art e jo shkencë dhe të gjithë specialistët profesionistë të inteligjencës janë të vetëdijshëm se njohuria e tyre mbi armikun tonë më të madh terrorist është sa e paplotë aq dhe shpeshherë e gabuar*”.<sup>33</sup> Pavarësisht përpjekjeve të shumta të autoriteteve britanike, sulmet e 7 korrikut mbeten një çështje e pazgjidhur dhe mjaft enigmatike.

## Islami politik?

Thellimi i debateve e polemikave midis botës myslimane dhe Perëndimit [sidomos midis vendeve myslimane e Bashkimit Europian] filloi me pjesëmarrjen e ushtrive europiane përkrah Shteteve të Bashkuara në luftërat kundër Afganistanit dhe, sidomos, kundër Irakut. Këto luftëra kundër “terrorit” nuk justifikuan e as përlligjën kauzën për të cilën u shpallën, pasi dhuna në të dy vendet vazhdon, madje me ritme të përshpejtuara dhe të përshkallëzuara, kurse Iraku sot është shndërruar në bazë rekrutimi për shumë aspirantë të rinj për terroristë.

Si ka pohuar dhe *Francis Fukuyama* në një artikull mjaft të debatuar në qarqet akademike të marrëdhënieve ndërkombëtare: “*Administrata Bush nuk ka denjuar të pranojë shkallën e humbjes së afateve kohore që i kishte vënë vetes për të demokratizuar Irakun. Iniciativa e saj më e gjerë në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut për të promovuar demokracinë përmes mbështetjes së theksuar retorike të demokracisë dhe financimit të organizatave lokale demokratike u pa fillimisht si një mënyrë për të kapitalizuar momentumin e fituar nga një tranzicion i suksesshëm i Irakut drejt demokracisë. Por deri më sot një momentum i tillë nuk ekziston, porse kemi vetëm kthime mbrapa drejt dhunës së pafundme.*”<sup>34</sup> Në të njëjtën kohë një sërë rastesh të bëra publike nëpër lajme

<sup>33</sup> Shih Paul Wilkinson, “International Terrorism: the changing threat and the EU’s response”, Institute for Security Studies, *Chaillot Paper*, nr. 84, European Union, Paris, tetor 2005, f.43.

<sup>34</sup> Francis Fukuyama and Adam Garfinkle, “Promote democracy and prevent terrorism - but don’t conflate the two”, *The Wall Street Journal*, 27 March 2006.

kanë shkaktuar zemërimin e botës myslimane. Ndër to mjafton të përmendim:

- Përdorimin e vendeve europiane dhe të faciliteteve të tyre për rrëmbimin dhe marrjen në pyetje të të dyshuarve si terroristë (në Greqi, Gjermani, Bullgari, Kosovë, midis të tjerëve), jashtë normave ligjore “*të njohura e respektuara*” nga këto vende.<sup>35</sup>
- Krijimin e Fletarrestit European për të lehtësuar ekstradimin brenda Bashkimit European si dhe drejt vendeve të treta.
- Fotot dhe videot e torturave dhe të gjendjes së degraduar të burgjeve irakiane nga ushtarët amerikanë e britanikë që shkaktuan zemërim e demonstrata në të gjithë botën
- Formulimin e listave të zeza të vendeve e grupeve terroriste, të ndërmarrë me iniciativë amerikane
- Por ajo që shkaktoi më shumë zemëratë ishin karikaturat e Profetit Muhamed në mediat daneze dhe ribotimin e tyre në mediat europiane.

Shqetësimi i qeverive europiane për të mbrojtur qytetarët e tyre ka bërë të rriten masat e sigurisë nga autoritete dhe, paralelisht, ka lançuar përpjekje për të vendosur sigurinë përmbi të drejtat e njeriut. Pas sulmeve terroriste në Londër është vërejtur një presion në rritje mbi Bashkimin European për të përmirësuar bashkëpunimin midis sistemit policor dhe atij gjyqësor anëmbanë Europës. Kështu, në dhjetor të vitit 2005, Parlamenti European miratoi një legjislacion i cili u impononte kompanive të telekomunikacionit të ruanin të dhënat e telefonatave dhe internetit për një minimum gjashtëmujor në rast se ato ishin të nevojshme për hetimet e autoriteteve të sigurisë. Ligje të ngjashme janë miratuar në Francë, Holandë, si dhe janë propozuar në një sërë vendesh të Europës, duke çuar në rritjen e shqetësimit se mos ndoshta kërcënimet terroriste do shërbenin si pretekst për autoritetet që të abuzonin me pushtetin.<sup>36</sup>

---

<sup>35</sup> Shih Gordon Corera, “CIA renditions strain Europe goodwill”, në *BBC*, 20 March 2006.

<sup>36</sup> Skandale me përgjime shpërthyen në Itali, Greqi dhe Portugali kur u bënë publike rastet e përgjimit të telefonave të zyrtarëve të lartë të qeverive përkatëse.

Edhe përpara se të vihej në lëvizje legjislacioni evropian, Italia konsiderohej demokracia perëndimore me përdorimin më të lartë të përgjimeve telefonike. Kohët e fundit një ligj i ri iu bashkëngjiti legjislacionit të mëparshëm, i cili lejon agjencitë e shërbimeve sekrete të përgjojnë në rast se mendojnë se është imediat rreziku i një sulmi terrorist.<sup>37</sup> *“Amnesty International ka kryer analizën e parë të detajuar për reagimin e Bashkimit Evropian ndaj 11 shtatorit në fushën e iniciativave ligjore. Ajo tregoi se ndërsa po thellohet bashkëpunimi ndërkuftar në luftën kundër terrorizmit, mbrojtja e të drejtave të njeriut po “lihet mënjanë”. Kjo nuk çon vetëm në shkelje të të drejtave fundamentale të njeriut por dhe në konfuzion legjislativ dhe pasiguri.”*<sup>38</sup>

Disa kritikë besojnë se mungesa e një “përkufizimi” koherent të terrorizmit lejon dhe bën vend për keq perceptime dhe abuzime me termin, duke çuar në ambiguitet dhe pasiguri mbi ata që janë terroristë dhe mbi ato që konsiderohen organizata terroriste. Masat e marra nga Bashkimi Evropian, si në rastin e krijimit të një “liste të zezë” terroriste, nuk duket se janë produkt i një shqyrtimi të kujdesshëm, duke lejuar një sërë pakënaqësish dhe sfidash ligjore të dalin në sipërfaqe. Masa, si Mandati Evropian i Arrestit, u hartuan për të lehtësuar ekstradimin midis vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, por ato u bënë një çështje debati kur u sfiduan si të padrejta në dy raste, në vitin 2004. Për më tepër, *“boshllëku dhe hendeku i të drejtave të njeriut që identifikohet në masat antiterror të Bashkimit Evropian ngatërrohet kur përballemi me transferta të të dyshuarve në vende të treta. Marrëveshja e Bashkimit Evropian e vitit 2003 me Shtetet e Bashkuara – marrëveshja e parë e këtij lloji për bashkëpunim gjyqësor në çështje kriminale me një vend të tretë – shkakton rezerva të papranueshme për sa i përket të dyshuarve që përballen me dënimin me vdekje në Shtetet e Bashkuara dhe garancive për një proces të paanshëm gjyqësor.”*<sup>39</sup>

---

<sup>37</sup> Shih Simpson L. Victor, “Wiretapping on the increase in Europe”, *Associated Press*, 8 prill 2006.

<sup>38</sup> Shih Dick Oosting, “Europe’s clampdown on terrorism risks backfiring”, *Europe’s World/131, The only Europe – wide Policy Journal*, vëll. 2, pranverë 2006.

<sup>39</sup> Shih Dick Oosting, *ibid.*



Ekstradimet e sipërpërmendura së bashku me raportet për “dorëzimet e jashtëzakonshme” që kanë të bëjnë me transferimin e pavullnetshëm të njerëzve përgjatë kufijve që shpeshherë bëhet në mënyrë mjaft të fshehtë, ka shkaktuar kritika intensive në media dhe nga studiues të ndryshëm nëpër të gjithë Europën. Shumica e të rrëmbyerve kanë akuzuar agjentët e Shteteve të Bashkuara (si dhe të agjencive të tjera kombëtare europiane) për rrëmbimet e kryera mbi territor europian. U ngritën disa çështje mbi ligjshmërinë e këtyre rasteve, mbi qëllimin politik dhe mbi efikasitetin në luftën reale kundër terrorizmit. Si përmend Dick Oosting: *“Bashkimi European ka nevojë të themelojë rregulla që të ndalojnë përdorimin e hapësirës ajrore ose të aeroportëve në territorin e vendeve anëtare të Bashkimit European për transferimin e njerëzve në rrethanat e pranisë së një kërcënimi serioz të shkëlqes së të drejtave të tyre njerëzore. Në planin afatgjatë siguria nuk arrihet përmes bashkëpunimit të verbër me vendet që nuk i respektojnë të drejtat e njeriut ose shtetin ligjor.”*

## Konstatime përmblyëse

Pak vite më parë Europa përballej me terrorizmin si problem i brendshëm dhe i përdorte sipas rastit shërbimet e saj të drejtësisë, policisë dhe inteligjencës. Sot terrorizmi nuk shihet më ekskluzivisht si çështje e brendshme e vendeve anëtare por si një problem i brendshëm sigurie për të gjithë Unionin.<sup>40</sup> Dy sulmet në territorin europian që nuk rezultuan të kenë lidhje të dukshme me asnjë rrjet ndërkombëtar terrorizmi bëjnë të mundur shfaqjen dhe formësimin e teorive që analizojnë “lidhjet ideologjike” të prirjeve radikale të dhunës. Prandaj mund të pohohet tashmë se ekziston mundësia që pjesëtarë të grupeve të njëjta fetare ose të ideologjive me nuancë fetare ta shohin dhunën si “zgjdhje” ose si “instrument”

---

<sup>40</sup> Shih Peter Chalk, “The Third Pillar on Judicial and Home Affairs Cooperation, Anti-terrorist Collaboration and Liberal Democratic Acceptability”, në Fernando Reinares (editor), “European Democracies Against Terrorism. Governmental Policies and Intergovernmental Cooperation”, Aldershot 2000, ff. 175-210.

pjesëmarrjeje në një luftë që ata vetë nuk e “filluan”. Teoria bazohet në themele të përbashkëta politike e sociale midis pjesëtarëve të një grupi ose komuniteti që ndjehen të huaj dhe të izoluar nga mjedisi i tyre social e politik. Rasti i paaftësisë së dukshme të Europës për të integruar minoritetin e saj të konsiderueshëm mysliman mund të prodhojë rreziqe sigurie. Mungesa e integritit, e kombinuar me përqindjet e larta të papunësisë midis këtyre grupeve si dhe me sigurizimin e çështjes së emigracionit përmes ligjërimit të elitës politike, krijojnë “*premisat e shëndosha për shfaqjen dhe lulëzimin e ekstremizmit islamik*”.<sup>41</sup>

Ndonëse në Europë ekstremistët janë një minoritet brenda minoritetit (të vlerësuar në rreth 1-2% të tyre) kërcënimi që buron prej tyre është real dhe serioz. Terreni për sjellje ekstreme hapet kur kombinohet me qëndrimin karshi luftës në Irak të shumicës së popullsisë myslimane anembanë botës. Duhet vërejtur se procesi i integritit në një shoqëri europiane do të ketë më pak kosto sesa tjetërsimi dhe izolimi që mund të çojnë drejt përdorimit të formave ekstreme të dhunës dhe drejt vdekjeve masive apo edhe shkatërrimit të pronave publike/private. “*Vendet europiane sot, si Holanda apo Gjermania, përfshinë brenda mirëseardhjes që u japin emigrantëve potencialë edhe teste të integritit shoqëror*”. Zyrtarët qeveritarë të të dy vendeve i mbështesin këto ndryshime si të nevojshme për “*...të ruajtur vlerat kulturore tradicionale dhe identitetin europian/perëndimor përballë sfidave që vijnë nga rritja e popullsisë myslimane*”.<sup>42</sup> Madje në Europë është duke u zhvilluar një debat mjaft i madh intelektual mbi myslimanët që jetojnë në këtë kontinent, perspektivat e ritmit galopant të rritjes së popullsisë së këtij grupi.

Ideja e xhihadit në Europë është alarmuese, por njëkohësisht ajo shihet edhe si një fenomen abstrakt dhe i largët. Për

---

<sup>41</sup> Shih Deklaratën e Ndihmës-Sekretarit Amerikan të Shtetit për Çështjet e Evropës përpara Komisionit të Marrëdhënieve me Jashtë të Senatit Amerikan në Uashington, cituar në të përditshmen gjermane “*Der Spiegel*”, më 6 prill 2006.

<sup>42</sup> Shih Andreas Tzortzis, “In Europe, quizzes probe values of potential citizens”, në *The Christian Science Monitor*, 10 prill 2006.

rrjedhojë, shumica e europianëve nuk e pranojnë idenë e një “*luftë kundër terrorit*”.<sup>43</sup> Mbi të gjitha kundërpërgjigja europiane ndaj terrorizmit ndërkombëtar ka konsistuar në “...një përdorim të harmonizuar të procedurave dhe proceseve ndërqeveritare. Kjo, së bashku me kufizimet e zakonshme të informacionit në lidhje me masat dhe presionet antiterrorizëm të ushtruara nga Shtetet e Bashkuara, ka çuar në përpjekje për të promovuar masa që duket se e mbivlerësojnë dhe e mbitheksojnë “sigurinë” duke bërë kompromise dhe duke dobësuar nocionet e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të tij”.<sup>44</sup> Një numër i madh kritikësh theksojnë se struktura e Bashkimit European nuk garanton kushtet “...e një strukture të mjaftueshme për të iniciuar, udhëhequr, koordinuar, madje dhe për të marrë, në fund të fundit, rolin e leadershipit politik në kontinentin european”. Për më tepër, “mungesa e një mandati të qartë dhe reduktimi i rolit të Unionit në atë të organizuesit dhe koordinuesit lidhen në mënyrë të pashmangshme me vetë natyrën e tij. Fillimisht Unioni u ideua si një bashkim i plotë politik (1952). Por përmes Traktateve të Romës (1957) ai u redaktua në një kuadër ekonomik (pra në Komunitetin Ekonomik European). Trajta e saj aktuale është ajo e një gjiganti burokratik që po përhapet edhe në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes së brendshme e të jashtme (si, bie fjala, në Shtyllën e Tretë, të Drejtësisë dhe Çështjeve të Brendshme). Megjithatë atij i mungon legjitimiteti i nevojshëm për t’u shndërruar në një organizatë të sigurisë kolektive ose në një “sovrani mbikombëtar” me mandat sigurie mbi Europë”.<sup>45</sup>

Duhet vërejtur gjithashtu se mungesa e një mbrojtjeje dhe e një ushtrie të përbashkët europiane ka ndihmuar NATO-n të riorientojë strategjinë e saj në epokën e Pasluftës së Ftohtë. Ky rikonfigurim përfshin edhe “*luftën parandaluese kundër terrorizmit*” që përfshin edhe anëtarët e rinj si mbështetësit “*më të flaktë*” të saj. Në mënyrë që NATO të sigurojë asistencë ushtarake e të pajisë teknologjinë e nevojshme për të realizuar operacionet kundër terrorizmit, ishte i nevojshëm transformimi dhe ristrukturimi i organizatës. “*Teorikisht e gjithë kjo filozofi e re është shumë premtuese dhe duhet të ndihmojë për të përmirësuar kapacitetet shtetërore dhe angazhimin e më shumë vendeve*

<sup>43</sup> Shih Doron Zimmermann ibid., p.123.

<sup>44</sup> Shih F. Gregory, “EU’s Response to 9/11”, ibid., f. 121.

<sup>45</sup> Shih Doron Zimmermann ibid., f. 124.

*në mekanizmat ndërkombëtarë. Por NATO ka edhe vështirësi strukturore në një sistem ndërkombëtar të dominuar nga Shtetet e Bashkuara.”<sup>46</sup>*

*Nga ana tjetër Bashkimi European në tërësi dhe secili shtet në veçanti u akuzua nga Shtetet e Bashkuara për mungesën e një vizioni strategjik dhe për dështim në riorientimin e politikave të tyre të jashtme dhe të mbrojtjes në drejtim të përbaljes më efikase me realitetin e re që paraqet terrorizmi si kërcënimi më i madh me natyrë strategjike për fundshekullin e kaluar dhe për shekullin e njëzetentë. Por vendet europiane kanë një histori të gjatë demokratike dhe kultura ligjore të mbështetura në themele njaft të thella që mund të shndërrohen në vlerën e tyre të shtuar në përbalje me terrorizmin gjatë viteve që vijojnë. Qasjet e ndryshme të europianëve ndaj fenomenit të terrorizmit u perceptuan fillimisht si reagime të dobëta ose të papërshtatshme ndaj një problemi që po rriste intensitetin e tij. Më pas, kur shtetet e para europiane iu bashkuan masave antiterror të iniciuara nga Shtetet e Bashkuara, u ngritën argumente të pavarura që vinin kryesisht nga bota akademike, media apo profesionistët kundër miratimit të propozimeve amerikane.*

*Terrorizmi mbetet një problem që prodhon “pasiguri e frikë dhe që ka për qëllim luftën ndaj një sistemi ekzistues social e politik”.<sup>47</sup> Në të gjitha shfaqjet e tij të larmishme terrorizmi ka shkaktuar negativizëm dhe agresion, duke fragmentarizuar njëkohësisht procesin e integritetit të shoqërive përmes mësymjes dhe luftës kundër vlerave qytetëruese. Nëse qëllimi është parandalimi i tij, atëherë ka rëndësi jetike të kuptohen siç duhet rrënjët e ekzistencës së tij dhe arsytet e vazhdimësisë së tij. Është gjithashtu thelbësore që vendet europiane kur përballen me të të mos harrojnë vlerat e tyre demokratike mbi të cilat kanë ndërtuar jo vetëm sistemet politike europiane por edhe qytetërimin perëndimor në tërësi. Duke mbrojtur demokracinë - jo sikurse e parashikonte e nënkuptonte doktrina neokonservatore e*

<sup>46</sup> Shih Wright J., “Europe in the Global Campaign Against Terrorism”, në *Terrorism and Political Violence*, vëll. 18, Nr 2, verë 2006, f. 294.

<sup>47</sup> Shih Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës: “Alleged secret detentions and unlawful inter-state transfers involving Council of Europe member states”, Komisioni i Çështjeve Ligjore dhe i të Drejtave të Njeriut, Memorandum i paraqitur nga Mr. Dick Marty, Raportues i Këshillit të Evropës, AS/Jur (2006) 16 pjesa 2, 7 qershor 2006.

*politikës së jashtme amerikane, por kuptimin dhe thelbin e demokracisë - vendet europiane do të garantojnë edhe parandalimin e dhunës.*

*Terrorizmi është mbivlerësuar, është thjeshtëzuar më shumë se ç' duhet dhe është keqpërdorur si term dhe koncept me qëllim promovimin dhe legjitimin e operacioneve shtetërore kundër kriminelëve që e përdorin atë. Statusi i tij është sigurizuar përmes ligjërimit politik duke bërë që ky fenomen të shihet si një luftë [ndërkombëtare] kundër terrorit, në vend që të shihet si një sëmundje, e cila duhet shëruar nga rrënjët, apo si një krim, ndaj të cilit duhet vepruar si me mjete ligjore ashtu dhe policore. Kurdo që një shoqëri demokratike ose një sistem politik përdor dhunën si justifikim për të ndëshkuar dhunën, kjo vë në rrezik të ardhmen e gjithsecilit prej nesh.*

Enri Hide është pedagog i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin European të Tiranës. Pasi ka zhvilluar studimet e larta për Marrëdhënie dhe Organizata Ndërkombëtare, ai ka vijuar me një MA në fushën e “Marrëdhënieve të BE-së me Vendet në Zhvillim” dhe një MA në “Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Strategjike” në Athinë.

**BARRY J. RYAN**

## ZHVILLIMI I AXHENDËS SË SIGURISË SË BE-SË: SIGURIMI I SHQIPËRISË DHE I MALIT TË ZI

Ky artikull përbën një kritikë të reformave në sektorin e sigurisë të implementuara në Shqipëri dhe Mali të Zi ndërmjet viteve 2000 dhe 2007 nga Bashkimi Europian. Ai tregon se brenda këtyre reformave është e mundur të dallosh një tension ndërmjet një qasje zhvillimi holistik dhe një qasje me bazë sigurinë, që i referohet krejtësisht dhe në masë të madhe shqetësimeve për sigurinë të Bashkimit Europian. Bazuar në studimin e drejtuar nga autori në Shqipëri dhe Mali të Zi, artikulli përdor anketat publike për të nxjerrë në pah distancën ndërmjet reformave të sigurisë së brendshme të financuara nga BE-ja dhe shqetësimeve të përditshme të sigurisë së banorëve që jetojnë në një shtet me polici jo efektive. Artikulli arrin në përfundimin se një axhendë parësore për sigurinë është bërë pjesë e qëllimeve të BE-së për të krijuar një hapësirë të “lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”. Kështu, megjithëse kufijtë e Ballkanit Perëndimor po sigurohen, mungesa e reformave të brendshme vështirëson zhvillimin social-ekonomik dhe demokratizimin e shteteve të angazhuara në procesin e zgjerimit të BE-së.

### Hyrje

Përgjatë viteve të fundit, reforma e sigurisë ka fituar një rol të rëndësishëm në politikat e jashtme të sigurisë dhe mbrojtjes së BE-së. Në këtë artikull do të shqyrtohen politikat që duket se kanë krijuar një tension ndërmjet kornizës normative të BE-së për sigurinë botërore dhe ambicies së tij për të krijuar

një hapësirë të “lirisë, sigurisë dhe drejtësisë” në Ballkanin Perëndimor. Synimi europian për të ndërtuar një zonë “të lirisë, sigurisë dhe drejtësisë” nënkupton një shkallë simetrie ndërmjet lirisë dhe sigurisë. Në të vërtetë, pretendimi për një balancë ndërmjet sigurisë dhe lirisë është një parim qendror i filozofisë politike liberale (Neocleous, 2007). Kështu, kushti i sigurisë dhe shpërndarja e zhvillimit janë artikuluar zakonisht si përmirësim i përbashkët i pikësnyimeve politike dhe parimeve thelbësore të politikës së jashtme europiane. Përkrahësit e sigurisë njerëzore e mbështesin këtë axhendë dhe argumentojnë se zotimi i mëtejshëm për një qeverisje të mirë dhe zhvillim bashkë me reformat në sektorin e sigurisë do të reflektojnë më mirë këtë kornizë holistike (Kaldor, Martin & Selchow, 2007).

Sigurisht, të dhënat tregojnë se bashkimi i këtyre axhendave po merret seriozisht nga politikëbërësit europianë (Youngs, 2008 : 419). Megjithatë, si tregon ky artikull, kjo nuk po ndodh në mënyrën e imagjinuar nga përkrahësit e sigurisë njerëzore. Në kundërshtim me aspiratën e Amartya Sen (1999), siguria dhe zhvillimi nuk po shkrihen për t’u bërë dy anë të së njëjtës monedhë. Më tepër sesa monedha, duket se ne duhet të mendojmë për një monedhë që quhet siguri, e cila ndahet në vlerat e zhvillimit infrastrukturor, ndërtimin e institucioneve demokratike liberale dhe përhapjen e një ekonomie të hapur tregu.

Siguria duket se po njihet si vlera e përbashkët për veprimtarinë e BE-së përtej kufijve të saj. Një qasje e tillë nga afër i përngjan pragmatizmit të studiuesve si Amitai Etzioni (2007), i cili kohët e fundit ka argumentuar që “*siguria e para*” (security first) duhet të jetë parimi që drejton politikën e jashtme të SHBA-së në ndërtimin e shtetit (state-building), duke pohuar se është e kuptueshme që siguria të marrë përparësi mbi zhvillimin dhe demokratizimin. Argumenti i tij është që aspiratat transformuese të liberalizmit për të demokratizuar shtetet joliberalë kanë qenë gjerësisht të paplotësuara.

Dikush mund të supozojë që një perspektivë e tillë do të jetë anatema e politikëbërësve (policy-makers) në Bashkimin

European, ndërsa ata eksperimentojnë me përcaktimin e një modeli për një strategji liberale për një strategji të ruajtjes së sigurisë ndërkombëtare. Prioritetizimi i sigurisë kundërshton premisën liberale që liria dhe siguria nuk kanë një marrëdhënie dikotomike. Gjithashtu, duke shmangur shqetësimet lokale, kjo tregon që siguria është diçka e imponuar nga BE-ja mbi fqinjët e saj. Ky artikull tregon se gjurmë të forta të një qasje të tillë janë të dukshme në praktikën e sigurisë dhe mbrojtjes në Ballkanin Perëndimor. Në kundërshtim me kushtet e brendshme të sigurisë dy shtetet që merren si shembull në këtë shkrim të drejtuar nga BE-ja në reformën e policisë, kjo synon të gjejë shkakun për një deficit ndërmjet nevojave të këtyre shoqërive post-konfliktuale dhe synimeve të aktorëve ndërkombëtarë. Shkurtimeisht, ai synon të përcaktojë natyrën e shfaqjes së qasjes *siguria e para* të BE-së ndaj pasigurisë social-ekonomike.

## Teoria kritike dhe reforma e sigurisë

Në tendencat e saj për ta kuptuar atë si një aktivitet teknik, shumica e literaturës në fushën e ndërtimit të shtetit (state-building) e paraqet kushtin e sigurisë në terma absolut. Gjithmonë, objekti i reformës është parregullsia dhe paefektshmëria e politikave të mëparshme, të cilat janë shoqëruar me ekonomi disfunktionale dhe/ose konflikt të dhunshëm. Shteti pritet që të sigurojë një përgjigje efektive dhe efikase ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe korrupsionit, ndërsa themelon parimet e mirëqeverisjes që mbrojnë të drejtat ligjore të qytetarëve të vet - një pjesë sigurie për një pjesë normash liberale. Praktikisht, Edmunds (2007) ka vëzhguar që reforma e sigurisë publike në vetvete përfshin zgjedhjen ndërmjet interesave dhe vlerave konkurruese. Edmunds këtu i referohet hierarkisë së kërcënimeve dhe përgjigjeve të qenësishme në çdo projekt që synon të transformojë një shtet post-konfliktual në një shtet liberal demokratik. Në mënyrë të ngjashme, Brzoska (2006) thekson vështirësinë e koordinimit të burimeve dhe kapaciteteve të



aktorëve të jashtëm me nevojat konkurruese në projektet e ndërtimit të shtetit (state-building). Këto studime janë tregues të një qasje ndaj reformës së sigurisë që nuk merr parasysh rolin e komunitetit ndërkombëtar në formimin dhe riprodhimin e kësaj hierarkie pasigurish. Kërcënimet, si terrorizmi dhe krimi i organizuar janë vërtet të pranishëm - dhe prandaj më të ngutshme - sesa, për shembull, krijimi i një policie të përgjegjshme. Kështu, kur Brzoska (2006 : 2) thekson se realizimi i objektivave të sigurisë, demokratizimit dhe zhvillimit nuk ka qenë një detyrë e lehtë, ne duhet të marrim me mend që kjo është pasojë e natyrës problematike të shteteve post-konfliktuale në përgjithësi.

Me kuptimin e kushtit të sigurisë në terma më pak pozitivistë, mund të perceptohet më mirë natyra e reformës së sigurisë në një mjedis post-konfiktual dhe tranzicional. Sipas kuadrit të Frankfurtit, siguria normativisht kuptohet në termat e vetëvendosjes shoqërore. Meqenëse bazohet në kontekstin, siguria përkufizohet si një **“koncept i derivuar”** dhe kështu që përmban potenciale emancipuese (Williams & Krause, 1997 : ix).

Arsyeja instrumentale e të bazuarit të reformës së sigurisë rreth vazhdimësisë së demokracisë liberale kundërshton imazhin që e paraqet rolin e donatorëve ndërkombëtarë si të angazhuar në një veprimtari neutrale dhe teknike.

Konceptimet tradicionale të sigurisë tentojnë t'i reduktojnë njerëzit në rolin e tyre si mjete për të siguruar një model të veçantë social-ekonomik të shtetit. Kështu, zgjedhjet ndërmjet vlerave dhe interesave konkurruese në lidhje me sigurinë reflektojnë vendime politike që janë të izoluara nga kontestimi popullor. Günther (2005 : 380) ka vëzhguar që këto vendime janë bazuar mbi ruajtjen e një **“arkitekture sigurie transnacionale”**, të ngritur rreth kërcënimit të shkaktuar nga efektet anësore disfunktionale të sistemit të tregut global: krimi i organizuar, terrorizmi dhe emigracioni i paligjshëm. Në këtë kuptim implikohet ekzistenca e një konceptimi kategorik të sigurisë që ka nevojë ta hapë veten ndaj pohimeve konkurruese.

Aspektet e kësaj perspektive gjetën përkrahje midis mbrojtësve të sigurisë njerëzore me synimin për të përdorur

ligjërimitin e sigurisë për qëllime zhvillimore. Këto treguan se adoptimi i një përkufizimi të gjerë të sigurisë mund ta shndërrojë sigurinë në sinonim me një qasje komunitare ndaj zhvillimit, që përfshinte: të drejtat politike, shoqërore dhe ekonomike në rajonet në zhvillim (MacFarlane & Foong Khong, 2006). Gjithashtu, kjo ofroi një logjikë për praktikantët përmes lidhjes me kujdes të një tërësie synimesh për zhvillim pas-Luftës së Ftohtë (si mirëqeverisjen, të drejtat e njeriut dhe pjesëmarrjen) rreth çështjes së sigurisë së përbashkët.

Megjithatë, puna e ndërmarrë nga dega neorealiste kritike e studimeve të sigurisë, paralajmëroi se përhapja e ligjërimit të sigurisë do të nisë një përgjigje tradicionale të sigurisë për çështjet e zhvillimit. Studimi i anëtarëve të “Copenhagen School” (Shkollës së Kopenhagenit) më pas eksploroj procesin, përmes të cilit ngjarjet u bënë “të sigurisë” (Buzan & Wæver, 2003). Ata treguan se sigurimi ndodh kur aktorët e elitës janë në gjendje të bindin audienc/ën(at) e tyre që një çështje e tillë përbën një nivel të mjaftueshëm kërcënimi që të përlligjë masa të jashtëzakonshme. Për rrjedhojë, liritë pakësohen në emër të çështjeve të sigurisë. Në këtë linjë arsytimi implikohet akuza që teoritë liberale e përdorin ligjërimitin për sigurinë në një mënyrë që promovon interesin vetjak të një aktori të fuqishëm përmes një fasade dashamirësie. Ky artikull shton peshën empirike, prandaj, ndaj argumentit kritik që kur siguria është mbizotëruese dhe e përcaktuar në terma absolut, zhvillimi do t'i shërbejë asaj, sesa të lehtësojë emancipimin.

## Siguria, liria, drejtësia në Ballkanin Perëndimor

Në përbërje të paqëndrueshmërisë së shkaktuar nga shpërbërja e Jugosllavisë dhe rënies së komunizmit në Ballkan ishte një rritje e veprimtarisë kriminale gjerësisht e inkurajuar nga afërsia e rajonit me territoret e Bashkimit Europian (Glenny, 2008). Efektet ndikuese të luftës, korrupsioni dhe varfëria në Ballkan, i bindi politikëbërësit e BE-së me provat e nevojshme të një politike të përbashkët ndaj rajonit. Rrjedhimisht, në një shkallë të gjerë aftësia e BE-së për të

sjellë stabilitet në rajon është e varur nga kapaciteti i saj për të formësuar dhe implementuar një politikë të jashtme koherente. Ashtu si ka theksuar Tom Gallagher (2003), Ballkani Perëndimor konsiderohet të jetë të dyja, një test dhe një fushë eksperimentimi për politikën e jashtme të BE-së. Thelbësore për këtë eksperiment është supozimi që siguria e vetë bashkimit është përcaktuar nga kapaciteti i tij për të rregulluar sigurinë e fqinjëve të tij.

Ndërkohë BE-ja është drejtpërdrejt e përfshirë në drejtimin e operacioneve post-konfliktuale në Bosnje dhe Kosovë, ndikimi i saj fillon si vendosës objektivash kudo në rajon për shtetet që aspirojnë anëtarësimin në BE.

Pjesë e një rrjeti të ngushtë që përfshin, ndër të tjera Bankën Botërore, Programin për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara (UNDP), Fondin Monetar Ndërkombëtar, Këshillin e Europës dhe Organizatën për Sigurinë dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE), ndikimi i tij është përhapur po ashtu si një aktor mbështetës dhe shtrëngues - duke mbështetur politikat dhe reformat që nxisin ndërtimin e institucioneve liberale e demokratike dhe ekonominë e lirë tregu si dhe ndëshkimin e çdo lëvizje kundërshtuese.

Eksternalizimi i politikave të drejtësisë dhe marrëdhënieve të brendshme të BE-së ka qenë instrument i fuqisë së butë të BE-së (Bigo, 2006). Praktika e adresimit të kërcënimeve të jashtme të sigurisë në burimin e tyre e ka filluesën në Traktatin e Amsterdamin në vitin 1999, kur kontrolli i jashtëm i kufijve, azili, emigracioni, parandalimi dhe luftimi i krimit u përfshinë në politikën e jashtme të BE-së. Në Tampere, në tetor të 1997-s, çështjet e sigurisë së jashtme ishin parësore në mendjet e politikëbërësve kur ata krijuan zonën e “lirisë, sigurisë dhe drejtësisë” së BE-së. Kjo zonë shtrihet përtej kufijve të Bashkimit Europian. Parametrat e saj mund të gjenden duke parë prioritetet e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Aktualisht këto janë theksuar nga programi i Hagës, i cili synon të fuqizojë politikat e përbashkëta mbi çështjet e emigracionit, azilit dhe punësimin të paligjshëm brenda dhe jashtë BE-së. Kjo e detyron bashkimin dhe shtetet anëtare të përqendrohen në kërcënimet e jashtme që mund të burojnë nga rajonet si

Ballkani: të sigurojnë bashkëpunimin me to, ndërkohë që të ndërtojnë kapacitetet e forcave policore në shtetet përgjatë kufijve të jashtëm të Bashkimit. Nën flamurin e “lirisë, sigurisë dhe drejtësisë”, Këshilli Europian “e konsideron zhvillimin e një dimensionit të jashtëm koherent të Bashkimit... si një prioritet në rritje” (Këshilli i Bashkimit Europian, 2004 : 33). Krijimi i një zone të jashtme të lirisë dhe sigurisë përcakton politikat e BE-së në Ballkanin Perëndimor, të cilat janë komunikuar përmes procesit të Stabilizim-Asocimit të BE-së në drejtësi dhe çështjet e politikave të brendshme (Lavanex, 2004). Që nga 1999-a, 17% e të gjithë legjislacionit të miratuar nga komisioni ka qenë në fushën e drejtësisë dhe çështjeve të brendshme<sup>1</sup>. Ndërmjet 2002-shit dhe 2006-s, Komuniteti i Asistencës për Rindërtim, programi për Zhvillim dhe Stabilizim (CARDS) në Ballkanin Perëndimor shpërndau 4.65 bilion euro për dimensionin e jashtëm të drejtësisë dhe çështjeve të brendshme (Komisioni Europian, 2002 : 3). Si fillim, kjo përfaqëson një rritje eksponenciale në financimin e sektorit të sigurisë - një të gjashtë e të gjithë financimit të CARDS për këtë periudhë (Trauner, 2007 : 5).

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit (MSA) përfaqëson mekanizmin e fuqisë së butë të kushtëzimit politik. Drejtësia dhe çështjet e brendshme janë thelbësore për (MSA) dhe formon komponentin kryesor të kushtëzimit për statusin e kandidatit të shteteve që kërkojnë anëtarësimin në BE. Sipas zonave prioritare të financimit të CARDS, bashkëpunimi intensiv në fushën e kontrollit të integruar të kufijve ishte prioriteti kryesor, ndërsa reforma në polici ose drejtësi dhe çështjet e brendshme u integruan në një numër prioritetesh institucionale dhe përtej kufijve kombëtarë që përfshijnë krimin e organizuar, antikorrupsionin, emigracionin, azilin dhe kapacitetin operativ të policisë (Komisioni Europian, 2002). Në qershor 2006, mbi bazën e reformave të krijuara për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, Shqipëria firmosi MSA-në e saj. Dhe, shumë shpejt pas ndarjes nga Serbia, Mali i Zi nënshkroi MSA në tetor të vitit 2007. Prosesi

---

<sup>1</sup> Shiko Komisionin Europian (n.d.a.).

i Shqipërisë në arritjen e MSA-së u kushtëzua pothuajse tërësisht mbi reformën në sektorin e sigurisë, mbi bazën e progresit të dukshëm të Shqipërisë në adresimin e disa kërcënimeve prioritare për BE-në nëpërmjet axhendës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Pavarësisht progresit të vogël në institucionalizimin ekonomik apo demokratik, të dyja shtetet u pranuan si kandidatë për anëtarësimin në BE mbi bazën e vullnetit për të pranuar pretendimin e BE-së mbi territoret e tyre si pjesë e zonës së lirisë, sigurisë dhe drejtësisë.

Ngushtësisht e lidhur me mekanizmin e MSA-së ishte Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, i cili u koordinua nga OSBE-ja deri në 2006, kur programi përfundoi. “Working Table III” (Tryeza e punës III) i kushtoi vëmendje çështjeve të sigurisë. Sërish, drejtësia dhe punët e brendshme janë thelbësore për ekzistencën e Paktit të Stabilitetit, i cili ndan reformën në fusha që korespondojnë me prioritetet e MSA-së: krimi i organizuar, antikorrupsioni, emigracioni, azili dhe refugjatët, dhe policia. Menaxhimi i kufirit ndërthuret me të gjithë këto fusha.

Përparësia që i është dhënë drejtësisë dhe punëve të brendshme si të Procesit të Stabilizimit-Asocimit ashtu edhe të Paktit të Stabilitetit nuk do të mbështesin vetëm pretendimin që një qasje ku siguria është e para, po zhvillohet brenda BE-së. Këtij pretendimi i është dhënë më tepër besim, meqenëse **siguria e para** ka ekzistuar që nga fundi i Luftës së Ftohtë dhe fillimi i epokës së ndërtimit të shtetit (state-building). Shumë kohë para se Etzioni të ngecë në këtë koncept, Holm & Eide (2000) treguan sesi mësimet për sigurinë u mësuan nga Kombet e Bashkuara gjatë përpjekjeve për vendosjen e paqes (peacebuilding) në Afrikën Perëndimore. Këtu u vu re se ligji dhe rendi duhet të jenë kushtet paraprake të domosdoshme për paqen dhe zhvillimin e vazhdueshëm. Nuk është një rastësi që ky mësim u nxor saktësisht në të njëjtën kohë kur policët po bëheshin më dominues brenda operacioneve të paqes së Kombeve të Bashkuara. Më të shumtë dhe më të gatshëm sesa ushtarët profesionistë, numri i policëve të dërguar në rajonet post-konfliktuale u rrit me shpejtësi gjatë

viteve '90 (Lutterbeck, 2004). Gjithashtu, formulimi i ligjit dhe rendit që çoi në qasjen *siguria e para*, ndodhi ndërsa reforma në polici po konsiderohej si një aspekt thelbësor i demokratizimit. Reforma e policisë u bë një veprimtari strategjike duke tërhequr oficerët e lartë prej shteteve të zhvilluara kapitaliste nga hemisfera veriore. Prandaj, praktika e ndërtimit të shtetit e BE-së gjithmonë ka qenë ndikuar fort nga një axhendë e “ndërtimit të sigurisë”. Holm & Eide (2000 : 3) e përcaktuan marrëdhënien komplekse ndërmjet zhvillimit dhe sigurisë në terma pothuajse dialektike, duke theksuar që siguria duhet të shihet si një çështje e procesit dhe perceptimeve... Një klimë sigurie është e domosdoshme për të promovuar një proces zhvillimi... thjesht përshtypja e rritjes së sigurisë kontribuon për një model të qëndrueshëm paqeje dhe zhvillimi.

Strategjia për Sigurinë Europiane (SSE) e zgjidh këtë tension dialektik pa dyshim në favor të sigurisë. Në këtë dokument, zhvillimi social-ekonomik dhe demokratizimi përcaktohen si nënprodukt i një mjedisi më të sigurtë.

Siguria është një parakusht i zhvillimit. Konflikti jo vetëm shkatërron infrastrukturën, ai gjithashtu inkurajon kriminalitetin, frenon investimet dhe e bën të pamundur veprimtarinë ekonomike normale (Solana, 2003 : 2).

Që siguria të konsiderohet një parakusht për zhvillimin sigurisht uzurpon çfarëdo barazie kontraktuale të sigurisë dhe zhvillimit. Gjithashtu, “vendet dhe rajonet” janë objektet referuese të caktuara në SSE, përkundër individëve dhe komuniteteve.

Për rrjedhojë e përcaktuar brenda SSE, doktrina e *siguria e para* duhet të kuptohet si projekti mbi të cilin BE planifikon të bazojë marrëdhënien e saj me të dyja rajonet post-konfliktuale dhe me kandidatët potencialë për anëtarësim. Ndonëse doktrina është akoma në fillimet e veta, Komisioni ka propozuar që ajo duhet të përcaktojë qasjen kundrejt rajoneve si Ballkani.

Përballë kompleksitetit të aktorëve të shumtë që shpërndajnë reformën e sigurisë, Komisioni, në 2006-n, u përpoq të përdorte reformën në sektorin e sigurisë si bazë mbi

të cilën të ndërtonte një koncept më fleksibël të BE-së për ndërhyrjen post-konfliktuale. Kjo politikë shkon përtej perspektivës *siguria e para* të caktuar nga SSE duke kërkuar shprehimisht që mbështetja për reformën në sektorin e sigurisë të jetë prioritare në secilën nga paketat për asistencën e jashtme (Komisioni Europian, 2006b : 11)<sup>2</sup>. Përshtatshmëria e reformës në sektorin e sigurisë për të tërhequr fonde prej Mbështetjes së Zhvillimit të Jashtëm të BE-së nxit Komisionin të përballet me financimin e mëtejshëm të reformës në sektorin e sigurisë në të ardhmen (Komisioni Europian, 2006b : 11). Në të gjithë politikën e Komisionit, reforma në sektorin e sigurisë konsiderohet si motivi detyrues rreth të cilit është shpërndarë një qasje koherente ndaj zhvillimit.

Tani le të kthehemi te dy vendet që po provojnë qasjen *siguria e para* në zhvillimin social-ekonomik.

## Sektorin e sigurisë në Malin e Zi

Nga viti 1997, presidenti Miloš Djukanoviæ, ndërmori politikën “**në radhë të parë / Mali i Zi i pari**” që shërbente për të distancuar republikën nga ndikimi i Serbisë brenda Republikës Federale Jugosllave. Dihet që “*Mali i Zi i pari*” u financua më së shumti nga të ardhurat e një operacioni masiv kontrabande. Vetëm operacioni i kontrabandës thuhej se sillte 20 milion euro në vit dhe i mundësonte qeverisë së Malit të Zi të ruante pavarësinë e tij duke financuar shërbimet e domosdoshme (Glenny, 2008 : 37). Një shërbim i tillë ishte mbajtja e një force policore për të luftuar kërcënimin e krijuar nga prezenca e 14.000 ushtarëve jugosllavë në republikën malazeze gjatë luftërave në Ballkan. “Policia” megjithatë është përdorur gjerësisht për të përshkruar grupin e burrave të pajtuar për të mbrojtur politikën “*Mali i Zi i pari*”. Rekrutët, të pajtuar mbi bazën e besnikërisë së tyre ndaj presidentit, u pajisën me një armë dhe një kontratë - pak prej tyre u trajnuan

---

<sup>2</sup> Duke përfshirë instrumentet e saj financiare për para anëtarësim, Partneriteti dhe Fqinjësia Europiane, Bashkëpunimi për Zhvillim dhe Bashkëpunimi Ekonomik dhe Stabiliteti.

dhe shumica nuk zotëronin aftësitë minimale të zbatimit të ligjit. Pas rënies së Slobodan Miloseviç, këtyre burrave iu caktua detyra e ruajtjes së rendit në një territor të ndarë midis atyre që dëshironin të qëndronin me Serbinë dhe atyre që dëshironin të shihnin frytet e synimeve të politikës “*Mali i Zi i pari*”.

Niveli i ndarjes etnike u shfaq kur, me një kufi të vogël të më pak se një mijë votash, republika kaloi një referendum për të deklaruar pavarësinë e saj nga Republika Federale Jugosllave (Friis, 2007 : 86). Prandaj, ekzistenca e një force policore që është politikisht dhe etnikisht afër 43.2% e popullsisë, e cila në regjistrimin e përgjithshëm të 2003-shit e kategorizuan veten si malazezë, ka pasoja të thella për sigurinë e shtetit<sup>3</sup>.

SHBA-ja, shtetet anëtare të BE-së dhe BE-ja vetë (nëpërmjet instrumentit financiar CARDS të BE-së) drejton mbështetjen për drejtësinë dhe punët e brendshme përmes Misionit të OSBE-së në Mal të Zi. OSBE - konsiderohet nga Solana (2002 : 8) të jetë “një partner i lindur i BE-së” - punon nga afër me BE-në në fushën e drejtësisë dhe punëve të brendshme. Qartazi, fushat më urgjente për reforma për BE-në drejtohen nëpërmjet Ministrisë së Brendshme të Malit të Zi - e cila është përgjegjëse për reformën në administrimin publik, sundimin e ligjit dhe qeverisjen vendore.

E shqetësuar nga procesi i reformës së policisë në Serbi, Misioni i OSBE-së kontribuoi pak në reformën e sigurisë malazeze deri vonë në 2005-n (Ryan, 2007). Gjithë reforma në sektorin e sigurisë deri në këtë pikë ishte përqendruar vetëm në ruajtjen e kufirit. Ky ishte shqetësimi kryesor për të dy qeveritë, atë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Europian. Dy milionë euro u siguruan nga Agjencia Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (AERZ), qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe qeveria italiane për pajisjen me aparatura për IT dhe për trajnim-informimin për emigracionin e paligjshëm, kontrabandën dhe trafikimin (OSCE, 2003). Trajnimi u siguroi veçanërisht në administrimin e kufijve të BE-së, kontrollin dhe mbikëqyrjen, komunikimin dhe

---

<sup>3</sup> Shih SHB - Departmenti i Shtetit (n.d.).



inteligjencën, dhe administrimin e “kufijve blu”. Në 2004-n, USAID dhuroi 4 milionë \$ për sigurinë e kufirit në republikën malazeze. Mjaft i debatuar, mbi një milion e këtij u shpenzua në ndërtimin e kontrolleve në kufirin me republikën serbe. Më tej 3 milionë \$ u dhuruan nga Departamenti i Shteteve të Bashkuara për sigurinë e vendit, për blerjen e skafeve, makinave, aparatura si radio dhe radar për sigurimin e brigjeve të Adriatikut të Malit të Zi (OSCE, 2005). Fokusi kryesor i qeverisë amerikane ishte kontrabanda e armëve dhe lidhje me frikën e saj që vija bregdetare e Malit të Zi ishte e cenueshme nga veprimtaritë terroriste. Për Europën Perëndimore, Mali i Zi njihet si një rrugë transiti për drogën që vjen nga Turqia, Kosova dhe Shqipëria. Agjencia Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (AERZ) shtoi grantin e USAID duke siguruar katër milionë euro për përmirësimin e shërbimit ndërkombëtar të kalimit të kufirit midis Kroacisë, Bosnjës dhe Shqipërisë. Agjencia i siguroi OSBE-së 600.000 euro në mënyrë që të lehtësonte në trajnimin e 300 policëve të kufirit, fokusi kryesor i këtij trajnimi ishte antiterrorizmi dhe krimi i organizuar. Në 2005-n u siguruan dhe 500.000 euro të tjera për të mbështetur më tej punën për një sistem IT të integruar në pikat kufitare (OSCE, 2005). Në 2006-n, programi CARDS, i cili është i lidhur drejtpërdrejt me procesin e Stabilizimit dhe Asocimit, vuri mënjanë 1.5 milion euro për të financuar një strategji të integruar të menaxhimit të kufirit<sup>4</sup>.

Në një intervistë në një të përditshme malazeze, drejtori i AERZH shpjegoi që kontrabanda dhe krimi përtej kufirit ka motivuar përfshirjen e BE-së në reformën e sektorit të sigurisë (de Dominicis, 2003).

Përqendrimi mbi reformën dukshëm vazhdon të reflektojë shqetësimet e shteteve anëtare të BE-së, të Bashkimit Europian dhe të qeverisë së SHBA-së.

Në një konferencë **kontribuuese** ku merrte pjesë edhe autori në nëntor 2005, drejtori i policisë malazeze listoi fushat kryesore për t’u reformuar, që janë: lufta kundër krimin të organizuar, korrupsionit, kontrollit të armëve të vogla,

---

<sup>4</sup> Shih Komisionin Europian (n.d.b.).

trajnimin e policisë, krijimin e një plan-veprimi kombëtar për emigracionin, azilin, vizat dhe menaxhimin e kufirit.

Gjatë 2006-s, OSBE vazhdoi të siguronte trajnimin e policisë malazeze në Akademinë e Policisë jashtë Podgoricës. Kurse trajnime specifike u shpërndanë gjithashtu në këtë vendndodhje: Kohët e fundit, trajnimi u sigurua për policët në lidhje me menaxhimin e krizave, i cili përfshinte trajnimin e skuadrave të ngarkuara për bisedimet brenda njësisë speciale të Malit të Zi për antiterrorizmin. Ka pak devijim nga mania me sigurinë e kufirit dhe krimin e organizuar.

Në 2007-n, Bashkimi European vuri në dispozicion 3.6 milionë euro për të luftuar krimin e organizuar, ndërsa për 2008-n, një tjetër 3.3 milionë euro u caktua për menaxhimin e kufirit. Kjo nuk krahasohet me 1 milion euro të vëna në dispozicion për të mbështetur shoqërinë civile<sup>5</sup>. Ky pakësim i aktorëve socialë u reflektua në përbërjen e një kursi një javor për 90 drejtues të policisë të nivelit të mesëm mbi teknikat e ruajtjes së komunitetit në 2006-n. Trajnuesit e OSBE-së, me të cilët fola, e konsideruan përbërjen tepër të thjeshtuar. Gjatë intervistës, policët e të gjitha gradave pa ndryshim iu referuan negativisht konceptit të policisë së angazhuar me shoqërinë civile, duke i cilësuar OJQ-të si organizata të paafta dhe me axhenda në kundërshtim me objektivat e policisë malazeze.

Një nga të paktat masa të sigurisë së brendshme nga vetë Mali i Zi vjen nga një anketim i ndërmarrë në tetor 2004 nga ky autor me OJQ-në Qendra për Demokraci dhe për Të Drejtat e Njeriut (CEDEM) në Podgoricë nën kujdesin e Ministrisë së Brendshme të Malit të Zi dhe OSBE-së (OSCE, 2004)<sup>6</sup>. Ky anketim ngriti çështje të rëndësishme në lidhje me masat e sigurisë në Malin e Zi. Së pari, malazezët përgjithësisht e konsiderojnë policinë e tyre si shumë të madhe dhe të politizuar. (Unë kam gjetur imazhin e Miloš Djukanovic të ekspozuar në shumicën e nëntë stacioneve të policisë që

---

<sup>5</sup> Shih Komisionin European (2008).

<sup>6</sup> Ky ishte një studim paralel ndërmarrë në tetor 2004. Ai kundërshtoi rezultatet e intervistave me 100 policë të të gjitha gradave në nëntë stacione policie me një kampion të shtresëzuar me 1.066 banorë nga të njëjtat bashki.

vizitova në 2004-n.) Megjithatë, për t'u dënuar më shumë, ishte perceptimi që policia konsiderohej e korruptuar dhe e kriminalizuar - që lidhja ndërmjet politikës, kriminit të organizuar dhe ligjit që krijoi “Mali i Zi i pari”, duhej të shkëputej ende. E lidhur me këtë ishte konstatimi se qytetarët në Mal të Zi besonin se policia e tyre ishte diskriminuese në sjelljen e saj - prirjen të jenë më pak të ashpër në marrëveshjet e tyre me disa sektorë të shoqërisë ndërsa janë represivë ndaj të tjerëve.

Duke banuar në një vend të vogël me një prani të madhe të policisë, çdo malazez tjetër ose është i lidhur ose ka një marrëdhënie të afërt personale me një polic. Policimi është një shërbim personal në Mal të Zi: krimi përgjithësisht i raportohet një polici që njihet nga paditësi. Aksesit në shërbimet e sigurisë publike përcaktohet nga lidhjet personale të gjithsecilit. Të jashtëmit - ose, siç i përkufizon studimi, “grupet e marxhinalizuara” (OSCE, 2004: 6) - nuk kanë mundësi për të hyrë në polici. Anketimi konstatoi se shqiptarët etnikë veçanërisht vuajnë nga ky “rrjet social”, sa kohë që prirjen të mos kenë lidhje personale me policinë dhe për pasojë janë më pak të mbrojtur.

Megjithatë, edhe ato që kanë mundësi hyrje në polici shprehën pakënaqësi gjatë anketimit tonë. Përgjithësisht, respondentët aluduan për një forcë policore apatike, të vrazhdë dhe të keqtrajnuar në Mal të Zi. Si tha një respondent “çdo lloj personi është bërë pjesë e forcave të policisë, edhe ato me dosje penale” (OSCE, 2004 : 8). Korrupsioni është i përhapur gjerësisht në mes të policisë së keqpaguar të Malit të Zi. Eksperienca ime duke jetuar në këtë vend sigurisht që e mbështet këtë konstatim. Pa përjashtim, çdo udhëtim që ndërmora me automjetin tim të regjistruar si i huaj, bëhej subjekt i një gjobe qarkullimi nga policia. Asnjëherë nuk mora një faturë për shumat e ndryshme të gjobave që më vendosën. Gjithashtu ekzistojnë prova se drejtorët më të vjetër nuk janë për të mos u qortuar. Anketimi citoi një anekdotë marrë nga një nëpunës i doganave, i cili tregoi sesi disa kamionë kaluan kontrollin kufitar pas një telefonate nga një polic më i vjetër. Mosbesimi i thellë ndaj forcave të policisë që perceptohen si

të manipuluar nga kriminelët, i frenon njerëzit të denoncojnë krimin ose të bashkëpunojnë në çdo mënyrë me policinë. Nuk është për t'u çuditur që, në anketimin tonë, vetëm 43% e popullsisë shprehën besim në forcat e tyre policore.

Në një shtet ku droga dhe armët mund të sigurohen lehtësisht, ku ritmet e alkoolizmit janë të larta dhe ku të rinjtë e papunësuar po formojnë banda, policia po konstaton se e ka të vështirë të funksionojë. Oborret e shkollave rregullisht po bëhen shënjestër e shpërndarësve të drogës. Drejtori i stacionit të policisë në Nikšić, një qytet që vuan nga kushte të vështira ekonomike, tregoi se 90% e kriminelëve në qytet janë të armatosur. Policët e tij nuk kanë radiomarrës dhe nuk marrin mbështetje në punën e tyre nga banorët. Ai më tregoi se njerëzit këtu nuk bashkëpunojnë me ne. Mbase kanë frikë nga uniforma meqë shihet si represive. Nëse dikush na jep informacion ose na kontakton ata menjëherë shihen si spiunët e policisë, informatorët, nga kushdo tjetër. (OSCE, 2004 : 22)

Pavarësisht ritmeve në rritje të vetëvrasjeve dhe niveleve kritike të narkomanëve të raportuar, tha ai, policia nuk ishte inkurajuar të formonte lidhje me shoqërinë civile vendore ose me OJQ-të. Përshtypja ishte e një policie jashtëzakonisht të izoluar. Në Podgoricë, policia mbrojtë autoritetet vendore gjatë dëbimit të refugjatëve, të cilët banonin në vendbanime informale në periferi të qytetit, një praktikë që i distancon ata më tepër nga të marxhualizuarit. Në këto vendqëndrime, që nuk kanë energji elektrike ose ujë të rrjedhshëm, banorët janë vetorganizuar për të kundërshtuar ndërhyrjen e policisë. Gjatë intervistave, policët pohuan që këto ishin zona të padepërtueshme. Gjithashtu, ky izolim është i dukshëm në nivelin e qeverisjes vendore. Studiuesi konstatoi se policia ishte institucionalisht e izoluar: qeverisja vendore e drejtuar nga partitë opozitare të Djukanoviç-it ka lidhje minimale me policinë.

Progres-Raporti i Komisionit European (2006) në një shkallë të gjerë liston fushat ku **siguria e para** duket se nuk po shtrihet. Për shembull, ai konstatoi se asnjë reformë nuk ishte ndërmarrë për të financuar një njësi policore ekonomike të aftë për të luftuar korrupsionin. Progres i pakët është bërë

për të parandaluar torturën ose keqtrajtimin. Aspak progres është bërë në trajtimin e çështjes së dhunës ndaj grave. Statusi ligjor, integriteti ose siguria fizike e 16.000 refugjatëve dhe të pastrehët e brendshëm që jetojnë në periferi të Podgoricës nuk janë përmirësuar. Praktikën diskriminuese kundër këtyre grupeve dhe kundër romëve janë dokumentuar në raport. Gjithashtu, fokusimi tek kufijtë nuk ka qenë i kënaqshëm për Komisionin, i cili thekson që ndonëse policia e kufirit është tashmë e pajisur mirë, shumë prej tyre nuk janë trajnuar. Raporti tregon se “përgatitjet për kontrollin e kufirit janë akoma në një fazë fillestare” (Komisioni Europian, 2006a : 41). Kjo supozohet se paraprin financimin e mëtjeshëm në kontrollin e kufirit në Mal të Zi. Deri tani, arrijmë në përfundimin se, reforma në sektorin e sigurisë në Mal të Zi vetëm sa ka prekur çështjet strukturore që çojnë në shpërndarjen e një sigurie të padrejtë dhe të pasuksesshme për qytetarët e Malit të Zi.

## Sektori i sigurisë në Shqipëri

Në të njëjtin vit që Miloš Djukanoviæ ndërmoi politikën “*Mali i Zi i pari*”, brishtësia e demokracisë që po lindte te fqinji i tij ishte e pambrojtur, ndërsa Shqipëria iu afrua luftës civile.

Varfëria ka qenë gjithmonë një tipar i qëndrueshëm i jetës shqiptare, por mbyllja e papritur në fillim të viteve ’90 të kompanive shtetërore dhe pushimet e mëdha nga puna në sektorin publik rezultuan potencialisht shkatërrimtare në një shtet pa një rrjet social të sigurtë. Atmosfera e pasigurtë ekonomike goditi më fort në rajonet më periferike të qendrës dhe një numër i madh veriorësh, të zhgënjyer nga varfëria në zonat rurale, migruan drejt Tiranës. Kjo shkaktoi një sforcim në infrastrukturën e kryeqytetit dhe rëndoi ndarjet ndërmjet vendasve dhe veriorëve të varfër që jetonin në vendbanime informale në periferi të qytetit. Rajonet në Tiranë, si Kamza, panë rritje të madhe në popullsinë e tyre pa u shoqëruar me ndonjë rritje në shërbimet publike. Popullsia urbane u rrit nga 36% e popullsisë në 46% mes viteve 1989 dhe 1997

(Castaldo, Litchfield & Reilly, 2007). Në jug të Shqipërisë, tensionet shoqërore po bëheshin gjithnjë e më të dukshme. Marrëdhëniet ndërmjet qeverisë qendrore dhe minoritetit greko-shqiptar, të vendosur në jug të vendit, u keqësuan në mënyrë drastike gjatë fillimit të viteve '90 (Vickers, 2006 : 218-219).

Duke pasur parasysh këto presione mbi unitetin e shtetit, qeveria mbajti një qëndrim të fortë kundrejt tranzicionit. Disa masa, si “Dekreti i Genocidit”, ishin shumë të debatueshëm dhe të kundërshtuar dhe çuan në polarizimin e mëtejshëm të opinionit publik. Në dukje i përcaktuar për të hequr vijën e ashpër komuniste nga organet shtetërore, legjislacioni ishte më efektiv në dobësimin e partive opozitare dhe konsolidimin e mëtejshëm të kontrollit të ushtruar nga partia në pushtet mbi institucionet shtetërore, si policia. Për më tepër, reforma e sigurisë nuk u shndërrua në një prioritet të qeverisë. Gjatë 1997-s, agjencitë e kontrollit të zbatimit të ligjit ishin shumë të ngjashme me paraardhësit e tyre komunistë.

Rezistenca ndaj pushtetit të qeverisë qendrore ishte më e zellshme në Shqipërinë e Jugut dhe protesta të mëdha u organizuan atje përpara zgjedhjeve të tensionuara të mbajtura në 1996-n. Sipas OSBE-së, këto zgjedhje nuk ishin të rregullta, dhe protestat u kthyen në rrëmuja në shumë rajone, veçanërisht në jug. Megjithatë, pavarësisht atmosferës politike të paqëndrueshme, zhvillimit të shpejtë të ndërtimit dhe 500 milionë dollarë të ardhura nga remitancat e shqiptarëve të diasporës, sollën një gjallërim ekonomik të mjaftueshëm për shqiptarët e thjeshtë për të filluar investimet në skemat “piramidale” të investimit. (Crampton, 2002 : 304).

Vala e revoltës popullore që pasoi rënien e skemave piramidale u bashkua me zemërimin e publikut kundrejt qeverisë qendrore në qytetet dhe zonat politikisht delikate, si Vlora. Milicia rebele vuri shpejt nën kontroll një sërë qytetesh, duke filluar me qytetin shqiptaro-grek të Sarandës, duke iu drejtuar më tej Gjirokastrës, Beratit dhe Kuçovës derisa arritën periferinë e vetë Tiranës. Zyrtarët jovendas dhe policët e emëruar nga qeveria u larguan nga jugu, duke lënë burgjet, komisariatet e policisë dhe garnizonet ushtarake të hapura për

plaçkitësit. U vlerësua që 656.000 armë të llojeve të ndryshme u plaçkitën prej depove të armëve përgjatë rrugës<sup>7</sup>. Veç kësaj, rebelët morën 1.5 milionë fishekë municionesh dhe sasi të mëdha granatash dhe minash (Ryan, 2006). Stacionet e policisë në mënyrë të veçantë u bënë shënjestër meqë shiheshin si simbol i autoritetit të qeverisë qendrore dhe represionit.

Ndonëse lufta civile u shmang, ngjarjet e marsit të 1997-s krijuan kushte shumë të vështira për banorët e Shqipërisë. Përhapja e armëve dhe vështirësia e mbajtjes nën kontroll e zonave periferike të vendit krijuan kushtet për zgjerimin e rrjeteve kriminale. Droga, cigaret dhe makinat e vjedhura u bënë mallrat kryesorë për operacionet e kontrabandës. Një tregti ogurzezë u zhvillua në trafikimin njerëzor. Porti i Vlorës dhe i Durrësit u bënë parajsa e mafiozëve, ndërsa kontrabanda lulëzoi në rajonet kufitare si Shkodër dhe Kukës, ku nafta dhe armët ishin lehtësisht të transferueshme drejt dhe prej luftës së Kosovës.

Kufijtë e depërtueshëm të Shqipërisë me Republikën e Malit të Zi lejuan sasi të mëdha kontrabande për të lëvizur nëpërmjet portit të Barit për eksport drejt Italisë, pak përtej brigjeve. Megjithatë, ndonëse rrjedhja e kontrabandës nga Shqipëria drejt Bashkimit Europian përbënte një kërcënim, ishte emigracioni masiv që dukej se kishte ngritur shqetësim më të madh për sigurinë për fqinjët më të afërt të Shqipërisë, Greqia dhe Italia. Ndërmjet 1989-s dhe 2001-shit, është vlerësuar që 628.000 persona u larguan nga Shqipëria për të shkuar në Greqi apo Itali (INSTAT, 2002). Gjermania gjithashtu ka parë rritjen e numrit të emigrantëve nga Shqipëria. (Nuk është e rastësishme që tre nga donatorët më të mëdhenj të Shqipërisë janë Italia, Greqia dhe Gjermania.) Varfëria dhe papunësia janë faktorët “shtytës” më të fortë të emigrimit nga Shqipëria, ku, që nga 1990-a, një fëmijë në çdo familje tani banon jashtë shtetit (UNICEF, 2000).

---

<sup>7</sup> Vlerësime të ndryshme u prodhuan. UNDP vlerëson se u morën 550.000 armë. (Ryan, 2006). Vickers (2006), megjithatë, citon një vlerësim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes së Malit të Zi të 656.000 armëve të vjedhura.

Angazhimi i komunitetit ndërkombëtar në Shqipëri i paraprin angazhimit të tij në Malin e Zi. Për rrjedhojë, reforma e sigurisë është paksa më e avancuar në Shqipëri. Domethënës është fakti që, Shqipëria ka Delegacionin e Komisionit të Bashkimit Europian, i cili përqendrohet në administrimin publik dhe reformën gjyqësore, policimin, doganat dhe, nëpërmjet EARD, zhvillimin e infrastrukturës - veçanërisht në fushën e kufijve dhe transportit. Në 2005-2006, mbi 30% e shpërndarjes kombëtare për Shqipërinë të asistencës së jashtme të BE-së u caktua për drejtësinë dhe çështjet e brendshme (Trauner, 2007 : 5). Drejtësia dhe çështjet e brendshme - të cilat synojnë reformën në polici dhe krimin e organizuar - u financua fillimisht midis 2003-shit dhe 2006-s nga programi CARDS i BE-së, bashkë me Greqinë (e cila u fokusua në trafikimin njerëzor), Holandën, OSBE-në, Suedinë, USAID-in dhe UNDP-në. Sigurimi i Shqipërisë është një shqetësim i drejtpërdrejtë i fqinjëve të saj, Italisë dhe Greqisë dhe në qendër të këtij shqetësimi është kujtimi i krizës së 1997-s.

Varfëria, krimi i organizuar dhe korrupsioni janë identifikuar si çështjet sociale kyçe për shoqërinë shqiptare nga Bashkimi Europian, i cili miratoi një program asistence trevjeçar në 2002-shin, me vlerë 144 milionë euro (Montes & Migliorsi, 2004 : 23). Këto para u caktuan për reformën në gjyqësor dhe administrimin publik shqiptar (UNHCR 2004). Shqipërisë iu ritheksua që ajo duhet t'i kushtonte vëmendje të veçantë sektorit të drejtësisë dhe punëve të brendshme nëse do t'i ofrohej Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit. Një raport në 2003-shin vuri në dukje përmirësimet që janë bërë në kontrollin e emigracionit të paligjshëm drejt BE-së, por trafikimi i qenieve njerëzore, drogës dhe formave të tjera të krimit të organizuar si dhe korrupsioni në fushat kyçe si sistemi gjyqësor, doganat dhe policia, mbeten çështje shumë problematike (Komisioni Europian, 2003 : 1).

Fushat prioritare të renditura në këtë raport përfshinin: përpjekjet për të luftuar krimin e organizuar - veçanërisht pastrimin e parave, kontrabandën e drogës dhe trafikimin - fuqizimin e menaxhimit të kufirit, përpjekjet e vazhdueshme



për të kontrolluar lëvizjet e emigracionit prej dhe nga Shqipëria; përmirësimi i menaxhimit të doganave dhe fuqizimi i administratës publike.

Disa agjenci ndërkombëtare dhe donatorët bilateralë, objektivat dhe projektet e të cilëve përputhen, kanë financuar reformën në sektorin e sigurisë në Shqipëri. Së bashku, ata garantojnë reformën në sektorin e sigurisë pothuajse ekskluzivisht sipas kushteve që janë vendosur nga Procesi i Stabilizim-Asocimit.

Për shembull, Programi i Asistencës së Trajnimit Investigimit Kriminal Ndërkombëtar (ICITAP) ka funksionuar që nga 1998-a. Ky projekt, financuar nga Departamenti i Shtetit të SHBA-së (ose USAID), është jashtë fushës së këtij studimi. Megjithatë, është me vend të përmendim që programi lidhet kryesisht me përmirësimin e aftësisë së forcave të policisë shqiptare për t'iu përgjigjur trafikimit të paligjshëm të njerëzve, drogës dhe armëve. Duke u fokusuar mbi çështjet e krimit përtej kufijve, ai përqendrohet në veprimtaritë e porteve të Shqipërisë.

Me shumë rëndësi për studimin tonë është puna e ndërmarrë nga OSBE dhe PAMECA I dhe II (Police Assistance Missions of the European Commission in Albania). Dekadën e fundit, PAMECA e ka përcaktuar reformën në polici në termat e menaxhimit të kufirit; këshillimin dhe trajnimin mbi legjislacionin e BE-së dhe organizimin e reformës së strategjisë; këshillimin dhe trajnimin për krimin e organizuar, antiterrorizmin dhe rendin publik në ndeshjet e futbollit; sigurimin e zgjedhjeve dhe financimin e projekteve të infrastrukturës.

Duke caktuar një këshilltar të posaçëm në Ministrinë e Brendshme të Shqipërisë dhe duke koordinuar punën e zyrtarëve të ministrisë me detyrën e zhvillimit të strategjisë, PAMECA ushtroi ndikim të madh në përcaktimin e trajektoreve të reformës në polici në vend. Financuar nga skema e CARDS e BE-së, administruar nga Komisioni, qëllimi i PAMECA-s është të rrisë kapacitetet institucionale dhe operative të policisë së shtetit shqiptar. Ndonëse fusha e veprimtarisë së saj përfshin reformimin e të gjitha aspekteve të punës së policisë, programi

i kushton një vëmendje të veçantë sferës së krimit të organizuar, terrorizmit dhe menaxhimit të kufirit. Programi kryesisht luan rol këshillues: 10% e 6.8 milionë euro të buxhetit të PAMECA II u shpenzua menjëherë për projektet, ndërsa mbi 5.8 milionë euro shkuan për burimet njerëzore (PAMECA II, 2007). Kjo përfshin sigurimin e ekspertëve nga donatorët kryesorë të reformës në siguri të Shqipërisë: Gjermania, Mbretëria e Bashkuar dhe Italia. Fushat e ekspertizës reflektojnë prioritetet e axhendës së reformës së PAMECA-s: një e pesta e këtyre ishin ekspertë për krimin e organizuar.

Roli parësor i PAMECA-s është një urë lidhëse për fondet për në Shqipëri nga programet e asistencës së Bashkimit Europian. Gjatë periudhës së PAMECA II dhe II, skema e CARDS e BE-së ka investuar mbi 4.6 milionë euro në ndërtimin, pajisjen dhe integrimin e kufijve të Shqipërisë (PAMECA II, 2007). Veç kësaj, trajnimi u sigurua në fushat e menaxhimit të integruar të kufirit, identifikimin e dokumenteve, analizat e riskut të kontrollit të kufirit dhe kontrollin e kufirit bregdetar. Programi kontribuoi gjithashtu në hartimin e legjislacionit të ri për ruajtjen e rendit. Drafti i ri ligjor i Policisë së Shtetit thekson përgjegjshmërinë financiare dhe të burimeve njerëzore brenda policisë shqiptare. PAMECA argumenton që duke e bërë më të vështirë pushimin nga puna, uljen në gradë ose zhvendosjen e policëve të gradës së mesme, menaxhimi do t'i adresohet mënyrës kryesore të mbajtjes së një policie të bindur politikisht. Veç kësaj, drafti ligjor përpiqet të krijojë bordet lokale të sigurisë të ngjashme me modelin e strukturave këshilluese të komunitetit në Britani. Këto aspekte të projektligjit nuk janë integruar mirë as me 10 vitet e strategjisë për reformën në polici apo me qëllimet e policisë së shtetit shqiptar. Ashtu si shpjegoi drejtori i policisë shqiptare: “Ne nuk do të ndjekim projekte që nuk mbulohen nga procesi i stabilizim-asocimit - idetë që i përkasin policimit në komunitet do të jenë pjesë e punës sonë, por qëllimet tona janë të ndalim krimin e organizuar, të përmirësojmë menaxhimin e kufirit dhe të ripajisim policinë”<sup>8</sup>.

---

<sup>8</sup> Ibraj, Bajram, komunikatë personale, Tiranë, korrik 2006.

Në 2007-n dhe 2008-n, Këshilli Europian i dha Shqipërisë 3 milionë euro për të kundërshtuar terrorizmin, ndonëse menaxhimi i integruar i kufirit u cilësua si një aspekt i mirë i qeverisjes (Komisioni Europian, 2009 : 22).

Aktori i tretë ndërkombëtar më i madh në Shqipëri, “prezenca” e OSBE-së në vend, është vetëpërcaktuar si kontribuues në reformën në sektorin e sigurisë. Projektet përfshijnë pajisjen e policisë kufitare dhe sigurimin e trajnimit, trajnimin paraushtarak të policisë, mbështetjen e bashkëpunimit ndërkufitar të policisë dhe shqyrtimin paraprak të azilkërkuesve dhe emigrantëve. E ngjashme me situatën në Mal të Zi, qasja *siguria e para* në Shqipëri duket larg pasigurive të përditshme që zënë mendjet e qytetarëve të thjeshtë shqiptarë.

Ashtu si Mali i Zi, Shqipëria ka një polici të madhe, të mbledhur me nxitim dhe të nënshtruar politikisht. Pas dezertimit masiv të policisë nga jugu i Shqipërisë në 1997-n, një forcë u formua shpejt, duke mbledhur bashkë burra me arsim të ulët dhe të pakualifikuar në ruajtjen e ligjit (PAMECA II, 2007 : 18). Efektet e shpërndarjes së forcave policore të pakualifikuara, në pjesët e vendit ku autoriteti i shtetit u kundërshtua, janë të dukshme edhe sot në Shqipëri. Një anketim i ndërmarrë nga një OJQ lokale, Qendra për Studime Rurale, zbuloi që nga fundi i 2005-s ka pasur pak ndryshim në kushtet që çuan në pakënaqësinë e publikut me këtë situatë sigurie<sup>9</sup>. Gjatë gjithë vendit kishte një rënie të vogël në raportimin e krimit në polici, meqë përgjithësisht besohej që policia nuk do t’i përgjigjej në mënyrën e duhur. Në fakt, 50% e të anketuarve, të cilët kishin raportuar krimet ishin të pakënaqur me përgjigjen e policisë. Në qytetet e jugut, si Gjirokastrë, Vlorë dhe Fier, njerëzit ende tentojnë të shmangin plotësisht policinë, anketimi zbuloi që në Vlorë 23% e banorëve që kishin kontaktuar me policinë pohuan se policia kishte përdorur forcë të panevojshme në takim.

---

<sup>9</sup> Ky anketim, i ndërmarrë më 2005, u krye nga Qendra për Studime Rurale, Rruga “Haxhi Sina”, nr. 4, Tiranë, Albania. Ajo përfshiu një kampion kombëtar prej 2.951 banorësh dhe 983 policë. Veç kësaj, 120 intervistime u bënë të mundura për këtë kërkim nga UNDP në Shqipëri.

Gjithashtu, gjysma e kampionit besonin që policia nuk ishte aspak e fokusuar në kërcënimet më të ngutshme të sigurisë së popullsisë, të cilat, sipas anketimit, lidhen me shpeshhtësinë e vjedhjeve të shtëpive dhe bizneseve, sigurisë në rrugë dhe çështjeve për rendin publik. Mbi 80% e të anketuarve e shihnin vjedhjen, drogën dhe prostitucionin si shqetësimet e tyre më të rëndësishme. Rreth një e katërta e të intervistuarve shprehën shqetësim serioz për mundësinë e tyre për të lëvizur të sigurtë gjatë ditës, ndërsa 37.5% ndjenin se nuk ishte e sigurtë të udhëtoje natën. Ky është një koment tregues në një shtet, i cili, në kohën e studimit, ka qenë subjekt i reformës në sektorin e sigurisë të drejtuar nga BE-ja për më shumë se 6 vite.

Deri tani, policia në Shqipëri mban besnikërinë ndaj partisë në pushtet. Me formimin e çdo qeverie të re, e gjithë fasha e menaxhimit dhe stafi ripozicionohen, pushohen nga puna, ulen ose ngrihen në detyrë. Gjatë këtij kërkimi, autori, në çdo stacion policie, u ndesh me staf dhe menaxhim të caktuar së fundmi nga qeveria e Sali Berishës. Më shumë dekurajuese ishin vështirësitë që hasi autori në lidhje me kontaktimin e policisë në Shqipëri. Kur u pyetën për procedurën e raportimit të një krimi, asnjëri nga kolegët e mi shqiptarë të PNUD nuk ishin në gjendje të më jepnin përgjigje. Ata nuk ishin në gjendje të vendosnin se kujt t'i drejtoheshin: policëve administrativë në terren që janë më pak të kualifikuar dhe me më pak autoritet, policëve të trafikut, apo njësisë së armatosur (njësitë antiterroriste). Në një rast, ne e patëm të pamundur të kontaktonim policinë për të raportuar një aksident të madh rrugor, pavarësisht pranisë së dy anëtarëve të Ministrisë së Brendshme në makinën tonë. Në komisariatit qendror të policisë në Tiranë, studiuesi u informua se kishte vetëm dy telefona dhe një kompjuter të vjetër. Gjithashtu, nuk kishte tavolina policie ku dikush të raportojë një krim të policia shqiptare në komisariatet ushtarake të policisë.

## Qasja e PNUD-it

Mbështetja e PNUD-it për reformën në sektorin e sigurisë (SSSR) përfaqëson aktorin e katërt në reformën e sigurisë shqiptare. Përjasja e saj mund të shihet si një aplikim i parimeve të sigurisë njerëzore. Në këtë projekt, varfëria dhe nënzhvillimi u kuptuan si bazat e ekspozimit të Shqipërisë ndaj krimit të organizuar, trafikimit dhe emigracionit (Pandey, 2005). Krejtësisht e bazuar në nivelin vendor, programi synoi përfshirjen e njësive të policisë vendore, qeverisjes vendore dhe shoqërisë civile në projekte që synuan të krijonin një përjasje të bazuar në komunitet ndaj shqetësimeve lokale për sigurinë. Grantet për zhvillim lidheshin me aftësinë e komunitetit për të formuar “Grupin e komunitetit për të zgjidhur problemet” (CPSG) i aftë për të punuar me policinë vendore në projektet për zhvillim që do të kontribuojnë në sigurinë e lokalitetit. Mbështetja e policisë për projektin u garantua nga premtimi që komisariatet e policisë pjesëmarrëse do të merrnin një sallë recepsioni policie moderne dhe brenda juridiksionit të çdo komisariati, secila zonë rezidenciale u sigurua në “zyrat e përbashkëta”. “Zyrat e përbashkëta” u parashikuan të ishin një nënstacion policie i lokalizuar brenda një zone rezidenciale, i drejtuar nga një polic i gatshëm që e njuh lokalitetin. Së bashku me CPSG, ky polic do të punonte me autoritetin vendor për ta këshilluar dhe marrë pjesë në një projekt për zhvillimin e komunitetit lokal i bashkëfinancuar nga bashkia lokale dhe Mbështetja për Reformën në Sektorin e Sigurisë (SSSR) e PNUD-it. Për rrjedhojë, siguria u përkufizua gjerësisht dhe, brenda frymës së sigurisë njerëzore, në terma zhvillimorë. Përgjithësisht, projektet përfshinin sigurimin e të mirave publike më të nevojshme, si ndriçimi i rrugëve apo adresimin e çështjeve të sigurisë në oborret e shkollave.

Puna e ndërmarrë nga PNUD në qytetin verior të Shkodrës është tregues i përjasjes së përdorur në dhjetë prefektura të tjera në të gjithë vendin. Në komisariatit e policisë në Shkodër, PNUD kontribuoi në ndërtimin dhe pajisjen e një zyre moderne për pasaportat dhe një salle pritjeje; në rindërtimin

e zyrave administrative dhe një korridor brenda ndërtesës; dhe në ndërtimin e një zyre për pagimin e gjobave të qarkullimit rrugor. Ashtu si komisariatet e tjera në të gjithë vendin, komisariati i policisë së Shkodrës ishte në gjendje të keqe. Ndërtesa kishte qenë një kazermë ushtrie dhe nuk ishte bërë asnjë përpjekje për ta transformuar atë për të mundësuar funksionimin si një komisariat policie civil modern. Muret dhe kangjellat e larta fshihnin një ndërtesë të rrënuar e ndërtuar nga italianët në fillim të shek. XX. Gjobat e qarkullimit rrugor dhe aplikimet për pasaportat merreshin përmes të çarave të vogla në këto mure të larta. Nga ana tjetër e mureve, policët punonin në një depo të ftohtë e me lagështirë që ishte ndërtuar pas murit.

Në një mjedis ku policia e centralizuar është besnike ndaj partisë në pushtet dhe ku opozita që drejton qeverisjen vendore dhe qeveria qendrore janë në tension të vazhdueshëm, ky projekt ia doli mbanë të bindte si aktorët institucionalë dhe ato jo institucionalë nga qëndrimet e tyre respektive për të bashkëpunuar. Deri në çfarë shkalle këto projekte ndikuan në kredencialet të asaj që mbetet drejtim i partisë në pushtet, policisë militante dhe jo efektive, është një çështje tjetër. Pavarësisht qëllimeve të mira, projekti nuk kontribuoi në krijimin e një policie më të përgjegjshme (Ryan, 2006). Për këtë përjasje ndaj reformës në sektorin e sigurisë kishte pak entuziazëm nga komuniteti ndërkombëtar. Në 2007-n, Komisioni European tërhoqi financimin e tij që i siguroi PNUD-it dhe kërkoi që të gjitha paratë e pashpenzuara t'i ktheheshin mbrapsht.

## Konkluzione

Reforma në polici është pa dyshim një mjet si për Malin e Zi dhe Shqipërinë drejt integritimit European. Ky artikull argumentoi që reformat janë të drejtuara më shumë drejt BE-së sesa drejt qytetarëve të Shqipërisë dhe Malit të Zi. Reformat **siguria e para** po krijojnë një polici të drejtuar së jashtmi më shumë në mbështetje të synimeve politike dhe ekonomike të këtyre shteteve sesa me shqetësimet për sigurinë e banorëve të tyre. Për rrjedhojë, policia rezulton se është më e shqetësuar për sigurimin e fqinjëve të tyre sesa sigurimin e qytetarëve të vet.

Fushat prioritare të përcaktuara nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit dhe Pakti i Stabilitetit shfaqin dukshëm një qasje në rënie ndaj reformës së sigurisë. Këmbëngulja në kontrollin e kufirit, kontrollin e emigracionit, krimit të organizuar dhe trafikimit paraqet një hierarki përmes së cilës reforma në radhë të parë adreson sigurinë e BE-së, pastaj sigurinë e shtetit në fjalë dhe në mënyrë të tërthortë sigurinë e individëve të atij shteti. Natyra vetëreferuese e reformave i hap rrugë diskutimeve që Ballkani Perëndimor ka qenë siguruar nga BE. Angazhimi i vogël me aktorët socialë nxjerr në pah distancën e madhe midis shqetësimeve reale të përditshme të qytetarëve për sigurinë dhe prioritetet e BE-së dhe aktorëve të tjerë ndërkombëtarë. Kjo përjasje garanton efektivisht që siguria të mbetet jashtë sferës politike. Qasja e PNUD-it në Shqipëri mund të interpretohet si alternativa e fundit për qasjen **siguria e para**.

Megjithatë, duhet të thuhet, që ndonëse PNUD adresoi disa shkaqe strukturore për pasigurinë në Shqipëri, bëri pak për të përmirësuar performancën ose përgjegjshmërinë e policisë shqiptare. Në fakt, kjo ndoshta shërbeu për të legjitimuar një organizatë tërësisht të pareformuar.

Më pak “muskulore” dhe më delikate se arsyetimi i Etzionit, mund të argumentohet se **siguria e para** e zhvendos “efektin e rrjedhjes” neoliberalë nga ekonomia në sferën e sigurisë. Politikëbërësit e BE-së pa dyshim do të pohonin se në fund të fundit se ajo që rrjedh do të jetë e dobishme. Në fund të këtij

procesi, kufijtë e Shqipërisë dhe Malit të Zi do të rregullohen dhe organizohen, kriminalitetit do t'i duhet të shkojë diku tjetër: do të rezultojë një mjedis miqësor ndaj biznesit. Sidoqoftë, në të dyja rastet mund të gjejmë një siguri të pabarabartë publike. Të dyja shtetet kanë polici jo efektive, të papërgjegjshme, të izoluar institucionalisht që mbështet objektivat politike të partive. Kushtet e punës, pajisjet, kapacitetet dhe burimet e disponueshme për këto organizata policore nuk duken të jenë të përshtatshme për të adresuar krimin e brendshëm.

BE-ja duket se po krijon përshtypjen e një sigurie të brendshme, ndonëse thjesht angazhohet në modifikimet teknokratike që ndikojnë kontrollin mbi kufijtë e këtyre shteteve. Rrëmuja e brendshme do të kontrollohet nga skuadrat e policisë paramilitare “antiterroriste” të trajnuara nga ndërkombëtarët. Reformat po izolojnë fqinjët e shteteve anëtare të BE-së nga efektet e mundshme të paqëndrueshmërisë që mund të shkaktohen shumë mirë nga politikat që nuk marrin parasysh nevojat reale të sigurisë të banorëve në Mal të Zi dhe Shqipëri.

*Barry J. Ryan është Senior Teaching Associate  
për Paqen dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Departamentin e Politikës  
dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Lancaster University.*

## Referencat

- Bigo, Didier, 2006. “Internal and External Aspects of Security”, *European Security* 15(4): 385-404.
- Brzoska, Michael, 2006. “Introduction: Criteria for Evaluating Post-Conflict Reconstruction and Security Sector Reform in Peace Support Operations”, *International Peacekeeping* 13(1): 1-13.
- Buzan, Barry & Ole Wæver, 2003. *Regions and Powers: The Structure of International Security*. Cambridge. Cambridge University Press.
- Castaldo, Adriana; July Litchfield & Barry Reilly, 2007. “Who Is Most Likely To Migrate from Albania? Evidence from the



- Albania Living Standards Measurement Survey”, *Eastern European Economics* 45(5): 69-94.
- Council of the European Union, 2004. *The Hague Programme: Strengthening Freedom, Security and Justice in the European Union*, 16054/04. Brussels: Council of the European Union.
- Crampton, Richard J., 2002. *The Balkans Since the End of the Second World War*. London. Longman.
- de Dominicis, Regina, 2003. “High Profits and Low Risks for Montenegrin Smugglers: An Interview with Regina de Dominicis”, *Dan Newspaper* (Podgorica), 12 September.
- Edmunds, Timothy, 2007. *Security Sector Reform in Transforming Societies*. Manchester: Manchester University Press.
- Etzioni, Amitai, 2007. *Security First: Towards a Muscular Moral Foreign Policy*. New Haven, CT: Yale University Press.
- European Commission, 2002. “Cards Assistance Programme to the Western Balkans: Regional Strategy Paper 2002-2006”; available at [http://www.reliefweb.int/library/documents/2001/ec\\_balkans\\_22oct.pdf](http://www.reliefweb.int/library/documents/2001/ec_balkans_22oct.pdf) (accessed 10 March 2009).
- European Commission, 2003. “Albania: Stabilisation and Association Report 2003”, Commission Staff Working Paper, COM(2003) 139 final; available at <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN012931.pdf> (accessed 20 March 2009).
- European Commission, 2006a. *Montenegro 2006 Progress Report*, Sec (2006) 1388. Brussels: Commission of the European Communities.
- European Commission, 2006b. *A Concept for European Community Support for Security Sector Reform*, Sec (2006) 658. Brussels: Commission of the European Communities.
- European Commission, 2008. “Montenegro – Financial Assistance”; available at [http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/montenegro/financial\\_en.htm](http://ec.europa.eu/enlargement/potential-candidate-countries/montenegro/financial_en.htm) (accessed 12 March 2009).
- European Commission, 2009. “EU Regionally Relevant Activities in the Western Balkans”, Commission Staff Working Paper, Sec (2009) 128. Brussels: Commission of the European Communities; available at [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key\\_documents/highlight/eu\\_regional\\_wester\\_balkans\\_2008-2009\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/highlight/eu_regional_wester_balkans_2008-2009_en.pdf) (accessed 11 March 2009).

- European Commission, n.d. a. "The Commission Presents Its First Political Assessment of Progress in Implementing The Hague JLS Programme"; available at [http://ec.europa.eu/justice\\_home/news/information\\_dossiers/the\\_hague\\_2006/index\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice_home/news/information_dossiers/the_hague_2006/index_en.htm) (accessed 12 March 2009).
- European Commission, n.d. b. "Cards Action Programme 2006 for Montenegro"; available at [http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/summary\\_cards\\_ap\\_2006\\_montenegro\\_sector\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/montenegro/summary_cards_ap_2006_montenegro_sector_en.pdf) (accessed 12 March 2009).
- Friis, Karsten, 2007. "The Referendum in Montenegro: The EU's "Postmodern Diplomacy"", *European Foreign Affairs Review* 12(1): 67–88.
- Gallagher, Tom, 2003. "Identity in Flux, Destination Uncertain: Montenegro During and After the Yugoslav Wars", *International Journal of Politics, Culture and Society* 17(1): 53–71.
- Glenny, Misha, 2008. *McMafia*. New York: Random House.
- Günther, Klaus, 2005. "World Citizens Between Freedom and Security", *Constellations* 12(3): 379–391.
- Holm, Tor Tanke & Espen Barth Eide, 2000. *Peacebuilding and Police Reform*. London: Frank Cass.
- INSTAT, 2002. "The Population of Albania in 2001: Main Results of the Population and Housing Census". Tirana: INSTAT.
- Kaldor, Mary; Mary Martin & Sabine Selchow, 2007. "Human Security: A New Strategy Narrative for Europe", *International Affairs* 83(2): 273–288.
- Lavanex, Sandra, 2004. "EU External Governance in "Wider Europe"", *Journal of European Public Policy* 11(4): 680–700.
- Lutterbeck, Derek, 2004. "Between Police and Military", *Cooperation and Conflict* 39(1): 45–68.
- MacFarlane, S. Neil & Yuen Foong Khong, 2006. *Human Security and the UN: A Critical History*. Indianapolis, IN: Indiana University Press.
- Montes, Carlos & Stefano Migliorsi, 2004. "EU Donor Atlas: Mapping Official Development Assistance"; available at [http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/Donor\\_Atlas\\_en.pdf](http://ec.europa.eu/development/icenter/repository/Donor_Atlas_en.pdf) (accessed 11 March 2009).
- Neocleous, Mark, 2007. "Security, Liberty and the Myth of Balance: Towards a Critique of Security Politics", *Contemporary Political Theory* 6(2): 131–149.

- Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), 2003. "Police Reform Developments in Serbia and Montenegro", OSCE Law Enforcement Newsletter no. 3; available at <http://www.osce.org/serbia/publications.html?lsi=true&limit=10&grp=350> (accessed 12 March 2009).
- Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), 2004. *Community Policing in Montenegro: Public and Police Perception Surveys 2004*. Podgorica: OSCE Mission to Serbia and Montenegro.
- Organization for Security and Co-operation in Europe (OSCE), 2005. "Police Reform Developments in Serbia and Montenegro", OSCE Law Enforcement Newsletter no. 4; available at [http://www.osce.org/publications/fry/2005/05/18200\\_541\\_en.pdf](http://www.osce.org/publications/fry/2005/05/18200_541_en.pdf) (accessed 12 March 2009).
- PAMECA II, 2007. *PAMECA II Final Report 18 Dec 2004 - 17 Dec 2007*. Tirana: PAMECA.
- Pandey, Kalyan, 2005. "Community Mobilization for Fostering Participative Local Democracy", paper presented at the conference on "Local Development and Governance in Central, East and South East Europe", OECD LEED Centre for Local Development, Trento, Italy, 6–8 June.
- Ryan, Barry J., 2006. "An Evaluation of the UNDP's Support to Security Sector Reform in the Republic of Albania". New York: UNDP Bureau for Crisis Prevention and Recovery; available at: [http://www.undp.org/cpr/documents/jssr/ssr/UNDP\\_Support\\_Albania.pdf](http://www.undp.org/cpr/documents/jssr/ssr/UNDP_Support_Albania.pdf) (accessed 20 March 2009).
- Ryan, Barry J., 2007. "Quasi-Pluralism in a Quasi-Peace: South Serbia's Multi-Ethnic Police", *International Peacekeeping* 14(2): 282-297.
- Sen, Amartya, 1999. *Development as Freedom*. Oxford: Oxford University Press.
- Solana, Javier, 2002. "The European Union and the Organization for Security and Cooperation in Europe: The Shape of Future Cooperation", an address to the OSCE Permanent Council, Vienna, 25 September.
- Solana, Javier, 2003. *A Secure Europe in a Better World: European Security Strategy*. Brussels: EU Institute for Security Studies.
- Trauner, Florian, 2007. "EU Justice and Home Affairs Strategy in the Western Balkans: Conflicting Objectives in the Pre-

- Accession Strategy”, Working Document no. 259. Brussels: Centre for European Policy Studies; available at [http://shop.ceps.eu/BookDetail.php?item\\_id=1469](http://shop.ceps.eu/BookDetail.php?item_id=1469) (accessed 12 March 2009).
- UNHCR, 2004. “Country Operations Plan Albania 2004”; available at <http://www.unhcr.org/home/PROTECTION/3f8c0fc54.pdf> (accessed June 2007).
- UNICEF, 2000. “Assessment of Social and Economic Conditions of Districts in Albania”; available at <http://www.unicef.org/albania/assessmentofsocioeconomicconditions.pdf> (accessed 25 March 2009).
- US Department of State (n.d.). “Background Note: Montenegro”; available at <http://www.state.gov/r/pa/ei/bgn/70949.htm> (accessed 10 March 2009).
- Vickers, Miranda, 2006. *The Albanians*. London. I. B. Tauris.
- Williams, Michael & Keith Krause, 1997. *Critical Security Studies: Concepts and Strategies*. London: Routledge.
- Youngs, Richard, 2008. “Fusing Security and Development: Just Another Euro-Platitude?”, *European Integration* 30(3): 419–437.

ILIR KALEMAJ

## LIGJËRATA E BE-SË NË POLITIKËN ELEKTORALE: KËRCËNIMI I PERCEPTUAR I KRIMIT TË ORGANIZUAR SHQIPTAR DHE EUROPIANIZIMI I ELITËS SHQIPTARE

Krimi i organizuar në dhe nga Ballkani Perëndimor është bërë një problem kërcënues për Bashkimin Europian. Këndvështrimi i BE-së mbi krimin e organizuar është se ai përbën një “kërcënim madhor për sigurinë e brendshme dhe procesin demokratik”.<sup>1</sup> Raportet pasuese, vlerësimet e kërcënimit dhe formulimet që i adresohen këtij kërcënim janë ngritur në disa raste nga zyrtarë të ndryshëm të BE-së. Ky artikull ka të bëjë në radhë të parë me mënyrën se si kërcënim i krimit të organizuar shqiptar, i lidhur me një varg fenomenesh, të tilla si korrupsioni i zyrtarëve shqiptarë dhe rreziku i “zënies rob të shtetit”, ka formësuar retorikën e BE-së drejt Shqipërisë dhe se si ka kundërvepruar elita shqiptare. Me fjalë të tjera si e ka brendësuar Shqipëria ligjëratën e BE-së dhe si kjo ka ndikuar politikën elektorale shqiptare dhe debatin publik?

Argumenti kryesor që shtjellon ky artikull është që ligjëratat e kërcënimit të krimit të organizuar është konceptualizuar qëllimisht në një mënyrë stereotipike, duke i dhënë krimin një ngulitje etnike, në mënyrë që BE-ja të mund të mbajë lidhjen e saj normative pavarësisht një largësie nga një realitet objektiv që kjo ligjëratë ka prodhuar. Duke e parë në këtë perspektivë, artikulli kërkon të tërheqë vëmendjen për disa ide të gabuara të konsiderueshme që analizojnë vjetari i BE-së,

---

<sup>1</sup> Përgjigja e BE-së për Krimin e Organizuar. Marrë nga: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org.crime\_files\The EU's Response To Organized Crime.mht, (12 March 2007).

i cili mat empirikisht nivelin e krimit dhe të korrupsionit në Shqipëri. Artikulli merr një këndvështrim kritik në këtë retorikë të dyfishtë që shkon në të dy anët dhe përpiqet të tregojë perceptimet dhe keqperceptimet që ka prodhuar ky proces i “brendësimit” të BE-së në sferën e brendshme shqiptare. Kjo ligjëratë “perëndimore” ka riprodhuar një efekt bumerang, ku elitat politike shqiptare artikulojnë të njëjtën ligjëratë kritike mohuese, në trajtimin e krimit, mafias dhe korrupsionit si problemi më i madh me të cilin përballlet shteti, edhe pse kjo nuk korrespondon me realitetin që percepton shumica e popullsisë shqiptare.<sup>2</sup>

Kjo ese përbëhet nga katër pjesë kryesore. Së pari, artikulli nis me një rishikim të përgjithshëm të literaturës së europianizuar, më specifikisht të vështruarit e difuzimit të ideve dhe ndërkombëtarizimin e normave, vlerave dhe retorikës politike të BE-së nga shtetet që aspirojnë të jenë pjesë e Bashkimit, sidomos Shqipëria. Së dyti, artikulli fokusohet veçanërisht në rolin e kërcënimit të perceptuar që vjen nga Krimi i Organizuar Shqiptar.<sup>3</sup> Në këtë konsideratë, analizohet ligjërata e BE-së e ngulitur në një sërë raportesh për problemet kryesore dhe/ose pengesave të Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritimit europian. Në pjesën më të madhe artikulli fokusohet në burimet primare, si raportet e vlerësimit të kërcënimit nga Europoli dhe formulimet nga Këshilli i Bashkimit Europian, të cilat shërbejnë si direktiva (udhërrëfyes) që udhëheqin drejt veprimeve të mëpasshme të BE-së. Së treti, ai diskuton politikën dhe strategjitë e BE-së për t’u marrë me këtë kërcënim. Së katërti, artikulli ka si qëllim

---

<sup>2</sup> Për problemet kryesore të elektoratit shqiptar, shiko Tabelën 2, te Blendi Kajsio, *Integrimi si një pengesë për demokratizimin*. Polis 2, (Tiranë, 2006), fq. 16. Të dhënat empirike tregojnë se shqetësimi kryesor i popullsisë shqiptare janë papunësia, infrastruktura, pagat dhe pensionet.

<sup>3</sup> Në këtë artikull unë përdor termin “Shqipëria etnike” për t’iu referuar shqiptarëve në përgjithësi, duke i rënë përmes kufijve shtetërorë, në një mënyrë të ngjashme me raportet e vlerësuara nga Europoli dhe dokumente të tjera zyrtare që përdorin të njëjtin konotacion. Sidoqoftë, e kuptoj se ky term është më tepër i përdorur për t’iu referuar shqiptarëve që ndodhen jashtë shtetit shqiptar, për arsye historike, gjuhësore dhe implikimeve të tjera.

të analizojë perceptimet publike të elitave shoqërore dhe politike shqiptare<sup>4</sup> në lidhje me retorikën europiane të kërcënimit që parashtron krimi i organizuar shqiptar. Metodologjia fokusohet në analizën e ligjëratës dhe në një trajtim epistemologjik dhe ontologjik të burimeve parësore dhe dytësore për efektet e retorikës së BE-së në politikën e brendshme të Shqipërisë.

## Rishikim mbi europianizimin

Europianizimi është njëherësh një fushë e re kërkimore në studimet e BE-së dhe e hapur ndaj një grupimi të gjerë përkufizimesh dhe interpretimesh nga autorë të ndryshëm. Risse et al., e kanë përkufizuar europianizimin si “shfaqjen dhe zhvillimin e strukturave të veçanta të qeverisjes në një nivel europian”.<sup>5</sup> Me këto struktura ata nënkuptojnë, “institucionet politike, ligjore dhe sociale të shoqëruara me zgjidhjen politike të problemit që formalizon ndërveprimet midis aktorëve dhe rrjeteve politike të specializuara në krijimin e rregullave autoritare evropiane”.<sup>6</sup> Ky është një përkufizim i gjerë, por vuan paksa nga një zgjatim konceptual. Radaelli observoi në mënyrë korrekte se një përkufizim më i ngushtë i europianizimit mund të jetë më mirë i përshtatshëm dhe mund të ofrojë një kuptim më të shtrenguar të konceptit. Me fjalë të tjera, ashtu si nënvijëzon autori: “duhet të jetë e ndryshme dhe më shumë e përzgjedhur se sa nocioni i përpunimit të politikave të BE-

---

<sup>4</sup> Që kur dokumentet e BE-së i referohen shpesh rrezikut të “shqiptarëve etnikë”, pa ndonjë dallim, siç u theksua edhe më sipër, eseja vështron si në sferën e brendshme shqiptare edhe atë kosovare, për të analizuar europianizimin e debatit publik.

<sup>5</sup> Risse, Thomas dhe Maria Green Cowles dhe James Caporaso (2001): *Europeanization and Domestic Change: Introduction* in Risse, Cowles and Caporaso (eds): *Transforming Europe: Europeanization and Domestic Change (Europianizimi dhe Ndryshimi i Brendshëm: Hyrje të Risse, Cowles dhe Caporaso (eds): Duke transformuar Europën: Europianizimi dhe Ndryshimi i Brendshëm)* (Cornell University Press), 1-20. fq.3

<sup>6</sup> *Ibid*

së dhe Integritimit European”.<sup>7</sup> Përkufizimi i tij se çfarë i referohet europeanizimi është:

Europeanizimi konsiston në proceset e (a) ndërtimit, (b) përhapjes dhe (c) institucionalizimit të normave formale dhe jo formale, procedurave, paradigmave të politikave, llojeve, “mënyrave të të bërit të gjërave dhe besimeve të ndara dhe normave të cilat fillimisht u përkufizuan dhe u konsoliduan në procesin e politikave të BE-së dhe më pas u përfshinë në logjikën e ligjëratisë (kombëtare dhe nënkombëtare) së brendshme, identiteteve, strukturave politike dhe politikave publike”.<sup>8</sup>

Përkufizimi i dytë duket më i përshtatshëm për të përmbledhur dinamikën e ligjëratisë së BE-së dhe mënyrën se si ajo shkrihet në sferën e brendshme nga shtetet aspiruese të BE-së, për arsye të shpjegimit më të gjerë dhe më të plotë që ofron. Ai fokusohet në proceset përmes të cilave normat europiane janë përfshirë brenda logjikës së politikave të brendshme dhe jetës publike. Radaelli, gjithashtu nxjerr në pah që “ligjëratat mund të ndryshojë preferencat e aktorëve, të riformulojë problemet e politikave” ose të ndryshojë stilet dhe vlerat e burimeve.

Autorë të tjerë i janë referuar europeanizimit si “reformësim i identiteteve në Europën bashkëkohore në një mënyrë që relativizon (jo domosdoshmërisht zëvendëson) identitetet kombëtare.”<sup>9</sup> Nëse e vlerësojmë ndryshe, është përhapja tejkombëtare e zakoneve të përditshme, ideve dhe traditave

---

<sup>7</sup> Claudio Radaelli, “The Europeanization of Public Policy” (*Europeanizimi i Politikës Publike*) në Kevin Featherstone dhe Claudio Radaelli eds., *The Politics of Europeanization. (Politikat e europeanizimit)* Oxford: Oxford University Press, 2004. fq.29.

<sup>8</sup> Ibid., fq. 30. gjithashtu shiko Radaelli, Claudio M. “Europeanization, solution or problem? European Integration on line Papers (*Europeanizimi, zgjidhje apo problem? Dokumentat on line të Integritimit European*) Vol. 4 (2000) No 15; <http://ciop.or.at/ciop/texte/2000-015a.htm>

<sup>9</sup> R. Harmsen dhe Wilson, T. M. “Introduction: Approaches to Europeanization” (*Hyrje: Qasjet drejt Europeanizimit*) Yearbook of European Studies 14: 13-26. 2000.



nga Brukseli drejt kryeqyteteve kombëtare që përfshin dhe brendëson këto norma. Duke iu rikthyer formulimit të Radaelli-t të pushtetit të ligjëratisë së BE-së për të prekur preferencat e aktorëve kombëtarë në atë masë që ata të “riformulojnë problemet e politikës”, deri sa t’i pajtohet rregullave dhe rregullimeve të BE-së, mendoj se ky është një mjet i fuqishëm në kuptimin e proceseve në vazhdim në disa nga vendet aspiruese që kërkojnë t’i bashkohen BE-së sa më shpejt. Unë i referohem këtu si vendeve të asociuara edhe atyre candidate, sidomos vendeve të Ballkanit Perëndimor, të cilat shpesh shihen si “oborri i pasmë” i Europës. Këto vende pritet t’i bashkohen normalisht BE-së në të ardhmen, por jo deri sa ato të përmbushin kriteret e plota të BE-së, qoftë formalisht (p.sh.: implementimi i *acquis communautaire* ose pajtimi me kriteret e Kopenhagenit) ose jo formalisht (përvetësimi dhe përfshirja e vlerave, ligjëratisë, politikave publike dhe strukturave politike të BE-së në hapësirën e brendshme.) Më poshtë, është marrë në analizë rasti i Shqipërisë.

Shqipëria është një rast interesant, sepse ka një konsensus të përhapur midis klasës së saj politike, po aq sa edhe në media dhe shoqërinë civile që anëtarësimi në Bashkimin Europian është qëllimi më i dëshirueshëm për t’u arritur. Gjithashtu, disa sondazhe në shkallë vendi kanë treguar se më tepër se 90% e popullsisë mbështet integrimin e Shqipërisë në BE, e cila deri më tani është shkalla më e lartë e një vendi të asociuar ose kandidat. Veç kësaj, Shqipëria është marrë në analizë për arsye të referimit të vazhdueshëm të BE-së në problemet e Shqipërisë me krimin e organizuar dhe korrupsionin dhe vullnetit të pakët të shtetit për të luftuar këto fenomene. Dhe së fundmi, Shqipëria është e habitshme, sepse në vend që aktorët e jetës publike të Shqipërisë t’i refuzonin vendosmërisht këto akuza, ne jemi çuditërisht të përballur me të njëjtën retorikë në sferën e brendshme të Shqipërisë, ku politikanët e përdorin shpesh këtë retorikë europiane për të fajësuar njëri-tjetrin, sidomos për përfitimet elektorale.

## Perceptimi i BE-së për kërcënimin e krimit të organizuar shqiptar

Në një takim ministerial JHA më 2003, pjesëmarrësit vërejtën se:

Krimi i organizuar dhe korrupsioni janë pengesa për stabilitetin demokratik, zërin dhe përgjegjësinë e institucioneve, rendin ligjor dhe zhvillimin ekonomik në Ballkanin Perëndimor. Fokusi i veçantë duhet vendosur në luftimin e çdo lloj forme të trafikimit, veçanërisht të qenieve njerëzore, drogave dhe armëve, si dhe kontrabandës së të mirave.<sup>10</sup>

Pavarësisht vullnetit të fortë që është shprehur në fjalimin e mësipërm, ai i ngjan më shumë një mendimi të dëshirueshëm se sa një projekti për veprimin në të ardhmen. Megjithatë, politikat e BE-së, si Strategjia Europiane e Sigurisë (SES) e cila merret me kërcënimet më të perceptuara nga shtetet europiane, janë më së shumti të informuara nga raportet e Europolit, që dalin çdo vit. Europoli mbështet aktivitetet e zbatimit të ligjit të Shteteve Anëtare kundër një shumëllojshmërie të krimeve, duke vënë theksin mbi targetimin e organizatave kriminale. Europoli është themeluar nga kontributet e shteteve anëtare në një mënyrë proporcionale, duke iu referuar GNP-së së tyre.<sup>11</sup> Qëllimi i tij kryesor është të krijojë një “organizatë politikash europiane përtej kufijve”. Europoli është përshkruar si një përpjekje për të krijuar “FBI-në evropiane”, duke luajtur një rol vendimtar në asistimin e përforcimit të ligjeve të agjencive kombëtare për të luftuar krimin.<sup>12</sup>

---

<sup>10</sup> “Forumi BE - Ballkani Perëndimor”, *JHA Ministerial Meeting Brussels, (JHA Takimi ministerial në Bruksel)*, 28 nëntor 2003. *Joint Conclusions. (Konkluzionet e përbashkëta)* SN 3559/1/03, Rev 1. Bruksel 28 nëntor 2003. fq. 2.

<sup>11</sup> Është me rëndësi të vërejmë këtu se buxheti i tij për 2006 ishte 63.4 milionë euro.

<sup>12</sup> Përgjigja e BE-së për krimin e organizuar. Marrë nga: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org.crime\_files\The EU's Response To Organized Crime.mht, 12/03/2007.

Një raport i Europolit i vitit 2003 theksoi se grupet e KO (krimit të organizuar) po bëhen më tepër profesionale dhe më heterogjene. Duke marrë në referencë grupet kriminale në Shqipëri, ai shprehet se: “grupet etnike shqiptare të KO-së vazhdojnë të jenë ndër kërcënimet kryesore të BE-së, si edhe të vendeve hyrëse dhe Norvegjisë.<sup>13</sup> Ai vazhdon të përshkruajë karakteristikat e këtyre grupeve, e cila përfshin, *ndër të tjera*, ndarjen e veçorive të njëjta tradicionale të grupeve, edhe pse kjo tendencë është duke ndryshuar gradualisht me ndërveprimin me grupe të tjera kriminale dhe përfshirjen e anëtarëve të jashtëm të krimit të organizuar nga vende të tjera. Aktivitetet e tyre kryesore fokusohen në kontrabandën e drogës dhe trafikimin njerëzor. Gjithashtu, është vënë re se “[një] nga veçoritë kyçe të grupeve kriminale shqiptare është forma e tyre e instrumentalizuar nga roli i tyre si lehtësues dhe ofrues shërbimesh për të themeluar grupe të KO-së, duke marrë përsipër disa tregje kriminale menjëherë sapo ata kanë siguruar njohuritë e duhura”.<sup>14</sup> Shembujt e përmendur në raport, flasin për marrjen në dorëzim të tregjeve të paligjshme nga trafikuesit turq, ose të industrisë së prostitucionit britanik. Akoma, shqiptarët etnikë ruajnë rolin e tyre si “ndërmjetësues për grupet kolumbiane të KO-së të përfshira në kontrabandën ndërkombëtare të kokainës”.<sup>15</sup>

Gjithashtu, në një raport për krimin e organizuar nga Këshilli i BE-së më 2005, retorika u përqendrua në faktin se zgjerimi i BE-së vetëm sa ka forcuar kërcënimin nga krimi i organizuar, ndonëse nën një paraqitje të re. Ai gjithashtu thekson rritjen e heterogjenitetit të këtyre grupeve dhe aftësive të reja që ata zotërojnë. Më specifikisht, ai përmend grupet etnike shqiptare dhe turke si ekzistencën e problemit më madhor në një BE me një numër në rritje të shteteve anëtare<sup>16</sup>.

---

<sup>13</sup> Europol: 2003 Raporti i Bashkimit European mbi krimin e organizuar, fq. 14.

<sup>14</sup> *Ibid*

<sup>15</sup> *Ibid*

<sup>16</sup> Këshilli i Bashkimit European: 2005 Organized Crime Report: Public Version ( *Raporti i Krimit të Organizuar 2005: Versioni Publik*). Bruksel, 17 nëntor 2005.

Shqiptarët etnikë shiheshin në raport si një nga grupet kriminale që po rritet më shpejt.

Grupet etnike shqiptare po shkallëzohen nga të qenit thjesht ofrues shërbimesh në një njësi të Krimin të Organizuar ndërkombëtar. Ata janë hierarkikë dhe homogjenë, por bashkëpunojnë me gatishmëri dhe mjeshtëri me grupe të tjera të Krimin të Organizuar. Ata janë kryesisht të përfshirë në trafikun e drogës dhe të qenieve njerëzore, përdorimit të prostitucionit, lehtësimit të imigrimit ilegal dhe të gjithë llojeve të krimeve standarde.<sup>17</sup>

Ky raport i referohet gjithashtu edhe aspekteve të tjera të kërcënimit prej krimin të organizuar nga shqiptarët, të cilët kanë marrë më parë vetëm një vëmendje të lehtë. Një aspekt i tillë ishte roli në rritje i Shqipërisë si një vend për akumulimin e kokainës, përpara shpërndarjes në BE.<sup>18</sup> Ndonëse raporti tregoi se, tani për tani, vendet e Europës Lindore nuk shërbejnë si tregje, nuk ka garanci që kjo tendencë do të mbahet edhe në të ardhmen. Me fjalë të tjera, raporti i Këshillit jo vetëm informon, por gjithashtu ofron parashikime që mund të përdoren për zbatimin e politikave në të ardhmen nga Komisioni ndërsa skicon politikat e tij lidhur me këtë çështje. Në anën tjetër, duket se grupet etnike shqiptare janë duke u bërë më profesionale dhe të sofistikuara në biznesin e paligjshëm të krimin të organizuar ku ata janë përfshirë. Në lidhje me dhunën, për shembull, “Sot shqiptarët tentojnë të përdorin më pak dhunë për të reduktuar ndikimin social të krimeve të tyre.”<sup>19</sup> Nga të dhënat e prezantuara deri tani, duket se tendenca e krimin shqiptar është në rritje dhe duke u bërë një kërcënim i qartë për BE-në.

Raporti vjetor i Europolitit i 2005-s, prapëseprapë ka vetëm një referencë, ai i referohet në veçanti grupeve të KO-së të shqiptarëve etnikë. Kështu bën kur ai përshkruan një operacion të bashkuar midis autoriteteve të zbatimit të ligjit të Italisë,

---

<sup>17</sup> 2005 Raporti i Këshillit, fq. 5.

<sup>18</sup> 2005 Raporti i Këshillit, fq. 10

<sup>19</sup> *Ibid*

Belgjikës dhe Holandës, që çoi në “arrestimin e 28 personave njehërësh”.<sup>20</sup> Ai ishte një operacion që konsistonte në bashkëpunimin e ngushtë të forcave gjyqësore dhe policore në këto tre shtete, ndërsa mandati i arrestit ishte lëshuar nga Zyra e Prokurorisë në Breshia, Itali.<sup>21</sup> Por duke konsideruar referencat gjithëpërfshirëse në raportin e mëparshëm dhe retorikën e përdorur në forumet e tjera të zyrave europiane të politikëbërjes, duket se as kërcënimi nuk është reduktuar, dhe se Europoli është thjesht duke kundërshtuar vlerësimet e tij të mëparshme. Një hipotezë e mëtejshme mund të jetë që vlerësimet për kërcënimin ishin vënë në vend të parë në mënyrë të ekzagjeruar.

## Politika e BE-së e skicuar për Shqipërinë

Duke qenë se nuk është qëllimi im të analizoj faktorët themelorë që çojnë në të tilla raporte të dukshme të diferencuara dhe formulime nga zyrtarët publikë europianë, po i kthehem tani politikës së skicuar të Brukselit për Shqipërinë dhe Kosovën, duke dalluar konkluzionet empirike nga formulimet publike të zyrtarëve dhe medias. Patrick Moore, në një artikull mendjemprehtë më 2005, argumenton se:

Për Brukselin, integrimi i Ballkanit Perëndimor nënkupton që aty nuk do të ketë më një “vrimë të zezë” në mes të BE-së - veçanërisht pas anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë - në të cilin **lulëzon** hija e krimit të organizuar. Përmes ofrimit të perspektivës së anëtarësimit, BE ka një levë të fuqishme për të influencuar saktësisht llojet e ndryshimeve - të quajtur “reforma” - që ajo dëshiron t’i shohë të zbatuara.<sup>22</sup>

---

<sup>20</sup> Europol: Europol Annual Report 2005 (*Raporti vjetor i Europolit 2005*), Hagë, 22 mars 2006, Dosja nr. 1423- 39r2 (#166073). Daunloduar nga: [www.statewatch.org/news/2006/apr/europol-report-2005.pdf](http://www.statewatch.org/news/2006/apr/europol-report-2005.pdf), fq. 6

<sup>21</sup> *Ibid*

<sup>22</sup> Patrick Moore. “Western Balkans: Is there life outside the EU?” (*“Ballkani Perëndimor: A ka jetë jashtë BE?”*), 16 shtator 2005. Daunloduar nga: <http://www.rferl.org/featuresarticle/2005/09/0169a1b5-e9a4-469d-8ad6-1e876b5b572f.html>

Megjithatë, pa mbështetje institucionale dhe financiare, retorika e BE-së, duke filluar me samitin e Selanikut, mund të kthehet në një lloj të “mashtrimit të dyfishtë, në të cilën BE pretendon të ofrojë anëtarësimin, ndërsa vendet e rajonit pretendojnë të zbatojnë reformat”<sup>23</sup> Kjo retorikë “boshe” nuk do të shërbej për gjë, në më të mirën e saj ajo mund të mbrojë *status quo*-në e pashpresë, ndërsa në më të keqen e saj, ajo mund të provokojë dëshpërim dhe shqetësim. E nxjerr këtë argument në pah sepse nëse kushtet e rajonit nuk përmirësohen, në vende si Kosova dhe Shqipëria do të vazhdojë të lulëzojë strehimi i krimit të organizuar.

E parë në këtë dritë, një pikë e rëndësishme është edhe roli që ESDP duhet të luajë në ndalimin e krimit të organizuar, sidomos kur ai shfaqet jashtë kufijve të BE-së, por ende brenda “oborrit të pasmë” të Europës, si në rastin e Ballkanit Perëndimor. Kjo pikë ka një vlerë të brendshme për diskutim, sepse zona është mikpritëse e popullsisë së shqiptarëve etnikë dhe gjithashtu ka qenë karakterizuar nga shqetësime dhe konflikte. Më e rëndësishme është se nëse misioni i ri i BE-së në Kosovë, EUMIK, dështon në vendosjen e rendit dhe stabilitetit në vend, Kosova mund të kthehet në një shtet të dështuar, shoqëruar me një shkallë të lartë të konfliktit etnik. Ashtu si sugjeroi Alistair Shepherd:

Kur ka konflikt dhe dështim të shtetit, krimi i organizuar shpesh lulëzon. Duke limituar dhe ndryshuar konfliktin dhe dështimin e shtetit, BE mund të ndihmojë kufizimin e përhapjes së krimit të organizuar. ESDP do të jetë thjesht një instrument politik në luftimin e krimit të organizuar dhe veprimeve të BE-së jashtë kufijve të saj në stabilizimin e shteteve dhe rajoneve që do të duhet të plotësohen nga veprimet brenda dhe jashtë kufijve të BE-së.<sup>24</sup>

---

<sup>23</sup> Stefan Lehne. “Has the ‘Hour of Europe’ come at last? The EU’s strategy for the Balkans,” (*A ka ardhur më në fund “Ora e Europës”? Strategjia e BE për Ballkanin*) në Franz Lothar Altmann et al. “The Western Balkans: moving on.” (*Ballkani Perëndimor: duke ecur përpara*) Judy Batt ed. *Chaillot Paper*, n. 70, tetor 2004. fq. 121- 122.

<sup>24</sup> A. J. K. Shepherd, “Irrelevant or Indispensable? ESDP, “War on Terror” and the fallout from Iraq” *International Politics (I parëndësishëm apo i Domosdoshëm? ESDP, “Lufta në Terror” dhe dalja nga Iraku*” *Politikat Ndërkombëtare*) 43: 82. 2006.

Në një linjë me argumentin e Shepherd, ne mund të argumentojmë se vetëm nëse BE është plotësisht e përgatitur të marrë në një vëmendje të veçantë, sidomos në lidhje me Kosovën, do të kemi të pranishëm rrezikun që Kosova të bëhet një shtet i dështuar dhe rrjedhimisht një eksportues i krimit të organizuar. Prandaj, nëse ESDP nuk zhvillon disa masa përgatitore brenda misionit të ri të EUMIK që do të fillojë të jetë veprues së shpejti, misioni është i dënuar të dështojë dhe fjalët nuk do të përputhen me faktet. Këto “masa përgatitore” duhet të përziejnë logjistikën me planifikimin e politikave afatgjata, me një fokus të veçantë në stimulimin e rritjes ekonomike dhe prosperitetit si qëllimin e saj kryesor. Kjo vetëm sa do të shtojë besueshmërinë në retorikën e BE-së dhe njëkohësisht, të reduktojë kërcënimin e krimit të organizuar, që vjen nga rajoni dhe veçanërisht nga Kosova.

Por politikëbërës të tjerë të BE-së duket të kenë zhvendosur retorikën në anën tjetër, duke e lënë topin në oborrin shqiptar. Solana e bëri këtë të qartë, kur ai nënvijëzoi se:

Ne po bëjmë gjithçka që kemi në dorë për të luftuar krimin e organizuar. Por ky krim i organizuar nuk është europian, ai është Kosovar. Kështu që, i përket Kosovarëve të luftojnë krimin e organizuar sepse është një krim Kosovar dhe kjo duhet mbajtur mend mirë.<sup>25</sup>

Kështu që, është e qartë që zhvendosja e retorikës në nivelet më të larta të politikëbërjes në BE duket se provokon po ashtu një zhvendosje të përgjegjësisë, duke ia deleguar një pjesë të obligimeve për të parandaluar krimin, atdheut të këtyre emigrantëve, përpara se të bëhet kërcënim për vendet e tjera. Por është vetëm një mendim i dëshirueshëm të presësh që një vend ende i menaxhuar nga të huajt si Kosova, të jetë i gatshëm të përballet me kërcënimet e sigurisë së brendshme që mund të përshkallëzohen në kërcënime më të gjera në një periudhë afatgjatë. Në anën tjetër, politikëbërja në nivelin europian disa

---

<sup>25</sup> Cituar në Forumin BE - Ballkan Perëndimor, *JHA Ministerial Meeting Brussels, (JHA Takimi ministerial në Bruksel)*, 28 nëntor 2003. *Joint Conclusions (Konkluzionet e përbashkëta)*. SN 3559/1/03, REV 1. Bruksel, 28 nëntor 2003.

herë është e influencuar nga raportet e shtrebbëruara të medias që paraqesin një pamje të errët të realitetit.

## Reagimi shqiptar nga retorika e BE-së

Si paraqiti edhe një analist shqiptar nga Kosova: “Politikanët e Kosovës nuk reagojnë edhe kur një e përditshme me influencë të madhe, si “Der Spiegel”, shkruan se përfitimet nga biznesi i drogës shkojnë deri në gjysmën e buxhetit, për afërsisht 350 milionë euro”.<sup>26</sup> Edhe pse Robelli e hedh fajin mbi politikanët e Kosovës që nuk i përgjigjen akuzave të tilla, të cilat nuk mund të provohen, ende fakti mbetet që autoritetet kosovare kanë pak ose aspak pushtet për t’u marrë me këmbëngulje me rritjen e vazhdueshme të krimit të organizuar. Kryesisht kjo ka të bëjë me faktin se shumica e autoriteteve është nën robën e UNMIK dhe trupave të NATO-s.

Sipas ish-kryeministrit kosovar Bajram Rexhepi: “...pa asnjë hartë udhërrëfyese, ose pa afateve të përcaktuara politike, ose pa një sens të zgjidhjes së statusit të tyre të paqartë ndërkombëtar si një entitet jo shtetëror, kosovarët janë duke e humbur shpresën shpejt... Njerëzit më votuan mua për këtë post dhe unë e gjeta veten time me duar të lidhura pas shpine. Kjo është një kontradiktë totale.”<sup>27</sup> Ashtu si mund të shihet nga këto formulime, ka një kontradiktë midis presionit ndërkombëtar mbi Kosovën që ajo të zbatojë standardet duke përfshirë reduktimin e krimit të organizuar në territorin e saj dhe kërcënimin që ai përbën për shtetet e tjera dhe pamundësinë e autoriteteve kosovare për të luftuar krimin seriozisht dhe për të përmbushur standardet, kur shumica e kompetencave ende ndodhet nën administrimin ndërkombëtar.

---

<sup>26</sup> Enver Robelli. “Një shpatë mbi lirinë e Kosovës”, *Gazeta Shekulli*, marrë nga: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org.vrime\_files\Një shpatë mbi lirinë e Kosovës.mht, 15 shkurt, 2007.

<sup>27</sup> Cituar në Helena Smith, “Angry Kosovars Call on ‘Colonial’ UN Occupying Force To Leave,” (*Kosovarët e irrituar kërkojnë që Forca ‘Koloniale’ e OKB të largohet*) *The Observer*, 19 tetor 2003, 21.



Për sa i përket shtetit shqiptar, shenjat tregojnë se qeveria e re është duke luftuar krimin e organizuar me forcë. Sipas Besnik Mustafaj, ministrit të Jashtëm shqiptar, lufta kundër krimin të organizuar është një nga tre prioritetet kryesore të qeverisë aktuale shqiptare. “Krimi i organizuar nuk mund të ekzistojë në Ballkan pa një lidhje me politikën. Lidhja duhet prerë”.<sup>28</sup> Në të vërtetë, qeveria e re që erdhi në pushtet pas zgjedhjeve të përgjithshme të qershorit 2005 ka qenë e ashpër me krimin në përgjithësi dhe në veçanti me krimin e organizuar. Për shembull, “Një paketë anti-Mafia përmban mjete të reja ligjore për të lehtësuar konfiskimin e burimeve kriminale dhe për të fokusuar prioritetet në krimet jashtëzakonisht serioze në krimin e organizuar”.<sup>29</sup> Për më tepër, në prill 2006 nga qeveria u propozua një ligj i ri për riatdhesimin e emigrantëve nga shtetet anëtare të BE-së i cili një muaj më vonë u miratua nga trupi legjislativ, Parlamenti Shqiptar. Ishte vendi i parë i Ballkanit Perëndimor që veproi në atë mënyrë dhe në kthim iu premtua liberalizimi i vizave. Sidoqoftë, përpjekje të tilla nisën në 2003, kur qeveria socialiste e asaj kohe nënshkroi një marrëveshje bilaterale me Britaninë e Madhe, e cila hapi rrugën për marrëveshje të tilla edhe me shtete të tjera po ashtu. Veç kësaj, edhe qeveria e mëparshme kishte reduktuar kontrabandën dhe trafikimin pothuajse me një shpejtësi zero, pas fillimit të operacionit policor “Puna”<sup>30</sup> më 2002, një sukses i madh në atë kohë. Ajo u krye me bashkëpunimin e ngushtë të “Guardia di Financia”-s italiane e cila siguroi ndihmë logjistike dhe materiale, si edhe informacione të paçmueshme për policinë shqiptare.<sup>31</sup>

---

<sup>28</sup> Stability and prosperity: key steps in Albania’s European Union vocation. (*Stabiliteti dhe përparimi: hapat kyçë në përkushtimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian*) Marrë nga: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org. crime\_files\European Policy Centre Website.mht. Parë për herë të fundit: 20 shkurt 2007.

<sup>29</sup> Eno Trimcev. “Nations in Transit 2006,” (*Kombet në transit 2006*) Freedom House. Budapest: AQUINCUM Publishing, 2006. fq. 72.

<sup>30</sup> Jana Arsovska. “The evolution of Albanian organized crime groups.” Law presentation for the Catholic University Leuven – Belgium. (*Evolucioni i grupeve të Krimin të Organizuar Shqiptar.* Përfaqësimi Ligjor për Universitetin Leuven-Belgjikë)

<sup>31</sup> Fjalim publik në TV Klan (një nga TV më të mëdhenj në vend) i një prej zyrtarëve drejtues të Policisë së Shtetit Shqiptar në atë kohë z. Sokol Bizhga, i ngarkuar me disa nga këto operacione.

Kurse administrata aktuale e ka çuar çështjen një hap përpara kur ajo vendosi një Moratorium 3 vjeçar në të gjitha llojet e skafeve, e cila u publikua në 3 prill të 2006 në Fletoren Zyrtare.<sup>32</sup> Kjo masë mjaft ekstreme - që provokoi një protestë nga grupet e të drejtave të njeriut dhe aktivistët në vend - u mor si një shenjë e vullnetit të mirë nga qeveria e re në Tiranë për të luftuar çdo lloj trafikimi, drejt partnerëve të tyre evropian. Qëllimi kryesor i kësaj ishte veçanërisht ndërprerja e kontrabandës së drogës dhe trafikimit njerëzor. Këto dhe të tjera masa të qeverisë i kanë dhënë asaj një vlerë dhe mirënjohje nga jashtë dhe nuk kanë kaluar pa u vënë re. Nënshkrimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian në 2006, ishte si një veprim madhështor, pjesë e përpjekjeve të qeverisë së re për të luftuar krimin dhe për të zbehur pushtetin dhe fuqinë e krimit të organizuar. Për më tepër, një raport i Departamentit të Shtetit të SHBA-së në 2007, njohu hapat pozitivë të marrë nga qeveria shqiptare “ku vetëm nga 2001 në 2005, qeveria shqiptare konfiskoi 4.72 milionë dollarë aktivë të krimit të organizuar dhe terrorizmit dhe 1.58 milionë dollarë të tjera nga pastrimi i parave”.<sup>33</sup>

Pavarësisht retorikës dhe vullnetit të mirë të qeverisë së re, pengesat mund të dallohen lehtësisht. Në të njëjtin raport të Departamentit të Shtetit, ne mund të vëmë re gjithashtu se Shqipëria është në listën e vendeve ku është duke lulëzuar pastrimi i parave. Një nga pengesat më të mëdha sipas raportit është qarkullimi i parave jashtë sistemit bankar, që raportohet të jetë rreth 25% e ekonomisë totale, krahasuar me një 10% të dobët në shtetet e tjera fqinje.<sup>34</sup> *Ndër të tjera*, raporti thotë se, grupet e krimit të organizuar dhe trafikuesit e drogës e kanë përdorur territorin e Shqipërisë si një pikë kalimi për trafikimin e heroinës nga Azia Qendrore. Por artikulli nxjerr përfundimin

<sup>32</sup> Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë: Një publikim nga Qendra e Publikimeve Zyrtare. Marrë nga: [www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al), 10 mars, 2007

<sup>33</sup> Raporti i SHBA-së për pastrimin e parave në Shqipëri. *Shekulli 03.03.2007*. marrë nga: C:/Documents and Settings/ncë user/ Desktop/ Raporti I SHBA'së.mht.

<sup>34</sup> *Ibid*

se: “Dëshira e shqiptarëve për t’iu bashkuar NATO-s dhe BE-së ka qenë një motivim parësor në përmbushjen e reformave”, edhe pse ai vëren se procesi ka qenë i ngadalshëm, për shkak të fraksionimeve politike të brendshme.<sup>35</sup>

Ajo që është e çuditshme dhe interesante në të njëjtën kohë, është se ndërsa opinionistët kosovarë, si Robelli, janë kritikë të qeverisë shqiptare në Kosovë, për mospërgjigjen e tyre ndaj akuzave (false) të medias perëndimore ose zyrtarëve të BE-së, në Shqipëri vihet re një prirje totalisht e ndryshme. Sipas një analisti shqiptar, Parlamenti Shqiptar “i nxitur” nga ndonjë “parti” e interesuar, “në janar të 2001, amendoi artikullin 283 të Kodit Penal dhe depenalizoi përdorimin vetjak të drogave.”<sup>36</sup> Ndryshe nga shtetet e tjera që kanë ndjekur praktika të ngjashme në depenalizimin e disa kategorive të drogave për përdorim vetjak, ose që kanë vepruar kështu vetëm për drogat e lehta, deputetët shqiptarë, për shkak të mungesës së njohurive ose të informacionit e kanë miratuar këtë ligj në bllok.<sup>37</sup> Reagimet janë aq antagoniste sa që edhe pse ata janë njëlloj të hidhur në kritikën e tyre kundrejt qeverive respektive, ata ende rrjedhin nga perceptimet e ndryshme të veprimeve të qeverisë në të dy territoret shqiptare. Ndërsa në një anë, shqiptarët e Kosovës besojnë se kritika me të cilën po përballet qeveria dhe qytetarët e tyre, sidomos në lidhje me krimin e organizuar është e ekzagjeruar, homologët e tyre nga Shqipëria kanë prirjen të fajësojnë politikën e brendshme në vendet e tyre, duke e quajtur qeverinë përgjegjëse për dështimin në luftimin e krimit.

Një argument tjetër pretendues ka të bëjë me konkluzionin që kritika e BE-së ndaj kërcënimit të krimit të organizuar shqiptar nuk e bën dallimin midis shqiptarëve nga Shqipëria dhe shqiptarëve etnikë nga Kosova, Maqedonia apo Mali i Zi. Kjo është e rëndësishme për tre arsye. Së pari, shqiptarët etnikë nga ish-Jugosllavia kanë pasur mundësinë të imigrojnë në Europën Perëndimore shumë më herët se sa “vëllezërit” e tyre

<sup>35</sup> *Ibid*

<sup>36</sup> Lekë Sokoli. “Ngrirja e ligjvënësit shqiptar.” *Tirana Observer*, 26 shkurt 2007.

<sup>37</sup> *Ibid*

nga Shqipëria, të cilët ishin të izoluar dhe të kufizuar nga diktatura staliniste. Kjo nënkupton se një pjesë e tyre, të cilët e gjetën më të përshtatshme të punonin për bosët e rrjeteve ndërbotërore të krimit në vendet ku ata emigruan, pas disa kohëve ata ishin të aftë të krijojnë “sferat e tyre të influencës”. Me fundin e komunizmit dhe me hapjen e kufijve në Shqipëri, bosët e rinj kosovarë<sup>38</sup> filluan të shfrytëzonin punën e “vëllezërve” të tyre të rinj të sapoardhur shqiptarë, të cilët më pas u punësuan nga këta *nouveau riche-s (të pasurit e rinj)*, për të bërë disa nga punët “e pista”. Edhe pse një përqindje e vogël ka zhvilluar rrjetet e tyre vetjake dhe madje ka zëvendësuar disa nga bosët lokalë në tregun e paligjshëm, pjesa më e madhe nuk pati sukses për t’u bërë aq të pushtetshëm ose të rrezikshëm sa ata zakonisht përshkruanin në median perëndimore ose në ligjërimin zyrtar të BE-së.

Përfundimi i dytë që rrjedh nga “konfuzioni” midis shqiptarëve, ndërsa për të gjithë ata përdorim termin “shqiptarët etnikë”, është fakti se këta shqiptarë i përkasin shteteve të ndryshme. Për pasojë, kritika me të cilën përballet shteti shqiptar se nuk bën mjaftueshëm për të ndaluar rritjen e krimit të organizuar në territorin e tij, nuk është gjithnjë e drejtë dhe në përputhje me realitetin. Shteti shqiptar ka kontribuar në mënyrë të ndjeshme në luftimin e kërcënimit të krimit në territorin shqiptar, por ai ka pak mundësi të kontrollojë shqiptarët etnikë jashtë juridiksionit të tij ose shqiptarët që punojnë në Perëndim. Është interesante të vërejmë se fqinjët malazezë, me një territor dhe popullsi shumë më të vogël, zhvilluan për njëfarë kohe struktura të drejtuara nga mafia, të cilat trafikonin hapur në Itali si armët edhe drogat e jashtëligjshme. Ajo që është me të vërtetë e çuditshme këtu është se jo vetëm që Mali i Zi nuk është përballur me kritikën me të cilat duhet të merret Shqipëria, por gjithashtu është

---

<sup>38</sup> Ata ishin veçanërisht të vendosur në Suedi dhe Gjermani dhe ishin më tepër të përfshirë në trafikun e drogave. Ky paragraf është më shumë i varur nga bisedat që unë kam pasur në të shkuarën me emigrantët shqiptarë në këto vende. Një përqindje e vogël e tyre kanë pasur njohje me bosët etnikë shqiptarë dhe kanë punuar për ta si korrierë të drogës ose në mënyra të ndryshme.

ndihmuar financiarisht dhe me një publicitet të madh nga BE, e cila kërkon të stimulojë një rritje më të madhe ekonomike në këtë vend në mënyrë që ta mbajë atë të stabilizuar dhe ekonomikisht të pavarur nga fqinji i tij më i madh, Serbia, e cila mund ta kërcënojë me një shqetësim të brendshëm në çdo kohë, pikërisht për shkak të përqindjes së madhe të serbëve etnikë në vend. Jo shumë larg, BE pagoi për një fushatë komerciale në Euronews për të promovuar bregdetin e bukur të Malit të Zi, ndërsa bregdeti shqiptar shihet ende si një vend i rrezikshëm për t'u vizituar.<sup>39</sup>

Një aspekt i tretë është se krimi i ngulitur etnik, jo vetëm që portretizon një realitet subjektiv, por, veç kësaj, lë pas dore faktin se krimi nuk kërkon një identitet apo një qytetari të veçantë. Më saktë, nëse ne e shohim fenomenin në një këndvështrim ekonomik, ne argumentojmë se edhe pse, grupet kriminale shqiptare homogjene eksportojnë këto të mira të paligjshme, vendet pritëse që u sigurojnë tregun dhe konsumatorët nuk janë më pak të fajshëm.

Në shumicën e rasteve është për shkak të “standardeve të dyfishta” që ushtron zakonisht BE-ja në drejtim të Shqipërisë, që klasa politike e vendit është shpesh e pavullnetshme për të gjetur gjuhën e përbashkët për të shtyrë përpara reformat. Më saktë, për ta është më komode të akuzojnë publikisht njëri-tjetrin se janë të lidhur me krimin e organizuar, e cila përdoret në këmbim si një “armë” në duart e BE-së për të goditur mungesën e progresit në Shqipëri. Në anën tjetër, duket se politika e BE-së e “shkopit dhe karrotës”, “përdor më shumë se sa bindjen dhe tundimin; ajo ka si qëllim të ndryshojë

---

<sup>39</sup> Ministria e Jashtme Italiane, për shembull, publikoi një raport vjetor që rekomandon shtete ku turistët italianë mund të kalojnë pushimet e tyre. Shqipëria është i vetmi shtet europian, së bashku me Bosnjen dhe Turqinë, të cilat janë shënuar me të kuqe - duke u konsideruar si të rrezikshme për t'u vizituar nga turistët italianë. Në një mënyrë të ngjashme, Greqia jo vetëm që i dekurajon turistët e saj të vizitojnë Shqipërinë, por gjithashtu provokon incidente të ndryshme në bregdetin shqiptar çdo verë. Disa nga këto incidente përfshijnë hedhjen e konsiderueshme të naftës në hapësirën ujore shqiptare në verën e 2005-s në mes të sezonit të turizmit ose vjedhjen e rërës në disa nga resortet më të bukura të bregdetit shqiptar.

qëndrimet politike të vendeve të tjera përmes përdorimit të formave tradicionale të shtrëngimit dhe joshjes”.<sup>40</sup>

Është disi paradoksale që një nga kushtet më të rëndësishme me të cilën përballet Shqipëria është lufta kundër krimit të organizuar, ndërsa korrupsioni dhe “zënia e shtetit” janë gjithashtu të theksuara fuqishëm në raportet e ndryshme të BE-së. Kjo qasje ka të paktën dy probleme serioze. Së pari, edhe pse Shqipëria është ndëshkuar vazhdimisht nga ajo çka Ethan Nadelmann e quan “një korrupsion i institucionalizuar”, fenomeni i *zënies rob të shtetit*, shpesh është hiperbolizuar përtej kufijve të arsyeshem, në të njëjtën kohë që kjo është empirikisht e pamundur të matet. Madje edhe raportet vjetore ndërkombëtare që i referohen vetëm korrupsionit në vetvete, si Transparency International, bazohen në perceptimin e njerëzve mbi nivelet e korrupsionit në agjencitë e ndryshme qeveritare, më tepër se sa testimi konkret empirik nga trupa të specializuara. Perceptimet mund të krijohen nga eksperiencat e përditshme, po aq sa edhe të fryhen nga ligjërata dominante që është e përhapur nga media, e cila përdor në këmbim sulmet politike *ad hominem* (sulm i orientuar ndaj emocioneve dhe paragjytimeve të personit që përfaqëson çështjen dhe jo aftësisë së tij të të menduarit, dhe çështjes në fjalë) dhe kundërsulmet si një pikë nisjeje në referencat e saj. Kështu që, është krijuar një rreth vicioz, ku është e vështirë të dallosh të vërtetën rreth nivelit real të kërcënimit.

Retorika e BE-së në lidhje me rolin e krimit të organizuar ka gjetur një rezonancë perfekte nga aktorët e brendshëm, sidomos nga elita politike, e cila përpiqet të kapitalizohet politikisht me “fantazmën” e mafias, edhe pse është bërë pak për të mundësuar mekanizmat e duhura për ta luftuar atë, nëse një kërcënim i tillë supozohet si i vërtetë. Për analistin politik, Blendi Kajsio, retorika e një mafie të fuqishme në vend është ndërtuar për të unifikuar dhe për të shtuar kohezionin e partive kryesore politike dhe për të krijuar një armik imagjinar, por të tmerrshëm, kundër të cilit anëtarët identifikojnë veten

---

<sup>40</sup> Ridvan Peshkopia. “The Limits of Conditionality.” *Southeast European Politics*, (“Limitet e kushtëzimit.” *Politikat e Europës Juglindore*), korrik 2005, Vol. VI, No. 1, 46.

e tyre.<sup>41</sup> Si ka vënë re Catherine Verdery, kjo është karakteristikë e të gjithë vendeve ish-komuniste. Verdery shpjegon se njerëzit në këto shoqëri tranzicioni, me një pafundësi problemesh ekonomike dhe infrastrukturore, kanë nevojë për një shpjegim logjik për situatën e tyre dhe më pas t'i kthehen konceptit të një mafie të fuqishme që kontrollon tregun duke e monopolizuar atë.<sup>42</sup>

Në një mënyrë paradoksale, ashtu si ka vërejtur Shannon Woodcock, në Rumani, kjo “mafie” sureale ishte portretizuar si e përfaqësuar nga komuniteti rom, i cili në fakt ishte “tjetri” i shoqërisë rumune.<sup>43</sup> Kjo tingëllon si jashtë realitetit jo vetëm sepse duket si totalisht imagjinare, por gjithashtu duke marrë parasysh se krimi i organizuar ose mafia konsistojnë në organizime hierarkike, të specializuara (edhe pse të paligjshme) që kanë një ekzistencë të fshehur (jo publike), as nuk mund të imagjinohet se si një komunitet i pafavorizuar, si romët, të mund të krijojnë struktura kaq të sofistikuar, si kritikon me të drejtë Woodcock. Autorja vazhdon duke argumentuar se në këto shoqëri “mafia është një simbol që përdor njerëzit për t’iu drejtuar dhe për të shprehur ambiguitetin e tyre, që ata ndiejnë në lidhje me ndryshimet politike, ekonomike dhe shoqërore që ata eksperimentojnë në jetën e tyre të përditshme”.<sup>44</sup> Duke u referuar veçanërisht tek opiniononi publik shqiptar, Kajsiu nxjerr në pah se:

...madje edhe për qytetarin mesatar, mafia është e nevojshme. Ajo thjeshtëzon kompleksitetin e situatës, eliminon përgjegjësitë individuale, zgjedhjet e gabuara në jetë, vështirësitë e gjetjes së një pune apo dështimin dhe humbjen në biznes, madje edhe në dashuri.<sup>45</sup>

---

<sup>41</sup> Blendi Kajsiu. “Në emër të mafias” [In the name of mafia], gazeta *Panorama*, 2 prill 2007.

<sup>42</sup> Shannon Woodcock, “The Tigan is not a Man”: *The Tigan Other as catalyst for Romanian Ethnonational identity*. University of Sydney, Department of history, Dissertation for PhD, qershor 2005. fq. 113.

<sup>43</sup> *Ibid*

<sup>44</sup> *Ibid*

<sup>45</sup> Kajsiu, *ibid*

Si mund të shohim qartësisht, ne nuk po përballemi vetëm me një retorikë të trupave të specializuara të BE-së që ndonjëherë mund të kenë një njohje sipërfaqësore të realitetit, por gjithashtu edhe me një retorikë për konsumin e brendshëm, në luftë me një armik imagjinar që pothuajse në të njëjtën mënyrë si në komunizëm, bashkon linjat ideologjike, ndërsa lehtëson shqiptarët nga pesha e pafundësisë së problemeve të tyre të ardhur nga një tranzicion pambarim. Në këmbim, kjo atmosferë krijon një klimë të re ku lideri i partisë kryesore, po ashtu edhe kryeministri i vendit, përqendron më shumë pushtet në duart e tij, nën doktrinën e luftimit të “fantazmave” të krimit të organizuar dhe të mafias. Jo shumë kohë më parë, ai madje sulmoi median e pavarur ku ai deklaroi në një konferencë për shtyp që media është “zënë” nga mafia. Në këtë mënyrë, kryeministri luan një lojë të keqe; sepse ai e di se ky është lloji i retorikës që duan të dëgjojnë përfaqësuesit e BE-së, sa kohë që kjo është pjesë e fjalorit të tyre po ashtu. Si Kajsio vërejti në kohën e duhur, shqetësimi kryesor i BE-së është stabiliteti i vendit dhe jo demokracia. Të dyja këto nuk janë domosdoshmërisht në harmoni.<sup>46</sup> Është interesante të përmendim këtu se raportet e BE-së jo vetëm që ngrihen në nderimet më të larta nga elitat lokale, por gjithashtu i referohen atyre si *sacra scriptu* (shkrim i shenjtë), ndërsa vetë BE i referohet ligjëratës së brendshme ose aktorëve të brendshëm si pikë referimi për të treguar se kush janë problemet dhe/ose prioritetet kryesore të Shqipërisë.

## Përfundim

Këto analiza kanë nxjerrë në pah një të metë në retorikën e BE-së në lidhje me kërcënimin e krimit të organizuar të “shqiptarëve etnikë”, po ashtu si edhe në ndërkombëtarizimin e ligjëratës së BE-së nga Shqipëria. Klasa politike shqiptare si

---

<sup>46</sup> Shiko për një argument të ngjashëm që i referohet rolit të BE-së në proceset e demokratizimit në Shqipëri. Kajsio, “The integration as an impediment for democratization” (“Integrimi si një pengesë për demokratizimin”), *Polis 2*, Tiranë, 2006.



dhe media dhe shoqëria civile shumë shpesh artikulojnë shqetësimet e BE-së në lidhje me pengesat e Shqipërisë në rrugën e saj drejt integritimit si probleme të përgjithshme ekzistuese që pengojnë zhvillimin e Shqipërisë dhe ndikojnë për keq në shumë pjesë të popullsisë, megjithëse ashtu siç u tregua qartë në këtë ese, interesat e BE-së dhe Shqipërisë nuk janë domosdoshmërisht në harmoni. Veç kësaj, sondazhe të ndryshme kanë treguar se popullsia shqiptare është më tepër e shqetësuar për faktorët ekonomikë si papunësia dhe pagat, se sa të ndajë retorikën zyrtare të kërcënimeve kryesore të krimit të organizuar, “zënies rob të shtetit” madje dhe korrupsionit.<sup>47</sup>

Unë dua të theksoj se qëllimi i kësaj eseje ishte të jap një panoramë më të gjerë të perceptimit të shqiptarëve për krimin e organizuar, bazuar në të dhënat e mjaftueshme empirike. Gjithashtu ajo ofron edhe një informacion analitik, të bazuar në mprehtësinë dhe vrotimet e autorit në lidhje me ligjëratën që është shfaqur rreth kërcënimit të krimit të organizuar nga Shqipëria. Mbi të gjitha, ajo fokusohet kryesisht në retorikën e BE-së si e ngulitur në tekstet e raporteve të Europolit ose të burimeve parësore të takimeve të Këshillit. Ajo gjithashtu ilustron në fjalimet e zyrtarëve të pushtetshëm të BE-së si Solana, ose analistëve si Moore dhe Robelli për të pasur një panoramë të plotë të rezonancës së kësaj retorike në politikat konkrete që ndikojnë rajonin prej ku shfaqen krimet e shqiptarëve etnikë.

Efekti i retorikës së BE-së në ligjëratën politike shqiptare, ose ta marrim ndryshe, europianizimi i rrjedhës së përgjithshme të ligjërimit në Shqipëri, ka çuar në artikulimin e perceptimeve të njëjta, shqetësimeve dhe qëllimeve si të liderëve shqiptarë edhe të homologëve europianë, edhe pse kjo nuk përputhet as me realitetin, as me nevojat dhe shqetësimet imediate të shumicës së elektoratit shqiptar.

BE ka zgjeruar retorikën e saj gjatë viteve të fundit, por ende nuk ka parashikuar mekanizma të reja të afta dhe eficientë

---

<sup>47</sup> Korrupsioni bën një dalje në opinionin publik shqiptar vetëm kur është e lidhur drejtëpërdrejtë me mirëqenien e tyre dhe në këtë kuptim, është disi ndryshe nga shqetësimet e klasës politike që e sheh atë si të lidhur ngushtësisht me “zënien e shtetit”.

për t'u përballuar me kërcënimin e krimit të organizuar. Në rastin tonë, BE ka dështuar të bëjë dallimin ndërmjet shqiptarëve, duke i vendosur ata nën të njëjtën etiketë dhe duke e trajtuar kërcënimin që vjen nga ata si linear. Vlerësimet e BE-së gjithashtu nuk e bëjnë dallimin ndërmjet kërcënimit të brendshëm që vjen nga shqiptarët etnikë të mirëvendosur në Europën Perëndimore dhe kërcënimin që është shfaqur nën situatën e tanishme dhe të lidhur më tepër me pasigurinë që mungesa e stabilitetit sjell në vende si Kosova, ku mungesa e një statusi formal dhe ndarja e përgjegjësive, mund të nxisë tensionet dhe të ndihmojë Kosovën të kthehet në një "shtet të dështuar".

Në mënyrë të çuditshme, ligjërata e brendshme shqiptare është parë si një zgjerim i europianizimit të saj në vitet e fundit.<sup>48</sup> Shpesh politikanët e akuzojnë njëri-tjetrin si të korruptuar ose si kontribuues të përhapjes së krimit të organizuar; ndërsa zakonisht partia që ka qeverisjen akuzohet sikur ka "zënë rob shtetin". Nuk është e habitshme që aluzionet e zyrtarëve të BE-së dhe vlerësimet mbi problemet dhe pengesat kryesore të Shqipërisë që e pengojnë atë për t'u bashkuar shpejt me pjesën tjetër të "familjes" europiane, janë njëherësh të artikuluara nga elita shqiptare, e cila e instrumentalizon retorikën për t'i shërbyer vetë asaj dhe për të hedhur baltë te kundërshtarët. Kërkime të mëtejshme të lidhjes shkakësore që lidh retorikën e BE-së me reagimin e Shqipërisë (vetëm në nivelin retorik ose të veprimit) janë po aq të mirëpritura dhe të inkurajuara.

Për t'u përballur në mënyrë adekuate me kërcënimet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe/ose "zënies së shtetit" që burojnë nga Shqipëria (duke supozuar se këto kërcënime janë reale), BE duhet të zhvillojë qëllime të politikave afatgjata që do të sigurojnë se asnjë "vrinë e zezë" nga ku mund të lulëzojë krimi, të mos ekzistojë në "oborrin e pasmë" të saj.

---

<sup>48</sup> Evidenca më e dukshme e kësaj është se fraza "integrimi në BE" është më e artikuluara në fjalorin politik shqiptar. Mbi të gjitha, partia e ish-kryeministrit, z. Ilir Meta, së fundmi kryetar i partisë së tretë më të madhe (Lëvizja Socialiste për Integrim), e ka bërë integrimin e Shqipërisë në BE me qëllimin e vetëm të ekzistencës së saj politike.

Mbi të gjitha, BE duhet të njoh përpjekjet e ndershme për të mbajtur nën fre kurbën e krimit të organizuar, kur ato janë bërë në një besim të mirë, si në rastin e shtetit shqiptar dhe ta përdori “karrotën” e tij në mënyrë të barabartë me “shkopat” e tij. Vetëm përmes bashkëpunimit, inteligjencës së ndarjes së informacionit dhe vullnetit të fortë multilateral, mund të zbehet kërcënimi që vjen prej krimit të organizuar dhe procesi i integritetit mund të ecë më shpejtë. Dështimi për të konsideruar një strategji afatgjatë që do të drejtojë te Shqipëria, ashtu si dhe fqinjët e saj integrimin në BE, vetëm sa do të shkatërrojë situatën ekonomike në këto vende, duke e bërë edhe më të madh hendekun me vendet e BE-së dhe t’i hedhë ekonomitë e tyre fillestare në një kolaps që në këmbim do të gjenerojë pikërisht krimin e organizuar, “zënien e shtetit”, dhe korrupsionin të cilit BE-ja i frikësohet me kaq të drejtë.

*Ilir Kalemaj po bën Doktoraturën në Shkenca Politike  
me specializim Marrëdhëniet Ndërkombëtare  
tek Universiteti i Europës Qendrore në Hungari  
dhe është pedagog tek Universiteti i Nju-Jorkut, Tiranë*

## FLORINA CRISTIANA (CRIS) MATEI

LUFTA NDAJ TERRORIZMIT  
DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR:  
QASJE TË PËRBASHKËTA  
TË EUROPËS JUGLINDORE

## Hyrje

Fundi i Luftës së Ftohtë shkaktoi lulëzim të beftë të demokracisë dhe lirisë në një ambient të ndryshëm dhe të rrezikshëm. Sfidat dhe kërcënimet ndaj sigurisë pas Luftës së Ftohtë nuk vijnë më nga aktorë hierarkikë dhe të organizuar shtetërorë, por nga grupe dhe organizata të tjera joshtetërore, me një rrjet qendror dhe lehtësisht të adaptueshëm (si terrorizmi, krimi i organizuar, grupet që operojnë në pastrim parash dhe trafikim njerëzor), të cilat vazhdimisht kanë pasur sukses për të ndërhyrë ndërmjet kufijve tradicionalë gjeografikë të vendeve të ndryshme dhe nëpërmjet kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme. Ndarja e Jugosllavisë në fillim të viteve '90 dhe sulmet terroriste në SHBA (2001), Turqi (2003), Spanjë (2004) dhe Londër (2005) etj. kanë treguar qartësisht sesi paqëndrueshmëria dhe lufta që përfshin shtetet e dështuara nga një anë, ose ideologji dhe bindje të caktuara fetare të grupeve të vogla të njerëzve (gjithsesi shumë të përgatitur dhe të mirorganizuar), në anën tjetër, mund të ndikojë në paqen dhe sigurinë e një rajoni ose kontinenti të tërë.

Këto zhvillime kanë nxitur qeveritë dhe kombet të hetojnë dinamikën e vendimmarrjeve të rrjetit dhe të përshtatin një sjellje më në rrjet për të kuptuar më mirë dhe për të goditur rrjetet e terrorizmit dhe krimit të organizuar.<sup>1</sup> Gjithashtu,

---

<sup>1</sup> Steve TSANG ed., 2007: Intelligence and Human Rights in the Era of Global Terrorism, Praeger Security International, 1-224. Megjithatë,

shtetet kanë thelluar bashkëpunimin me vendet me qëllime të përafërta të sigurisë duke krijuar mjete dhe mekanizma të “bashkëpunimit ndërinstitucional”, duke zhvilluar dhe konsoliduar “partneritete” dhe duke u bashkuar në organizata dhe aleanca të ndryshme “të sigurisë së përbashkët”.

Europa Juglindore nuk është e panjohur me terrorizmin dhe krimin e organizuar. Këto kërcënime, bashkë me varfërinë, paqëndrueshmërinë politike, korrupsionin, izolimin e minoriteteve, sëmundjeve pandemike, fatkeqësive natyrore etj. formësojnë spektrin e kërcënimeve ndaj sigurisë në rajonin e Europës Juglindore. Në kërkimin e tyre për përgjigje të efektshme, kombet kanë zhvilluar gradualisht një varg mekanizmash bashkëpunimi dypalësh, ndërajonal dhe rajonal dhe/ose i janë bashkuar aleancave dhe organizatave ekzistuese ndërkombëtare të bashkëpunimit. Një pyetje mbetet: me gjithë këto mjete të bashkëpunimit në rajon, a ka kaluar Europa Juglindore nga një “fuçi baruti” e Europës në një rajon të qëndrueshëm pa terrorizëm apo krim të organizuar? Ky punim heton zhvillimet e Europës Juglindore në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe bashkëpunimit të krimit të organizuar.

## Qasje të përbashkëta për bashkëpunim në luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit në Europën Juglindore

**Nevoja për bashkëpunim:  
terrorizmi dhe krimi i organizuar në rajon**

Europa Juglindore nuk është një parajsë madhështore për terrorizmin, krahasuar me rajonet e tjera. Nga një anë, ka një numër relativisht të vogël emigrantësh myslimanë, dhe

---

shndërrimi i qeverive në organizata të centralizuara shumë të efektshme pengohet nga çështjet burokratike dhe pikëpamjet e kufizuara. Është e vështirë të sheshosh procesin e tyre të vendimmartjes për të zhvilluar shpejtësinë dhe shkathhtësinë e nevojshme për të depërtuar në terrorizmin armik. See Paul SHEMELLA: Interagency Coordination: The Other Side of CIMIC (Draft Paper).

minoritetet myslimane janë të integruara në shtetet e EJT (Rumania dhe Bullgaria, për shembull). Nga ana tjetër, mbështetja për terrorizmin nga ana e grupeve më të mëdha myslimane në Ballkan është e vakët, për shkak të filozofisë së tyre më laike në krahasim me myslimanët tjetërkund; ata e konsiderojnë veten europianë dhe kanë frikë se terrorizmi do të njollosë emrin e tyre në Europë, duke i ndaluar ata nga udhëtimet drejt saj dhe duke penguar përpjekjet e vendeve të tyre për t'u anëtarësuar në NATO dhe BE. Gjithashtu, shtypja e militantëve islamikë nga burimet kryesore të terroristëve në Lindje të Mesme (si Arabia Saudite) ka ulur edhe më kërcënimin e terrorizmit në Ballkan.<sup>2</sup>

Prapëseprapë, që nga viti 1989, EJT ka qenë një tokë pjellore për krimin e organizuar dhe deri në një farështrirje, terrorizmin. Për këtë ka disa arsye. Së pari, është rënia e komunizmit (dhe ndryshimi i regjimit) në rajon, që i ka vendosur vendet e EJT-së në nivele të ndryshme ekonomike, politike e shoqërore. Institucione shtetërore të paqëndrueshme dhe disfunksionale, organizata të dobëta për zbatimin e ligjit, paqëndrueshmëria politike, korrupsioni dhe varfëria kanë nxitur veprimtaritë e grupeve të terrorizmit dhe krimin të organizuar.<sup>3</sup> Gjithashtu, një shkrirje e krimin të organizuar me terrorizmin është vënë re këto kohët e fundit, si pasojë e mbështetjes së zvogëluar nga Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e tij, si dhe nga rënia e ndihmës nga disa vende arabe pas 11 Shtatorit 2001. Këto ndryshime kanë detyruar grupet terroriste

---

<sup>2</sup> Steven WOEHLER, 2008: *Islamic Terrorism and the Balkans*, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10. Frances G. BURWELL, David C. GOMPERT, Leslie S. LEBL, Jan M. LODAL, Walter B. SLOCOMBE, 2006: *Transatlantic Transformation: Building a NATO-EU Security Architecture*, 1–32. Anes ALIC, 2006: *Al-Qaeda's Recruitment Operations in the Balkans*, *Terrorism Monitor*, Jamestown Foundation, Vol 4(12), 1–13.

<sup>3</sup> <http://www1.cj.msu.edu/~outreach/security/orgcrime.html>, (18 May 2008). Michael A. INNES, 2005: *Terrorist Sanctuaries and Bosnia-Herzegovina: Challenging Conventional Assumptions*, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 28(4), 295–305. Fotios MOUSTAKIS, 2004: *Soft Security Threats in the New Europe: The Case of the Balkan Region*, *European Security*, Vol 13(1 & 2), 139–156.

të gjejnë mbështetje materiale dhe financiare nga burime të tjera, duke përfshirë dhe krimin e organizuar. Në EJL, është raportuar se Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK-ja) ishte e përfshirë në trafikun e heroinës si një mënyrë për të mbledhur të ardhura për operacionet e saj gjatë konfliktit në Kosovë.<sup>4</sup> Edhe globalizimi ka kontribuar në zgjerimin e mundësive për terrorizmin dhe krimin e organizuar, si dhe për një konvergencë ndërmjet veprimtarive të krimit të organizuar dhe atyre terroriste.<sup>5</sup> Së dyti, duhen përmendur konfliktet e zgjatura në disa vende të ish-Jugosllavisë dhe/ose Bashkimit Sovjetik. Kjo ka lejuar shumimin, në këtë rajon, të strukturave të ngjashme me mafien, por të motivuara politikisht.<sup>6</sup> Së treti, është shtrirja e veprimtarisë ushtarake në rajonin e Detit të Zi gjatë Luftës së Ftohtë, çka rriti mundësitë për trafikimin e jashtëligjshëm të armëve, gjë e cila çoi në lindjen e ushtrive private dhe forcave paraushtarake nga lëvizje të ndryshme separatiste në rajon.<sup>7</sup> Së katërti, është prania e islamit në EJL: myslimanët dhe/ose arabët që kanë studiuar në disa vende të EJL-së gjatë periudhës komuniste (si në rastin e Rumanisë) dhe kanë mbetur në Europë pas rënies së regjimit, dhe/ose luftëtarë islamikë dhe përfaqësues të organizatave të ndryshme humanitare ndërkombëtare që kanë mbërritur nga vendet arabe (Arabia Saudite, Siria dhe Algjeria) gjatë konflikteve në ish-Jugosllavinë e viteve '90.<sup>8</sup> Të gjithë faktorët e mësipërm i

---

<sup>4</sup> Steven HUTCHINSON, Pat O'MALLEY, 2007: A Crime-Terror Nexus? Thinking on Some of the Links between Terrorism and Criminality, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 30(12), 1095–1107.

<sup>5</sup> <http://www1.cj.msu.edu/~outreach/security/orgcrime.html> (18 May 2008). Ron CHEPESIUK, 2007: Dangerous Alliance: Terrorism and Organized Crime. <http://www.globalpolitician.com/23435-crime> (18 May 2008).

<sup>6</sup> Philipp H. FLURI, Gustav E. GUSTENAU, Plamen I. PANTEV, 2005: The Evolution of Civil-Military Relations in South East Europe: Continuing Democratic Reform and Adapting to the Needs of Fighting Terrorism, *Physica-Verlag Heidelberg*, 1–276.

<sup>7</sup> George Cristian MAIOR, Mihaela MATEI, 2005: The Black Sea Region in an Enlarged Europe: Changing Patterns, Changing Politics, *Mediterranean Quarterly*, Vol16(1), 33–51.

<sup>8</sup> Anes ALIC, 2006: Al-Qaeda's Recruitment Operations in the Balkans, *Terrorism Monitor*, Jamestown Foundation, Vol 4(12), 1–13.

kanë dhënë mundësi Al Qaeda-s dhe grupeve të tjera terroriste të depërtojnë në EJL (sidomos në Ballkanin Perëndimor), edhe pse, siç u tha dhe më sipër, thirrja e Bin Laden-it për jihad nuk i josh të gjithë myslimanët në rajon.<sup>9</sup> Më tej, grupe dhe organizata të ndryshme terroriste janë përpjekur të rekrutojnë të ashtuquajturit “myslimanë të bardhë” nga Ballkani (gjë që me shumë mundësi mund të ketë lindur një rrjet “të bardhë” Al-Qaeda, që operon nga Europa Perëndimore deri në EJL), duke qenë se në Europë pamja e tyre e jashtme është më e përshtatshme sesa ajo e popujve të Lindjes së Mesme.<sup>10</sup> Së pesti, është prania ushtarake e SHBA-së në disa vende të EJL-së (Rumania dhe Bullgaria, për shembull), që mund të bëhen tërthorazi objektiv i terroristëve. Së fundi, një zhvendosje<sup>11</sup> aktuale e dukshme e terroristëve, e përqendruar në Irak, drejt rajonit të Ballkanit, ose anasjelltas, mund të sjellë një rritje të veprimtarive terroriste dhe të krimit të organizuar në rajon.

---

<sup>9</sup> Organizatat Joqeveritare Islamike (disa nga të cilat mbulojnë Al-Kaedën) kanë operuar në Shqipëri që nga viti 1991 dhe kanë hapur kampe të trajnimit terrorist në Serbi. Nga këto, Rinia Aktive Islamike kishte lidhje në sulmet ndaj kroatëve etnikë në Bosnjën qendrore. Al-Qaeda ka vepruar në Ballkan që nga lufta e Bosnjes. Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10. Florina Cristiana MATEI, 2007: Romania’s Intelligence Community: From an Instrument of Dictatorship to Serving Democracy, *International Journal of Intelligence and CounterIntelligence*, Routledge, Vol. 20(4), 629–660. Michael A. INNES, 2005, Terrorist Sanctuaries and Bosnia-Herzegovina: Challenging Conventional Assumptions, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 28(4), 295–305.

<sup>10</sup> Autoritetet boshnjake kanë dhënë analiza mikse: është ose një rrezik i madh ose një kërcënim i mundshëm i të ardhmes për shkak të mungesës së provave me vlerë. Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10. Në vitin 2006 tre të rinj u ndaluan në Bosnje (tani presin gjyqin) me akuzën e një plani sekret, për sulme terroriste mbi objektivat perëndimore në Sarajevë. Autoritetet besojnë se ata ishin “myslimanë të bardhë” të rekrutuar nga Al-Qaeda. Anes ALIC, 2006: Al-Qaeda’s Recruitment Operations in the Balkans, *Terrorism Monitor*, Jamestown Foundation, Vol. 4(12), 1–13.

<sup>11</sup> Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10.



## Nisma dhe mekanizma të bashkëpunimit

Këto zhvillime kanë stimuluar bashkëpunimin dhe koordinimin ndërmjet vendeve të EJL për forcimin e lirisë, demokracisë dhe sigurisë në rajon. Lufta kundër kërcënimeve ndaj sigurisë në përgjithësi, dhe terrorizmit dhe krimit të organizuar në veçanti, ka përfshirë lidhje më të forta diplomatike, politike dhe ushtarake ndërmjet vendeve të EJL, një përmirësim të bashkëpunimit në fushën e shërbimeve të inteligjencës, dhe bashkëpunim intensiv ndërkufitar, policor dhe juridik. Bashkëpunimi përfshin që nga takimet e udhëheqësve ushtarakë e politik në rajon, deri tek stërvitjet dhe trajnimet e përbashkëta me qëllim luftimin dhe parandalimin e terrorizmit dhe krimit të organizuar, dhe veprimet e bashkërenduara të prokurorëve publik rajonalë, zyrtarëve të inteligjencës dhe të zbatimit të ligjit për të siguruar kufijtë e tyre, arrestuar ose dëbuar të dyshuarit për terrorizëm dhe/ose krim të organizuar, për të eliminuar organizatat e lidhura me terrorizmin dhe krimin e organizuar, për të ngrirë ose konfiskuar asetet e njerëzve dhe grupeve të dyshuara për financime për terrorizmin, etj. Bashkëpunimi ka përfshirë gjithashtu edhe vendet e EJL që luftojnë në luftën kundër terrorizmit së bashku me aleatët dhe partnerët e tyre.

Shpresa për anëtarësim në NATO dhe BE (një status i dëshiruar nga shumica ish-vendeve komuniste në Europë si një provë e pjekurisë së tyre demokratike dhe aftësive të përparuara për sigurinë), bashkë me kushtet dhe nxitjen e këtyre dy organizatave, kanë përshpejtuar përpjekjet për bashkëpunim rajonal në EJL. Pas 1989, si NATO ashtu dhe BE u përqendruan në zgjerimin e zonës Europiane të paqes dhe stabilitetit, duke hapur dyert e tyre për anëtarët e rinj dhe duke ndihmuar vendet aspiruese dhe vendet jo-kandidate për të forcuar demokracitë të tyre dhe për të rritur aftësitë e tyre për sigurinë, nëpërmjet programeve të ndryshme, partneriteteve dhe/ose kërkesave të nevojshme për anëtarësim, me qëllim rindërtimin dhe zhvillimin e pas-luftës, reformat në institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes, dhe afrimin e vendeve

të EJT më afër Perëndimit.<sup>12</sup> Njëpërmjet këtyre programeve, dy organizatat i kanë detyruar vendet candidate të forcojnë marrëdhëniet dy dhe trepalëshe, për të konsoliduar marrëdhëniet me fqinjët e tyre dhe për të marrë pjesë në një sërë organizatash rajonale dhe nënrajonale të sigurisë. Me fjalë të tjera, bashkëpunimi rajonal dhe ndërrajonal ka qenë një kusht i domosdoshëm për integrimin në të dy organizatat.

### Bashkëpunimi dy dhe trepalësh

Vendet e EJT-së kanë nënshkruar një sërë traktatesh dypalëshe dhe kanë ngritur nisma të ndryshme trepalëshe të bashkëpunimit, secila me objektiva të veçanta, bazuar në interesat e përbashkëta dhe shqetësimeve të sigurisë (duke filluar që nga bujqësia, arsimit dhe transporti deri te dogana, mbrojtja, ekstradimi dhe lufta kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar). Traktatet dypalëshe për mossulmim dhe pretendimet jo territoriale<sup>13</sup> ndërmjet Ruisë dhe Hungarisë (1997) dhe Bullgarisë dhe ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (FYROM) (1999), u nënshkruan si një dëshirë e të dyja palëve për të ndaluar keqkuptimet e mosbesimit e së shkuarës, dhe për të shpejtuar bashkëpunimin dypalësh, megjithëse vendet shpresuan të fitonin më shumë besim në përpjekjet e tyre për anëtarësim në NATO dhe BE. Marrëveshja trepalëshe Rumuno-Bullgaro-Turke u përqendrua në luftën ndaj krimit të organizuar, por u përforcua edhe nga nxitja e përbashkët nga vendet e BE-së për integrim europian, si dhe nga përpjekjet e Rumanisë dhe Bullgarisë për anëtarësim në NATO. Në të njëjtën mënyrë, traktati trepalësh Rumuno-Bullgaro-Grek nuk ka qenë vetëm një mekanizëm për bashkëpunim ndërmjet tri vendeve në luftën ndaj krimit të organizuar, por ka shërbyer gjithashtu si një mundësi për

---

<sup>12</sup> Frances G. BURWELL, David C. GOMPert, Leslie S. LEBL, Jan M. LODAL, Walter B. SLOCOMBE, 2006: *Transatlantic Transformation: Building a NATO-EU Security Architecture*, 1–32.

<sup>13</sup> <http://www.nato-pa.int/archivedpub/special/rr-borovetz99.asp> (28 June 2008).

Rumaninë dhe Bullgarinë për të siguruar mbështetjen greke për kandidaturat e tyre në NATO.<sup>14</sup>

## Bashkëpunimi rajonal

### NATO

Nëntë vende të EJL-së janë anëtare ose partnere të NATO-s (dhe dy të tjera morën ftesa për anëtarësim në prill 2008), e cila, që nga fundi i Luftës së Ftohtë (dhe sidomos pas sulmeve të 11 Shtatorit 2001) është orvatur të forcojë aftësitë e saj kolektive kundër terrorizmit. NATO e ka parë terrorizmin si një problem të sigurisë ndërkombëtare, i cili kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse dhe përgjigje që të përfshijë masa të përbashkëta politike, ekonomike dhe të zbatimit të ligjit, si dhe angazhim ushtarak. Me fjalë të tjera, terrorizmi është kthyer në një mision të qëndrueshëm për aleancën. Në vitin 2001, brenda 24 orëve që nga sulmet ndaj SHBA-së, NATO iu referua Artikullit 5 për herë të parë. Në vitin 2002, NATO përvetësoi masa dhe nisma të ndryshme për luftën ndaj terrorizmit: një Plan Veprimi për Planifikim të Emergjencave Civile (për të ndihmuar autoritetet kombëtare në forcimin e gatishmërisë së tyre civile), një shkëmbim më intensiv ndërmjet shërbimeve inteligjente, masa më të mira për përgjigjen ndaj krizave dhe bashkëpunim më të madh me partnerët e saj (brenda kuadrit të **Partneritetit të Planit të Aksionit** kundër terrorizmit). NATO ka një koncept ushtarak për mbrojtjen ndaj terrorizmit, gjë që ka vendosur katër kategoritë e veprimtarive të mundshme ushtarake të NATO-s (antiterrorizëm, menaxhim i pasojave, kundërterrorizëm dhe bashkëpunim ushtarak). Gjithsej, 26 vendet anëtare të NATO-s kanë kontribuar në luftën ndaj terrorizmit me përfshirjen e tyre në Afganistan.<sup>15</sup>

<sup>14</sup> Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008)

<sup>15</sup> Christopher BENNETT, 2003: Combating terrorism, *NATO Review*. Frances G. BURWELL, David C. GOMPert, Leslie S. LEBL,

## Bashkimi Europian (BE)

Tetë shtete të EJT-së janë anëtare të Bashkimit Europian, një fakt që ka kanalizuar përpjekjet e tij për mekanizma të përbashkëta për luftën ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar. Për sa i përket terrorizmit, në vitin 2001 BE përvetësoi një plan antiterrorizëm me qëllim përforcimin e konsensusit dhe përpjekjeve ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin (duke përfshirë financimin dhe rekrutimin për terrorizmin), për të rritur aftësitë antiterroriste të Bashkimit Europian, për të mbrojtur transportin ndërkombëtar dhe siguruar kufijtë, si dhe për të inkurajuar edhe përpjekje të vendeve të treta kundër terrorizmit. Më pas, BE miratoi një ligj për fondet e ngrira dhe ndalimin e mbështetjes për terrorizmin, e ndjekur nga një vendim mbi përcaktimin dhe ndëshkimin për terrorizmin në vitin 2002. Të gjitha këto masa antiterroriste janë të zbatueshme edhe në luftën e BE-së ndaj krimin të organizuar (p.sh.: diskutimi rreth harmonizimit të sanksioneve kriminale dhe ngrirjes së aseteve mund të zgjerohet drejt OC).<sup>16</sup> Më tej, Konventa e Bashkimit Europian mbi Asistencën e Ndërsjelltë në Çështjet Kriminale (2000) dhe Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimin të Organizuar Mbarëkombëtar (2000) kanë si qëllim të forcojnë bashkëpunimin në përpjekjet kundër krimin të organizuar.<sup>17</sup>

Ndërmjet përpjekjeve të tjera, përpjekjet më të rëndësishme për bashkëpunim të Bashkimit Europian përfshijnë EAW, EUROPOL, JIT dhe Zyrën e Koordinatorit Kundër terrorizmit. **Urdhri Europian për Arrestimin**

Jan M. LODAL, Walter B. SLOCOMBE, 2006: Transatlantic Transformation: Building a NATO-EU Security Architecture, 1–32. <http://www.nato.int/issues/afghanistan/040628-factsheet.htm> (30 June 2008).

<sup>16</sup> W. BRUGGEMAN, 2002: Security and Combating International Organized Crime and Terrorism, 1–46.

<sup>17</sup> Fighting Terrorism at European level, 2003. [http://www.auswaertiges-amt.de/www/en/aussenpolitik/vn/itb/itb\\_eu\\_html](http://www.auswaertiges-amt.de/www/en/aussenpolitik/vn/itb/itb_eu_html) (24 May 2008). Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145. W. BRUGGEMAN, 2002: Security and Combating International Organized Crime and Terrorism, 1–46.

(EAW) u miratua në vitin 2002 për të thelluar bashkëpunimin e sistemeve gjyqësore të vendeve të BE-së, duke lehtësuar ekstradimin ndërmjet shteteve të BE-së.<sup>18</sup> **Organizata Europiane e Zbatimit të Ligjit, e njohur edhe si Drejtoria e Policisë Europiane (EUROPOL)**, u themelua më 1992, për të rritur efektshmërinë e bashkëpunimit të organizatave të BE-së për zbatimin e ligjit në luftën ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar ndërkombëtar (për shembull përmes shkëmbimit të informacionit dhe inteligjencës, mbështetjes së operacioneve, raporteve strategjike (për shembull vlerësimet e kërcënimit) dhe analizave të krimin dhe harmonizimit të teknikave investigative ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Njësia kundër terrorizmit është riaktivizuar kohët e fundit brenda EUROPOL-it.<sup>19</sup> Rrjeti i Ekspertëve Kombëtarë në Ekipet e Përbashkëta të Hetimit (JIT) u krijua më 2005 për të siguruar bashkëpunimin e skuadrave të hetimit të shteteve të BE-së në lidhje me terrorizmin dhe krimin e organizuar.<sup>20</sup> Bashkëpunimi Gjyqësor i Bashkimit Europian (EUROJUST) është rrjeti i parë i përhershëm i autoriteteve gjyqësore, themeluar në vitin 2002 për të thelluar bashkëpunimin në rastet e drejtësisë penale kudo në

---

<sup>18</sup> New Warrant May Speed Extradition, 2005. <http://news.bbc.co.uk/1/hi/uk/4732219.stm> (25 May 2008). W. BRUGGEMAN, 2002: Security and Combating International Organized Crime and Terrorism, 1–46. Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145.

<sup>19</sup> <http://www.europol.europa.eu> (24 May 2008). Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145. Europe – succeeding together, Presidency Programme, 1 January to 30 June 2007. [http://www.eu2007.de/includes/Downloads/Praesidentschaftsprogramm/EU\\_Presidency\\_Programme\\_final.pdf](http://www.eu2007.de/includes/Downloads/Praesidentschaftsprogramm/EU_Presidency_Programme_final.pdf) (23 March 2008).

<sup>20</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145. [http://eurojust.europa.eu/press\\_releases/2007/30-11-2007.htm](http://eurojust.europa.eu/press_releases/2007/30-11-2007.htm) (25 May 2008). [www.eurojust.europa.eu/jits](http://www.eurojust.europa.eu/jits) (25 May 2008). [www.europol.europa.eu/jits](http://www.europol.europa.eu/jits) (25 May 2008).

Bashkimin Europian.<sup>21</sup> Zyra e Koordinimit Kundër Terrorizmit në Këshillin e Bashkimit Europian është themeluar në vitin 2004 për të adoptuar një qasje më të integruar për luftën ndaj terrorizmit dhe për një koordinim më të mirë të politikave të ndryshme të BE-së.<sup>22</sup>

## OSBE

Krijuar më 1975, Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSCE) është ndër organizatat më të mëdha të sigurisë rajonale në botë, me 56 shtete pjesëmarrëse nga Europa, Azia Qendrore dhe Amerika. Ajo përfaqëson njëkohësisht një forum të bashkëpunimit politik (për çështje që shkojnë nga paralajmërimi e parandalimi i hershëm i konfliktit, deri te menaxhimi i krizave dhe rindërtimi i pasluftës) dhe një mekanizëm veprues (nëpërmjet rrjetit të saj unik të misioneve në terren). Bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar ka qenë një prioritet i lartë për OSBE-në; për këtë qëllim OSBE ka organizuar shumë takime, konferenca dhe tryeza të rrumbullakëta në mënyrë që të përforcojë bashkëpunimin ndërmjet policive, prokurorëve dhe gjykatësve në hetimet për krimin e organizuar, si dhe për harmonizimin e legjislacionit të shteteve anëtare. Gjithashtu, ka qenë një mbështetëse dhe kontribuuese në përpjekjet botërore kundër terrorizmit.<sup>23</sup>

---

<sup>21</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145. <http://eurojust.europa.eu/index.htm> (25 May 2008).

<sup>22</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123-145. [http://ec.europa.eu/justice\\_home/fsj/terrorism/institutions/fsj\\_terrorism\\_institutions\\_counter\\_terrorism\\_coordinator\\_en.htm](http://ec.europa.eu/justice_home/fsj/terrorism/institutions/fsj_terrorism_institutions_counter_terrorism_coordinator_en.htm) (24 May 2008).

<sup>23</sup> <http://www.osce.org> (28 June 2008). <http://www.basicint.org/pubs/Notes/2002EU-OSCE.htm> (28 June 2008).

## Organizatat ndërrajonale

### Nisma e Europës Qendrore (CEI)

Nisma e Europës Qendrore (CEI) është një forum i bashkëpunimit ndërqeveritar i themeluar më 1989, për të ndihmuar vendet anëtare të Europës Qendrore në plotësimin e kushteve për anëtarësimin në BE. Pas përfshirjes së vendeve të Europës Juglindore dhe Lindore në fund të viteve '90, axhenda e CEI ndryshoi për të përfshirë bashkëpunimin ndërkufitar në luftën ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar. Aktualisht, CEI përbëhet nga 18 vende nga Europa Qendrore dhe Lindore (Shqipëria, Austria, Bjellorusia, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Çekia, Hungaria, Italia, Maqedonia, Moldavia, Mali i Zi, Polonia, Rumania, Serbia, Sllovakia, Sllovenia dhe Ukraina).<sup>24</sup> Veprimtaritë e CEI kanë përfshirë takime të rregullta me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencës, vlerësimin e mësimëve të nxjerra nga përvojat e kaluara dhe sigurimin e studimeve krahasuese mbi kërcënimet për sigurinë rajonale.<sup>25</sup>

### Procesi i Brdo-s

Procesi i Brdo-s është një forum i bashkëpunimit i CT dhe OC krijuar në vitin 2001 në Brdo pri Kranju, në Slloveni, nga një numër vendesh nga Europa Lindore dhe Qendrore (Austria, Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, FYROM, Greqia, Hungaria, Rumania, Serbi-Mal i Zi, Sllovenia dhe Turqia). Përfaqësuesit e institucioneve me kompetencat e duhura në fushën e luftës ndaj terrorizmit nga shtetet anëtare të Brdo-s mblidheshin çdo vit për të diskutuar kërcënimet e tanishme ndaj sigurisë në rajon dhe për të gjetur mënyra të përbashkëta për t'u përballur me to.

<sup>24</sup> <http://www.ceinet.org/home.php> (22 June 2008).

<sup>25</sup> <http://www.ceinet.org/home.php> (22 June 2008).

## Procesi i Bashkëpunimit i Europës Juglindore (SEECp)

Procesi i Bashkëpunimit i Europës Juglindore u krijua në vitin 1996 për të përforcuar bashkëpunimin ndërrajonal për sigurinë (p.sh.: bashkëpunimi në drejtësinë dhe çështjet e brendshme, bashkëpunimi përtej kufitar, si dhe bashkëpunimi në luftën ndaj krimit të organizuar, trafiqeve ilegale të drogës dhe armëve, dhe terrorizmit). Ai përfshin Shqipërinë, Bullgarinë, Greqinë, FYROM, Rumaninë, Serbinë, Malin e Zi, Turqinë dhe Bosnje-Hercegovinën (shkurt 2001), me Kroacinë dhe Moldavinë si vende vëzhguese.<sup>26</sup> Në vitin 2004, SEECp krijoi një Grup Këshillimi për Luftën ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit.<sup>27</sup>

## Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore

Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore (i njohur ndryshe edhe si Plani Marshall për EJL) është një forum bashkëpunimi i më tepër se 40 vendeve dhe organizatave nga EJL, krijuar më 1999 me nismën e BE-së, pak a shumë si një kusht paraprak i bashkëpunimit rajonal për çdo vend kandidat për në Bashkimin Europian. Bashkëpunimi për sigurinë garantohet nga Tabela 3 e Punës (me dy nëntabela: Siguria dhe Mbrojtja, si dhe Drejtësia dhe Punët e Brendshme). Arritjet e Tabelës së Punës në luftën ndaj krimit të organizuar përfshijnë Nismën e Paktit të Stabilitetit kundër Krimit të Organizuar (SPOC) dhe Forumin Policor (PF).<sup>28</sup> Pakti është kritikuar për ritmin e tij të ngadaltë dhe financimin e dobët, sidomos për mungesë të

<sup>26</sup> <http://www.mae.ro/seecp/history.html> (28 May 2008). South East European Cooperation Process Ministerial Joint Statement In The Field Of Justice And Home Affairs, Belgrade, 3–4 March 2003.

<sup>27</sup> **Doru-Romulus COSTEA, 2004.** [http://www.romaniaunog.org/statements/20041202\\_iom.htm](http://www.romaniaunog.org/statements/20041202_iom.htm) (23 June 2008).

<sup>28</sup> <http://www.stabilitypact.org/default.asp> (22 June 2008). Milica DELEVIC, 2007: Regional Cooperation in the Western Balkans, *Chaillot Paper*, No. 104, 5–105. Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008).



vetëfinancimit, por nuk mund të mohohet vlera e tij në përforcimin e bashkëpunimit rajonal.<sup>29</sup> Në vitin 2007 Pakti i Stabilitetit u bë Këshilli Rajonal për Bashkëpunim (RCC), një organizatë e bashkëpunimit rajonal.<sup>30</sup>

## Nisma Bashkëpunuese e Europës Juglindore (SECI)

Nisma Bashkëpunuese e Europës Juglindore (SECI) u krijua në vitin 1995 për të forcuar bashkëpunimin euroatlantik ndërmjet 13 shteteve pjesëmarrëse (Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Bullgaria, Kroacia, Greqia, Hungaria, Maqedonia, Moldavia, Rumania, Serbia, Sllovenia, Turqia dhe Mali i Zi).<sup>31</sup>

Brenda SECI, një Qendër Rajonale për luftën ndaj Kriminalitetit përtej kufitar u krijua në vitin 2000 në Bukuresht, Rumani, për të forcuar zbatimin e ligjit dhe bashkëpunimin kundër krimit ndërkufitar (lufta ndaj drogës, armëve, trafikut të qenieve njerëzore dhe emigracionit të jashtëligjshëm). Përveç 13 shteteve anëtare, Qendra e SECI ka 15 shtete mbikëqyrëse (Austria, Azerbajxhani, Belgjika, Kanadaja, Franca, Gjeorgjia, Gjermania, Italia, Japonia, Holanda, Polonia, Portugalia, Sllovakia, Spanja, Ukraina, Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA) dhe 2 këshilltarë të përhershëm (ICPO-Interpol dhe Organizatën Botërore të

<sup>29</sup> Fotios MOUSTAKIS, 2004: Soft Security Threats in the New Europe: The Case of the Balkan Region, European Security, Vol 13(1 & 2), 139–156.

<sup>30</sup> Strategic Outlook at the Priority Areas of Cooperation in South East Europe. [http://rcc.int/download.php?tip=docs&docRCCStrategicOutlook\\_200508.pdf&doc\\_url=1654e047b919225f06cc5b6e1cb12a91](http://rcc.int/download.php?tip=docs&docRCCStrategicOutlook_200508.pdf&doc_url=1654e047b919225f06cc5b6e1cb12a91) (23 June 2008).

<sup>31</sup> [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (28 May 2008). <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true> (28 May 2008). Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008). Steven WOEHRREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10.

Doganave, ose WCO). Qendra ka shtatë grupe pune, të përqendruara në trafikimin e qenieve njerëzore, emigracionin e jashtëligjshëm, trafikun e drogës, makinat e vjedhura, kontrabandën, krimet doganore, krimet financiare dhe ato kibernetike, si dhe në sigurimin e kontejnerëve të transportit në det.<sup>32</sup> Qendra e SECI drejton, organizon dhe merr pjesë në arsimimin dhe trajnimin e përbashkët, si dhe organizon mbledhje të rregullta për të luftuar krimin e organizuar dhe terrorizmin.<sup>33</sup> Ndër ushtrimet e fundit, ia vlen të përmendet Ushtrimi Rajonal i Detit të Zi Kundër Shtimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë (2007), organizuar nga Agjencia Amerikane e Reduktimit të Kërcënimeve ndaj Mbrojtjes dhe FBI, me pjesëmarrës nga Bullgaria, Gjeorgjia, Moldavia, Rumania dhe Qendra SECI. Ushtrimi simulues rriti bashkëpunimin ndër pjesëmarrësit për sa i përket testimit, komandimit dhe kontrollit, komunikimit, shkëmbimit të informacionit dhe aftësitë vepruese kundër shtimit të armëve të shkatërrimit në masë.<sup>34</sup> Gjithashtu, çdo gjashtë muaj, ekspertët e Qendrës i paraqesin vendimmarrësve analiza dhe raporte strategjike specifike për trafikun e drogës, kontrabandën e duhanit, trafikimin e qenieve njerëzore dhe emigracionit të jashtëligjshëm në Europën Juglindore.<sup>35</sup>

---

<sup>32</sup> [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (28 May 2008). <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true> (28 May 2008). Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008). Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10.

<sup>33</sup> [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (28 May 2008). <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true> (28 May 2008). Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008). Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10.

<sup>34</sup> <http://www.mai.gov.ro/engleza/Documente/Arhiva%20comunicate/2007/BI%20web%2024-30.09.en.pdf> (16 June 2008).

<sup>35</sup> [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (28 May 2008). <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true> (28 May

Megjithatë veprimtaria e SECI shkon përtej takimeve, mbledhjeve ose edhe ushtrimeve simuluese. SECI është një qendër e vërtetë operationale për bashkëpunim, e cila ka qenë shumë e efektshme dhe e suksesshme në përpjekjet e saj kundër krimit në tetë vitet e ekzistencës së saj, duke bashkëpunuar ngushtësisht me INTERPOL-in, WCO dhe organizata të tjera. Operationet e suksesshme të SECI përfshijnë: në 2002, Operacioni “Mirazh”, me pjesëmarrjen e shteteve anëtare dhe jo anëtare të SECI (p.sh.: Ukraina, Serbia dhe Mali i Zi<sup>36</sup>), i cili ka arritur të identifikojë dhe të eliminojë një numër shumë të madh rrjetesh<sup>37</sup> të trafikimit të qenieve njerëzore; në 2003, SECI luajti një rol domethënës në arrestimin e mbretit maqedonas së tregtisë së seksit, Leka<sup>38</sup>, në Mal të Zi; në 2006, Operacioni “Torino”, drejtuar nga autoritetet italiane dhe rumune dhe mbështetur nga SECI, rezultoi në arrestimin e 32 trafikantëve shqiptarë dhe rumunë të qenieve njerëzore, si në Rumani ashtu edhe në Itali<sup>39</sup>, në 2006, hetimi i përbashkët i SECI me Rumaninë, Serbinë dhe Malin e Zi, për kontrabandën e duhanit ndërmjet të dy vendeve, rezultoi në 11 arrestime në Rumani e Serbi dhe Mal të Zi, si dhe në konfiskimin e një sasive të konsiderueshme duhani dhe produktesh të tjera<sup>40</sup>; në 2007, Operacioni “Unaza”, një operacion kundër trafikut të drogës, drejtuar nga një rrjet turk OC (që vepronin në Rumani dhe Turqi, dhe me destinacion përfundimtar për shitje, Holandën), i cili çoi në kapjen e 14 personave në Turqi dhe Rumani<sup>41</sup>; dhe në 2008,

---

2008). Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008). Steven WOEHRREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10.

<sup>36</sup> Montenegro joined SECI in 2008.

<sup>37</sup> Ioan RUS. Interview by Victor IONESCU, *Balcinii si Europa*, No. 33. [http://www.balcinii.ro/index\\_html?editia=33&page=ioanrus&nr=1](http://www.balcinii.ro/index_html?editia=33&page=ioanrus&nr=1) (3 December 2007).

<sup>38</sup> Balkan Countries Step Up the Fight against Organized Crime. <http://www.sectv-exchanges.com/code/navigate.php?Id=184> (23 June 2008).

<sup>39</sup> [http://www.secicenter.org/p182/20th\\_of\\_June\\_2006](http://www.secicenter.org/p182/20th_of_June_2006) (24 June 2008).

<sup>40</sup> [http://www.secicenter.org/p185/19th\\_of\\_May\\_2006](http://www.secicenter.org/p185/19th_of_May_2006) (24 June 2008).

<sup>41</sup> [http://www.secicenter.org/p286/20\\_December\\_2007](http://www.secicenter.org/p286/20_December_2007) (26 December 2007).

Operacioni “Pëllumbi”, i cili çoi në arrestimin e 24 kontrabandistëve, të cilët ishin pjesë e dy rrjeteve që operonin në rrugën Moldavi-Ukrainë-Rumani-Hungari-Itali.<sup>42</sup>

### Bashkëpunimi ekonomik i Detit të Zi (BSEC)

Krijuar më 1992, Bashkëpunimi Ekonomik i Detit të Zi (BSEC) ishte organizata e parë rajonale krejtësisht e re në rajonin e Detit të Zi, duke përfshirë të gjitha shtetet që lagen nga ky det (Bullgaria, Gjeorgjia, Rumania, Rusia, Turqia dhe Ukraina), si dhe 5 shtete fqinje (Shqipëria, Armenia, Azerbajxhani, Greqia dhe Moldavia). Për sa i përket krimit të organizuar dhe terrorizmit, vendet anëtare të BSEC kanë firmosur një marrëveshje për Bashkëpunim në Luftën ndaj Krimit (duke përfshirë krimin e organizuar) më 1998 dhe një protokoll shtesë në vitin 2004.<sup>43</sup><http://www.bsec-organization.org/temp/cooperation.htm> (29 November 2007). [http://www.bsec-organization.org/areas\\_of\\_cooperation.aspx?ID=Cooperation\\_in\\_Combating\\_Crime](http://www.bsec-organization.org/areas_of_cooperation.aspx?ID=Cooperation_in_Combating_Crime) (28 May 2008).

### Grupi Detar i Punës i Detit të Zi (BLACKSEAFOR)

Grupi Detar i Punës i Detit të Zi (BLACKSEAFOR) është një forcë detare shumëkombëshe që përfshin gjashtë vendet e Detit të Zi (Turqinë, Rusinë, Ukrainën, Rumaninë, Bullgarinë dhe Gjeorgjinë), e cila ka si qëllim që, nëpërmjet bashkëpunimit ndërkombëtar, të reduktojë veprimtaritë e ndaluara në Detin e Zi. Ai është aktivizuar në rastet e emergjencave detare (p.sh.: operacionet e shpëtimit, nevojat humanitare, kundërterrorizmit detar, pastrimi i minave detare etj.).<sup>44</sup>

<sup>42</sup> <http://www.secicenter.org/p411/23+April+2008> (24 June 2008).

<sup>43</sup> <http://www.bsec-organization.org/temp/cooperation.htm> (29 November 2007). [http://www.bsec-organization.org/areas\\_of\\_cooperation.aspx?ID=Cooperation\\_in\\_Combating\\_Crime](http://www.bsec-organization.org/areas_of_cooperation.aspx?ID=Cooperation_in_Combating_Crime) (28 May 2008).

<sup>44</sup> Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27

## Nisma e Mbrojtjes Kufitare (BDI)

Nisma e Mbrojtjes Kufitare (BDI), gjithashtu e njohur me emrin “Nisma e Mbrojtjes Kufitare e Detit të Zi”, është një përpjekje për bashkëpunim e vendeve që lagen nga Deti i Zi (Rumania, Bullgaria, Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina), e nisur më 2004. Nën mbikëqyrjen e BDI, shtetet anëtare po drejtojnë ushtrime simuluese të ndryshme për të luftuar shtimin e armëve të shkatërrimit në masë (WMD), për të forcuar kontrollin kufitar dhe për inteligjencën rreth veprimtarive të ndaluara në lidhje me WMD në rajon.<sup>45</sup>

## Analiza e bashkëpunimit

Ekzistenca e një numri kaq të madh të instrumenteve të bashkëpunimit provon shqetësimet e përbashkëta të vendeve të Europës Juglindore dhe dëshirës për të punuar së bashku për t’u ballafaquar me to. Gjithsesi, kjo mund të shndërrohet në një sfidë për një bashkëpunim të efektshëm. Jo vetëm që disa nisma të bashkëpunimit nuk janë përdorur, por ato duken se janë bërë më shumë simbolike sesa të vërteta (duke qenë se ose u mungon menaxhimi i duhur, ose mbështetja për të qenë të efektshme, ose organizojnë takime thjesht për të pasur më shumë të tilla në të ardhmen).<sup>46</sup> Për shembull, ka tri nisma të tilla të bashkëpunimit vetëm për vendet e Detit të Zi, të tria për të luftuar terrorizmin dhe krimin e organizuar. Pakti i

---

February 2008). Orhan BABAOGLU: 2005: The Black Sea Basin: A New Axis in Global Maritime Security. <http://www.washingtoninstitute.org/templateC05.php?CID=2361> (16 June 2008). Basat ÖZTÜRK, 2007: Black Sea maritime cooperation in a context of security and environment, *PolicyWatch* #1027. [http://www.osce.org/documents/eea/2007/09/26209\\_en.pdf](http://www.osce.org/documents/eea/2007/09/26209_en.pdf) (16 June 2008).

<sup>45</sup> [http://www.roembus.org/presidency\\_agenda/2005/visit\\_march\\_2005/10cfr/speech.htm](http://www.roembus.org/presidency_agenda/2005/visit_march_2005/10cfr/speech.htm) (30 June 2008). Cristian ISTRATE, 2006: NATO and the Black Sea, *Romanian Military Thinking*, No. 1, 129–133.

<sup>46</sup> Anthony CORDESMAN, Arleigh A. BURKE, 2006: The Lessons of International Cooperation in Counterterrorism. [http://www.csis.org/media/csis/pubs/060118\\_lessonsintctcoop.pdf](http://www.csis.org/media/csis/pubs/060118_lessonsintctcoop.pdf) (16 June 2008).

Stabilitetit për Europën Juglindore ishte më shumë simbolik se i efektshëm për shkak të “autoritetit të pamjaftueshëm, caktimin konfuz të prioriteteve dhe një menaxhimi jo për t’u lavdëruar”.<sup>47</sup> SEECp, megjithëse e parë për shumë kohë si e vetmja organizatë e vetëdrejtuar rajonale, nuk shkoi tej takimeve të shpeshta të krerëve të shteteve dhe qeverive, dhe lëshimit të deklaratave pa pasoja të drejtpërdrejta; kjo e vuri në pikëpyetje efektshmërinë e procesit, sidomos duke marrë parasysh se grupet me ndikim të krimit të organizuar akoma ushtrojnë veprimtarinë e tyre në rajon.<sup>48</sup> Më tej, shumë nisma rajonale kanë preferuar zgjidhje të shpejta dhe afatshkurtra, në vend të pikësnyimeve afatgjata të rajonit, çka e ka bërë bashkëpunimin rajonal një qëllim të mirë, por pa rezultate të rëndësishme.<sup>49</sup> Gjithashtu, Europa Juglindore ka pasur më shumë instrumente diplomatike se ç’ka operuese; edhe nëse përpjekjet diplomatike janë të vlefshme në forcimin e marrëdhënieve rajonale, në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, ato nuk mund të jenë aq të efektshme në CT dhe CO sa qendrat specifike rajonale të ekspertëve të CT dhe/ose CO.

Ndërsa, në përgjithësi, të gjitha vendet e Europës Juglindore kanë pranuar nevojën e një përgjigjeje të përbashkët ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar, interesat kombëtare dhe çështjet e sigurisë kanë përparësi mbi bashkëpunimin. Për pasojë, bashkëpunimi në fushën e inteligjencës, çështjeve të

---

<sup>47</sup> Për shkak se komunitetit ndërkombëtar nuk kishte mjetet e nevojshme financiare për Ballkanin (p.sh.: miliarda) ndërsa rajonit i mungonte aftësia për t’i thithur këto shuma kaq të mëdha. Fotios MOUSTAKIS, 2004: *Soft Security Threats in the New Europe: The Case of the Balkan Region*, *European Security*, Vol 13(1 & 2 ), 139–156. Risto KARAJKOV, 2007: *Balkans: Stability Pact Goes Into History*. <http://www.worldpress.org/Europe/3017.cfm> (28 June 2008).

<sup>48</sup> Has Regional Cooperation Led to the Establishment of Balkania: Europe’s Southeastern Dimension?, *Analytica* 2007. <http://www.analyticamk.org/files/ReportNo7.pdf> (30 November 2007). Fotios MOUSTAKIS, 2004: *Soft Security Threats in the New Europe: The Case of the Balkan Region*, *European Security*, Vol. 13(1 & 2 ), 139–156.

<sup>49</sup> Has Regional Cooperation Led to the Establishment of Balkania: Europe’s Southeastern Dimension?, *Analytica* 2007. <http://www.analyticamk.org/files/ReportNo7.pdf> (30 November 2007).

brendshme dhe drejtësisë ka hasur në vështirësi: vendet kanë qenë të rezervuara në dhënien e informacioneve kombëtare në lidhje me luftën ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar, kanë hezitur të krijojnë një bazë të dhënash të integruar rajonale për krimin e organizuar (çka do të ishte shumë e dëshirueshme për të lehtësuar përdorimin e të dhënave për të gjitha agjencitë dhe institucionet e zbatimit të ligjit) dhe të paafta për të krijuar kapacitete të forta bashkëpunuese ndërmjet organeve hetuese.<sup>50</sup> Nga ana tjetër, vendet e Europës Juglindore kanë pasur ritme të ndryshme zhvillimi, të ndërtimit të institucioneve dhe të integritimeve euroatlantike, pra edhe ritme të ndryshme të reformave dhe transformimeve të institucioneve juridike dhe të sigurisë. Ato nuk kanë pasur legjislacion të përshtatshëm kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar, burime, kapacitete, metoda dhe pajisje, nga të cilat rrjetet e krimin të organizuar kanë ditur të përfitojnë, çka ka ulur efektshmërinë e bashkëpunimit.<sup>51</sup> Përfundimisht takimet e shpeshta të organizatave rajonale e ndërrajonale, ndarja e përvojës, trajnimi dhe ushtrimet simuluese në lidhje me luftën kundër terrorizmit dhe krimin të organizuar do të thellojnë bashkëpunimin në rajon. Edhe Qendra SECI ka dhënë shenja mjaft premtuese. Duke afruar së bashku ekspertë të zbatimit të ligjit nga degë të ndryshme të qeverive të vendeve anëtare dhe mbikëqyrëse, Qendra SECI ka qenë e suksesshme në ndërtimin e rrjeteve të efektshme rajonale për zbatimin e ligjit, duke kapërcyer mospërputhjet dhe mosbesimin ndërmjet shteteve ose ndërmjet institucioneve të ndryshme të të njëjtit vend (p.sh.: policisë dhe doganave, një problem mbizotërues në Europën Juglindore).<sup>52</sup> Nga ana tjetër, për sa i përket bashkëpunimit ligjor dhe juridik, Deklarata e Sarajevës (2003) e Paktit të Stabilitetit i rreshtoi vendet e Europës Juglindore

---

<sup>50</sup> A Regional Security Strategy for the Western Balkans, *Journal of Foreign Policy of Moldova*, Issue 1, 2006, 2–20.

<sup>51</sup> See Peter ANTILL, 2002: Strengthening Stability in Central Europe: Practical Approaches to Regional and Sub-Regional Cooperative Security, 1–43.

<sup>52</sup> [http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event\\_summary&event\\_id=15910](http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event_summary&event_id=15910) (29 June 2008).

në Konventën e OKB-së Kundër Krimit të Organizuar, ku vendet ranë dakord të bashkëpunojnë: për të siguruar zbatimin e hershëm dhe të plotë të Konventës së Kombeve të Bashkuara dhe tre protokolleve të saj; për të krijuar kuadrin e nevojshëm institucional dhe për të siguruar infrastrukturën e duhur për zbatimin e legjislacionit të kërkuar nga Konventa e Kombeve të Bashkuara; vendosjen e marrëveshjeve dypalëshe për ekstradimin dhe ndihmën e ndërsjellët ligjore; inkurajimin e bashkëveprimit ndërrajonal, sidomos ndërmjet autoriteteve përkatëse juridike dhe policore; sigurimin e trajnimit të nevojshëm të policisë, personelit doganor, gjykatësve dhe prokurorëve për hetimin, ndjekjen dhe dënimin e anëtarëve të krimit të organizuar.<sup>53</sup> Kjo deklaratë ishte shumë e rëndësishme kur marrim parasysh mungesën e legjislacionit të përshtatshëm kriminal, e cila ka qenë një pengesë e madhe për bashkëpunimin. Për shembull, edhe pse inteligjenca dhe aksionet e përbashkëta policore të SECI ishin jetike për arrestimin në Mal të Zi të mbretit maqedonas të tregtisë së seksit, Leka, gjyqi i tij në Maqedoni nuk do të ishte i mundur pa një marrëveshje paraprake ekstradimi ndërmjet Maqedonisë dhe Malit të Zi.<sup>54</sup> Gjithashtu, Grupi Këshillues i Prokurorëve të Europës Juglindore (SEEPAG) u krijua në vitin 2003 për të lehtësuar bashkëpunimin juridik ndërmjet Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Maqedonisë, Greqisë, Kroacisë, Moldavisë, Rumanisë, Malit të Zi, Serbisë, Sllovenisë dhe Turqisë, nëpërmjet shkëmbimit të informacioneve dhe provave në hetimet transkufitare dhe nëpërmjet asistimit të ligjvënësve në rajon në çështje të ndryshme të drejtësisë dhe zbatimit të ligjit.<sup>55</sup>

---

<sup>53</sup> Balkan Countries Step Up the Fight against Organized Crime. <http://www.seetv-exchanges.com/code/navigate.php?Id=184> (23 June 2008). <http://www.stabilitypact.org/org-crime/031028-sarajevo.asp>, (27 June 2008).

<sup>54</sup> Vendet e Ballkanit bëjnë hapa para në luftën kundër krimit të organizuar. <http://www.seetv-exchanges.com/code/navigate.php?Id=184> (23 June 2008).

<sup>55</sup> Milica DELEVIC, 2007: Regional Cooperation in the Western Balkans, *Chaillot Paper*, No. 104, 5–105.



Edhe organizata më të mëdha, si Bashkimi European, kanë pasur probleme në bashkëpunimin, sidomos në luftën kundër terrorizmit. Disa nga vendet e BE-së nuk e shohin terrorizmin si një kërcënim global, por si një “epokë e kaluar e dhunës politike me zanafillë nga Europa e viteve ’70”.<sup>56</sup> Madje, edhe pse sulmet terroriste në Madrid u panë si një 11 Shtator european, disa vende nuk e ndryshuan qëndrimin e tyre në drejtim të një strategjie të përbashkët kundërterroriste (duke përfshirë përdorimin e forcës për të luftuar terrorizmin ndërkombëtar).<sup>57</sup> Kjo është njëra nga arsyet pse BE-së i mungon një autoritet i fortë autonom i inteligjencës, i zbatimit të ligjit dhe i operacioneve kundërterroriste.<sup>58</sup> EUROPOL për shembull, mund të jetë mekanizmi kryesor i Bashkimit European për zbatimin e ligjit, por atij i mungon një mandat i efektshëm për të luftuar terrorizmin, për shkak se shtetet anëtare akoma hezitojnë t’i japin EUROPOLI-t një rol të tillë.<sup>59</sup> Nga ana tjetër, sipas studiuesve, planit antiterrorizëm të Bashkimit European i mungon koherenca në kundërshtimin e financimit të terrorizmit dhe menaxhimit të pasojave.<sup>60</sup>

Sipas të gjitha gjasave, ndërveprimi ndërmjet organizatave do ta bëjë bashkëpunimin rajonal dhe atë ndërrajonal më të efektshëm. Ia vlen të përmendet edhe progresi në rritje i bashkëpunimit dhe asistencës së ndërsjellët ndërmjet nismës

---

<sup>56</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 29(2), 123–145. A Regional Security Strategy for the Western Balkans, *Journal of Foreign Policy of Moldova*, Issue 1, 2006, 2–20.

<sup>57</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 29(2), 123–145. A Regional Security Strategy for the Western Balkans, *Journal of Foreign Policy of Moldova*, Issue 1, 2006, 2–20.

<sup>58</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 29(2), 123–145.

<sup>59</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 29(2), 123–145.

<sup>60</sup> Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol. 29(2), 123–145.

së Paktit të Stabilitetit për të Luftuar Krimin e Organizuar (SPOC), Forumit Policor (PF), SEECP, SEEPAG, Shoqërisë së Drejtuesve të Policisë të Europës Juglindore (SEPCA)<sup>61</sup> dhe Qendrës SECI.<sup>62</sup> Edhe NATO, edhe BE kanë nënshkruar marrëveshje të sigurisë (sidomos ndërmjet NATO-s dhe atyre vendeve të BE-së të cilat nuk bëjnë pjesë në NATO) për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit dhe inteligjencës.<sup>63</sup> EUROPOL bashkëpunon më një numër shtetesh dhe organizatash të treta, duke përfshirë dhe vendet e Europës Juglindore: Shqipërinë, Bosnje-Hercegovinën, Kroacinë, FYROM dhe Turqinë.<sup>64</sup>

Depërtimi i krimit të organizuar në institucionet e sigurisë në të gjithë Europën Juglindore ka qenë një pengesë e madhe për një bashkëpunim frytdhënës rajonal dhe ndërrajonal për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.<sup>65</sup> Një shembull mjaft domethënës është përfshirja në veprimtari kriminale e njësisë serbe për Operacione Speciale (e njohur

<sup>61</sup> E cila u krijua në vitin 2002 për të luftuar krimin e organizuar (ndër të tjera) dhe që në fakt mori përgjegjësinë për veprimtaritë e vitit 2007 të Forumit Policor. <http://www.sepca-bg.org/about/?a=3> (23 June 2008).

<sup>62</sup> <http://www.stabilitypact.org/default.asp> (22 June 2008). Milica DELEVIC, 2007: Regional Cooperation in the Western Balkans, *Chaillot Paper*, No. 104, 5–105. Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008).

<sup>63</sup> Frances G. BURWELL, David C. GOMPERT, Leslie S. LEBL, Jan M. LODAL, Walter B. SLOCOMBE, 2006: Transatlantic Transformation: Building a NATO-EU Security Architecture, 1–32.

<sup>64</sup> <http://www.europol.europa.eu> (24 May 2008). Doron ZIMMERMANN, 2006: The European Union and Post-9/11 Counterterrorism: A Reappraisal, *Studies in Conflict & Terrorism*, Vol 29(2), 123–145. Europe – succeeding together, Presidency Programme, 1 January to 30 June 2007. [http://www.eu2007.de/includes/Downloads/Praesidentschaftsprogramm/EU\\_Presidency\\_Programme\\_final.pdf](http://www.eu2007.de/includes/Downloads/Praesidentschaftsprogramm/EU_Presidency_Programme_final.pdf) (23 March 2008).

<sup>65</sup> Një studim i detajuar për depërtimin e krimit të organizuar në sektorin e sigurisë në Europën Juglindore është publikuar nga Qendra për Studimin e Demokracisë më 2004: Partnerë në krim. Rreziku i simbiozës ndërmjet Sektorit të Sigurisë dhe Krimit të Organizuar në Europën Juglindore. <http://unpan1.un.org/intradoc/groups/public/documents/UNTC/UNPAN017117.pdf> (23 June 2008).

ndryshe si “kapelat e kuqe”), zv/komandanti i së cilës, Zvetan Jovanović, më 2003 vrau kryeministrin serb të viteve 2001-2003<sup>66</sup>, Zvezdan Djindjić. Pas vrasjes, autoritetet serbe filluan një reformë domethënëse në institucionet e sigurisë në vend, filluan ndjekjen e grupeve të krimit të organizuar (dhe lidhjeve të tyre me bashkëpunëtorët në qeveri) dhe forcuan bashkëpunimin me Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve për Jugosllavinë (ICTY), çka çoi drejt kapjes së 4500 njerëzve dhe eliminimit të organizatave më të mëdha të krimit të organizuar në Serbi, duke përfshirë dhe grupin kriminal pas vrasjes së Djindjićit.<sup>67</sup> Korrupsioni në të gjitha nivelet qeverisëse është një problem në Europën Juglindore dhe, kur flasim për policinë doganore ose kufitare, shndërrohet në një kërcënim ndaj sigurisë rajonale, për shkak se inkurajon trafikun e jashtëligjshëm të mallrave, qenieve njerëzore dhe materialeve terroriste në kalimin e kufijve. Një përpjekje e suksesshme bashkëpunuese drejtuar kësaj sfide ishte, ndër të tjerash, Memorandumi i Mirëkuptimit (MOU) i Programit të Tregtisë dhe Transportit të SECI, nënshkruar nga nëntë prej shteteve anëtare, për të forcuar tregtinë dhe kufizuar korrupsionin dhe kontrabandën në pikat kufitare.<sup>68</sup> Bashkëpunimi dypalësh ka qenë gjithashtu frytdhënës për sa i përket luftës kundër krimit të organizuar.

## Konkluzion

Me vullnet të lirë apo të kushtëzuar nga NATO dhe BE, vendet e Europës Juglindore, janë momentalisht të lidhura mirë nëpërmjet mekanizmave bashkëpunuese të bollshme, të

---

<sup>66</sup> Vendet e Ballkanit bëjnë hapa para në luftën kundër krimit të organizuar. <http://www.seetv-exchanges.com/code/navigate.php?Id=184>, (23 June 2008).

<sup>67</sup> Vendet e Ballkanit bëjnë hapa para në luftën kundër krimit të organizuar. <http://www.seetv-exchanges.com/code/navigate.php?Id=184>, (23 June 2008).

<sup>68</sup> [http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event\\_summary&event\\_id=15910](http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event_summary&event_id=15910) (28 June 2008).

cilat variojnë nga marrëveshjet dypalëshe deri tek organizatat dhe aleancat rajonale dhe ndërrajonale. Mund të thuhet se Europa Juglindore është shndërruar nga “fuçia e barutit në Europë” në një rajon më të qëndrueshëm dhe paqësor. Në një sondazh të zhvilluar nga Financial Times në 2008 rreth vendeve më paqësore të vitit 2007, disa vende të Europës Juglindore u renditën shumë lart (Sllovenia në vendin 16, Hungaria 18, Rumania 24, Bullgaria 57, Kroacia 60, nga një total prej 140 vendesh). Renditja merrte parasysh politikën e jashtme dhe të brendshme të vendeve, duke përfshirë dhe mundësinë për veprime të terrorizmit dhe krimit të organizuar, konfliktin e brendshëm dhe dhunën politike, marrëdhëniet e mira me vendet fqinje, pjesëmarrjen në operacionet ushtarake dhe paqësore ndërkombëtare etj.<sup>69</sup> Pa dyshim, disa vende u renditën lart për shkak, ndër të tjerash, të bashkëpunimit rajonal.

Megjithatë Europa Juglindore nuk është një rajon i paprekur nga terrorizmi dhe krimi i organizuar. Së pari, në të njëjtin sondazh, vende të tjera të rajonit u renditën më poshtë (Shqipëria në vendin 79, Moldavia 83, Serbia 85, Maqedonia 87).<sup>70</sup> Më tej, sado të përkushtuara të jenë vendet e rajonit për bashkëpunim, rrjetet e terrorizmit dhe krimit të organizuar duket se janë një hap përpara çdo përpjekjeje të përbashkët rajonale; sipas një studimi në rajon, “me gjithë përpjekjet e shumta për ta ndaluar, bashkëpunimi ndërkombëtar i autoriteteve të zbatimit të ligjit nuk mund të mbajë ritmin e bashkëpunimit ndërkombëtar të kriminelëve, të cilët ishin gjithmonë një hap para ligjit”.<sup>71</sup> Prandaj, ndërsa përpjekjet për

---

<sup>69</sup> <http://www.visionofhumanity.org/gpi/results/rankings.php> (29 June 2008). [http://www.antena3.ro/Finacial-Times-Romania-pe-locul-24-in-topul-celor-mai-pasnice-state-din-lume\\_ext\\_49511\\_ext.html](http://www.antena3.ro/Finacial-Times-Romania-pe-locul-24-in-topul-celor-mai-pasnice-state-din-lume_ext_49511_ext.html) (22 May 2008) Maria ARDELEAN, 2008: Romania, in topul celor mai pasnice tari din lume, *Monitorul de Cluj*.

<sup>70</sup> <http://www.visionofhumanity.org/gpi/results/rankings.php> (29 June 2008). [http://www.antena3.ro/Finacial-Times-Romania-pe-locul-24-in-topul-celor-mai-pasnice-state-din-lume\\_ext\\_49511\\_ext.html](http://www.antena3.ro/Finacial-Times-Romania-pe-locul-24-in-topul-celor-mai-pasnice-state-din-lume_ext_49511_ext.html) (22 May 2008) Maria ARDELEAN, 2008: Romania, in topul celor mai pasnice tari din lume, *Monitorul de Cluj*.

<sup>71</sup> Milica Milica DELEVIC, 2007: Regional Cooperation in the Western Balkans, *Chaillot Paper*, No. 104, 5–105

bashkëpunim të vendeve të Europës Juglindore janë për t'u vlerësuar, ato duhet të vazhdojnë të punojnë së bashku në mënyrë më të efektshme (sidomos në nivelin operues) për të zhdukur si terrorizmin ashtu edhe krimin e organizuar (dhe paralelisht, të përshpejtojnë reformën dhe transformimin e institucioneve të tyre të sigurisë, duke çrrënjësuar depërtimin e krimit të organizuar në qeveri). Deri tani, Qendra SECI për Luftën ndaj Krimit Ndërkufitar ka qenë shumë e suksesshme në luftën e përbashkët ndaj terrorizmit dhe krimit të organizuar dhe ka shërbyer si një model për rajone të tjera (p.sh.: Qendra e Zbatimit të Ligjit GUAM, Qendra për Koordinim dhe Informim Rajonal për Azinë Qendrore, e vendosur në Kazakistan (CARICC), Këshilli i Bashkëpunimit të Gjirit dhe një qendër e ngjashme në Kolumbi), ose ka rezultuar në kërkesën e vendeve të tjera për t'iu bashkuar organizatës (p.sh.: Bjellorusia dhe Izraeli).<sup>72</sup> Si përfaqësues ligjor (ministri i Drejtësisë) i SHBA-së, Mark Philip, vlerësoi: “Qendra SECI është një institucion unik në Europë dhe po bën një punë më të mirë se çdo institucion tjetër në Europë”.<sup>73</sup> Megjithatë, ajo ka nevojë të përforcojë bashkëpunimin e saj me mekanizma të tjerë të zbatimit të ligjit dhe bashkëpunimit gjyqësor në rajon, si EUROPOL, SEPCA, SEEPAG etj. Shpresohet se kjo do të arrihet nga e sapokrijuara RCC, objektivi kryesor i së cilës është rritja e

---

<sup>72</sup> [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (28 May 2008). <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true> (28 May 2008). Melanie H. RAM, 2001: Black Sea Cooperation towards European Integration, 1–20. <http://www.irex.org/programs/symp/01/ram.pdf> (27 February 2008). Steven WOEHREL, 2008: Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service (CRS) Report for Congress (Order Code RL33012), 1–10. <http://ue.mae.ro/index.php?lang=en&id=31&s=6181&arhiva=true>; [http://www.secicenter.org/m106/About\\_SECI](http://www.secicenter.org/m106/About_SECI) (16 June 2008). <http://www.stabilitypact.org/pages/press/detail.asp?y=2003&p=44> (16 June 2008). [http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event\\_summary&event\\_id=15910](http://www.wilsoncenter.org/index.cfm?fuseaction=events.event_summary&event_id=15910) (16 June 2008).

<sup>73</sup> <http://www.secicenter.org/p416/20+May+2008> (24 June 2008).

rolit të Qendrës SECI, dhe ta shndërrojë atë në agjencinë e zbatimit të ligjit në Europën Juglindore dhe të forcojë bashkëpunimin e SECI me organizatat e ngjashme.<sup>74</sup>

*Florina Cristiana (Cris) Matei është studiuese e asociuar pranë Qendrës për Marrëdhëniet Civilo-Ushtarake (CCMR), Shkolla Detare Pasuniversitare (NPS), Monterey, CA, USA.*

---

<sup>74</sup> Strategic Outlook at the Priority Areas of Cooperation in South East Europe. [http://rcc.int/download.php?tip=docs&doc=RCCStrategicOutlook\\_200508.pdf&doc\\_url=1654e047b919225f06cc5b6e1cb12a91](http://rcc.int/download.php?tip=docs&doc=RCCStrategicOutlook_200508.pdf&doc_url=1654e047b919225f06cc5b6e1cb12a91) (23 June 2008).

MICHAEL HEALEY

“NJERIU USHTARAK”, SHOQËRIA DHE  
TEORIA E MARRËDHËNIEVE CIVILO-  
USHTARAKE: NJË PËRMBLEDHJE TEORIKE

Më 1960, një ish-gjeneral amerikan reflektoi mbi një ndryshim themelor në shoqërinë amerikane kur ai observoi saktësisht: “organizimi ynë ushtarak i ditëve të sotme lejon pak marrëdhënie nga ajo që njihet nga paraardhësit tanë në kohë paqeje”.

Duke shprehur një shqetësim mbi rritjen e sipërmarrjeve ushtarake dhe industrisë së armatimeve, Gjenerali paralajmëroi për shfaqjen e “kompleksit ushtarak-industrial”, i cili do të kërkojë “arritjen e influencës së panevojshme”. Në retrospektivë, parashikimet e gjeneralit mund të duken alarmante, shqetësimi i tij i pabazuar dhe vëzhgimet e tij mbi organizimin ushtarak të dukshëm. Sidoqoftë, kur presidenti Dwight D. Eisenhower bëri këtë koment në fjalimin e tij të lamtumirës, të paktë ishin ata që e kuptuan se ai po komentonte një dilemë dhe një teori që, nga të gjitha gjasat, daton me shkrimet e strategut të famshëm të Luftës Prusiane të shekullit XIX, të Karl Von Clausewitz; teoria e marrëdhënieve civilo-ushtarake. Në bazë të saj, teoria studion marrëdhënien ndërmjet leadershipit politik dhe atij ushtarak. Në pjesën e parë të saj, ajo përpiqet t’i përgjigjet tre pyetjeve themelore në lidhje me: 1) natyrën e qenësishme të profesionit të ushtarakut dhe trupës së zyrtarëve në shoqëri; 2) ekuilibrin optimal të fuqisë politike dhe ushtarake në procesin e vendimmarrjes; 3) ndikimet relative të faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në formimin e ekuilibrit të fuqisë civile dhe ushtarake. Ky artikull ofron një përmbledhje të literaturës aktuale në lidhje me mosmarrëveshjet mbi këto çështje qendrore dhe vlerëson vlefshmërinë e një sërë argumenteve.

## Natyra e profesionistit ushtarak

Natyra e profesionit ushtarak qëndron në zemër të teorisë së marrëdhënieve civilo-ushtarake. A është profesioni i ushtarit kundër rrezikut apo i prirur në rrezik, esencialisht agresiv apo konservativ, ideologjik apo realist? Mënyra si u përgjigjen studiuesit këtyre pyetjeve themelore, në fund të fundit influencon perceptimin e tyre për funksionin që do të shërbejë në shoqëri ushtaraku po ashtu edhe se çfarë faktorësh formojnë ekuilibrin e marrëdhënieve civilo-ushtarake. Po t'i përmbledhim, përgjigjet e këtyre pyetjeve presupozohen nga deklarimi se në të vërtetë oficeri ushtarak është një profesionist. Ndonëse ka një marrëveshje të përgjithshme se ushtarakët perëndimorë kanë qenë profesionalisht të organizuar që në shfaqjen e Stafit të Përgjithshëm Prusian në mes të shekullit XIX, studiuesit kanë mosmarrëveshje mbi mënyrën se si ushtarakët profesionistë ndryshojnë nga profesionistët në fusha të ndryshme dhe se si kjo influencon rolin e tyre në shoqëri.

Tipikisht, konceptimet mbi natyrën e profesionit ushtarak lëkundën ndërmjet dy kampeve: ata që e shohin profesionin ushtarak si të dhunshëm dhe të prirur për luftë dhe ata që e shohin profesionin ushtarak si pacifistë dhe të kujdesshëm. Harold Lasswell, një nga teoristët më me influencë të marrëdhënieve civilo-ushtarake të gjysmës së parë të shekullit XX, ishte një mbështetës i kampit të parë. E zhvilluar përgjatë kursit të Luftës II Botërore, teoria e tij e “shtetit ushtar” përfytyronte një shoqëri të drejtuar nga “specialistët e dhunës”, një term që ai përdori për të përshkruar elitën e mundshme drejtuese ushtarake. Duke besuar se bota është në një gjendje pak a shumë të vazhdueshme të luftës, Lasswell argumentoi se elita ushtarake do të ulte rëndësinë e masës dhe do t'i bashkonte ato me përpjekjen e luftës totale. Megjithatë, thelbi i historisë së tij ishte besimi i tij se ushtarakët preferonin luftën ndaj paqes.

Në 1957, Samuel Huntington paraqiti një punim vendimtar, një këndvështrim sfidues ndaj modelit të “shtetit ushtar” të Lasswell-it, “ushtari dhe shteti” (Huntingtoni 1959). E konsideruar si një thellim i studimit të marrëdhënieve civile-



ushtarake, teoria e Hantingtonit sjell shpjegimin më të kujdesshëm deri tani të natyrës dhe rolit të ushtarakut në shoqëri. Si ekuivalenti i ushtarakut, “njeriut ekonomik” i Adam Smith ose “princit” politik i Makiavelit, “njeriu ushtarak” i Hantingtonit është një paraqitje mbi pikëpamjen botërore për zyrtarin ushtarak. Ajo është një përpjekje për të kuptuar motivimet e tij, vlerat e tij dhe etikën e tij. Hantingtoni bie dakord që qëllimi i ushtarakut profesionist është “menaxhimi i dhunës”, por në të kundërt me Lasswell, ai ofron një portret të ushtarakut profesionist ku ai “rrallë favorizon luftën”. Njeriu ushtarak, në këndvështrimin e Hantingtonit, ka cilësi pacifiste: “Ai ka frikë nga lufta. Ai dëshiron të përgatitet për luftën. Por ai nuk është kurrë gati të luftojë në një luftë”. Për më tepër, ndërsa njeriu profesionist ushtarak njihet përgjegjësia e tij në mbrojtjen e sigurisë së shtetit, ai e sheh luftën si një rezervë të fundit, e cila duhet ndërmarrë vetëm atëherë kur fitorja është e sigurt. “Njeriu ushtarak normalisht kundërshton papërgjegjshmërinë, agresivitetin, veprimet agresive”, shkruan Hantingtoni, dhe ai beson se lufta “nuk është një alternativë e cila duhet pranuar si një rezervë e fundit... kur produkti është një siguri virtuale”.

Ajo që argumenton Hantingtoni është se profesionisti ushtarak është i dhënë drejt një etike që është “realiste dhe konservative”. Në lidhje me këtë, ai ndryshon shumë nga etika ushtarake ideologjike dhe natyrisht agresive e propozuar nga Lasswell. Në fakt, Hantingtoni kritikon në mënyrë të qartë paraardhësit e tij në këtë pikë, duke akuzuar se linja e mendimit lasswelliane ka “keqkuptime në lidhje me përmbajtjen e vlerave ushtarake”. Përveç kësaj, Hantingtoni duket se është pjesërisht dakord me Lasswellin rreth potencialit për tejzgjatje të fuqisë ushtarake në shtet. Përderisa profesionisti ushtarak është në përgatitje të vazhdueshme për luftë dhe favorizon vetëm veprimin e dhunshëm kur fitorja është e qartë, Hantingtoni pohon se “nëse lufta me një fuqi të veçantë është e pashmangshme në një periudhë të mëvonshme kur kemi një rënie të shanseve për sukses, njeriu ushtarak do të favorizojë “luftën parandaluese” në mënyrë që të mbrojë sigurinë kombëtare”. Hantingtoni thotë gjithashtu se një forcë e

mjaftueshme ushtarake është e nevojshme si për të siguruar paqen, “shteti që dëshiron paqen duhet të jetë i armatosur mirë”, ashtu edhe, si një zgjatim, në mbrojtje të sigurisë së shtetit.

Implikimet e kësaj situatë janë të qarta: ushtarakët duan të shmangin luftën sepse të gjitha luftërat rrezikojnë sigurinë e shtetit, por në mënyrë që të parandalojnë luftën, njeriu ushtarak duhet të përgatitet dhe të fuqizojë forcat e tij në mënyrë konstante. “Shtetet e dobëta”, në pikëpamjen e Hantingtonit “inkurajojnë sulmin”, kështu që si rezultat, Hantingtoni konkludon që “ushtaraku në shqetësimin e tij në lidhje me pushtetin mund të konsiderojë akumulimin e fuqisë si një përfundim të pavarur në vetvete nga përdorimet në të cilat mund të përdoret ai”. Në mënyrë të ngjashme, Lasswell nënkuptonte se drejtuesit e shtetit të tij ushtarak, p.sh.: zyrtarët ushtarakë, “do të kenë një interes profesional në shumëfishimin e mjeteve të specializuara për aktet e dhunshme”. Sigurisht, ndryshimi themelor ndërmjet dy argumenteve është se shteti i Hantingtonit vendos kontrollin civil mbi atë ushtarak, ndërsa në skenarin e Lasswellit, shteti është ushtria. Përmbledhtazi, Hantingtoni nuk bie dakord me Lasswellin mbi vlerat natyrore të etikës ushtarake, por bazuar në obligimet e profesionit ushtarak në vetvete, ai bën me njohje një shkak për t’u shqetësuar ashtu si te “shteti ushtar” i Lasswellit edhe pse në një shkallë më të vogël.

Këto zhvillime në hapat e Hantingtonit shpesh janë në harmoni me thirrjen e tij për kontrollin civil mbi atë ushtarak, por në mënyrë të shpejtë ato treguan se versioni i tij i idealizimit të profesionistit ushtarak shpesh nuk është në përputhje me realitetin (Cohen, 2001). Eliot Cohen, për shembull, teston disa premisa në argumentin e Hantingtonit kundër evidencave empirike ekzistuese. Ai argumenton se teoria e Hantingtonit, ose siç e quan ai, “teoria normale e marrëdhënieve civilo-ushtarake”, përmban disa gabime në konceptin e tij të profesionalizmit ushtarak.

Së pari, Cohen bën përjashtime në vlerësimin e Hantingtonit se aftësitë e zyrtarëve ushtarakë janë “universale” përtej kohës dhe vendit, duke argumentuar se aftësitë e

nevojshme për zyrtarët shpesh variojnë dhe diktohen nga natyra e luftës në të cilën ata po luftojnë. Së dyti, ai argumenton kundër thënies së Hantingtonit se forcat më efektive janë ato të motivuara nga idealet më tepër se sa nga ideologjia. Në kontrast, Cohen vëren se ushtritë e motivuara ideologjikisht, si ato të Gjermanisë Naziste ose BRSS, kanë provuar shpesh se janë efektive dhe forca ushtarake profesionale, ndonëse kanë fituar ose jo luftërat. Së treti, Cohen sugjeron se problemi më i thellë me përkufizimin e Hantingtonit për profesionalizimin e ushtrisë është se, ndryshe nga profesionet e tjera, zyrtari ushtarak rrallë e praktikon atë për të cilën ai është i trajnuar të bëjë. Kjo mungesë eksperience në këndvështrimin e Cohen, dobëson cilësitë profesionale të zyrtarëve dhe çon drejt gabimeve në luftë.

Disa studiues të tjerë bashkëkohorë kanë sfiduar deklaratën themelore të Hantingtonit se profesioni ushtarak është kundër rrezikut dhe konservativ (Posen, 1984; Snyder, 1991). Në analizën e tij për origjinën e Luftës II Botërore, Jack Snyder fajëson një “paragjykim ofensiv” prej natyre për profesionin ushtarak si një prej faktorëve kyçë që çon në shpërthimin e dhunës. Ai sheh dy arsye kryesore për tendencën ushtarake për sulm. E para qëndron mbi vlerësimin strukturalist realist të Kenneth Waltz që “shtetet janë socializuar me implikimet e anarkisë ndërkombëtare”. Ndërsa Snyder është në harmoni me Hantington sipas së cilit trajnimi i profesionistëve ushtarakë i bën ata të shohin botën në termat e kërcënimit për sigurinë e shtetit, ai beson se kjo do të çojë në më shumë luftëra, jo më pak. Në këndvështrimin e Snyderit “profesionistët ushtarakë tentojnë të mbajnë një vizion të thjeshtëzuar me shumë zero të politikës ndërkombëtare dhe natyrës së luftës, në të cilën luftërat shihen si të vështira për t’u shmangur dhe përgjithësisht të pamundura për t’u kufizuar”. Duke e parë luftën si të pashmangshme, profesionisti ushtarak do të rrisë mundësinë e luftës duke adoptuar doktrinat sulmuese të bazuara në një strategji preventive.

Një shpjegim i dytë për “paragjykimet ofensive” të profesionit ushtarak janë të lidhura me të parën, por i kanë rrënjët në teorinë organizative. Të ngarkuara për të përballuar

risqe dhe sfida të caktuara, organizatat tentojnë të zhvillojnë rutinat dhe “procedurat operuese standarde” për të reduktuar pasiguritë. E parë me këto lente, Snyder e sheh ushtrinë si jo të ndryshme nga çdo organizim tjetër i madh; doktrina ofensive është në thelb një përgjigje organizative e dizenuar për të reduktuar pasiguritë e luftës “duke marrë ofensivën dhe duke ushtruar iniciativën”, ashtu si vëren Berry Posen, “është një mënyrë e strukturimit të betejës” përgjatë linjave të favorshme.

Përveç rritjes së kapaciteteve të ushtrive profesionale, vazhdimësisë së konflikteve të armatosura dhe prezencës së një “paragjykimi ofensiv”, “shtetit ushtar” i Lasswell ka dështuar të shfaqet. Ashtu si edhe “njeriu ushtarak” i Hantingtonit qëndron një vështrim i vlefshëm dhe elegant në profesionin ideal ushtarak. Por si kanë vërejtur Cohen, Snyder dhe Posen, forma e idealizuar shpesh humb fuqinë e saj shpjeguese kur përballet me botën reale. Literatura e tanishme reflekton disa mosmarrëveshje thelbësore në cilësitë natyrore të profesionit ushtarak dhe këto kanë implikime për mënyrën se si e gjejnë studiuesit ekuilibrin optimal të lidërshipt politik dhe ushtarak.

## Ekulibri optimal i marrëdhënieve civilo-ushtarake

Vendosja e një ekuilibri optimal ndërmjet liderëve politikë dhe ushtarakë sjell me vete një set me hipoteza dhe probleme përkufizimi. Së pari, ai nënkupton se është e mundur të identifikosh një marrëdhënie optimale. Së dyti, duke e marrë këtë si të mundshme, bëhet e nevojshme të përkufizosh se si ekuilibri optimal duhet të matet. Ndërsa Hantingtoni besonte se është e mundur të përkufizosh ekuilibrin optimal “në abstrakt”, ai bëri me dije se duhet të kishte një marrëveshje mbi premiset në lidhje me natyrën dhe qëllimin e ushtrisë. Ndryshimet mbi këto çështje kanë tentuar të formojnë argumentet pasuese dhe si rezultat studiuesit e kanë përkufizuar marrëdhënien optimale civilo-ushtarake të bazuar tipikisht mbi interpretimet e tyre për profesionin ushtarak dhe matjeve të tyre mbi optimalen. Ky seksion ekzaminon tre

koncepte të ndryshme të marrëdhënieve civilo-ushtarake më të favorshme.

Për Hantingtonin, marrëdhënia ideale ndërmjet lidërshipt politik dhe trupave të zyrtarëve ushtarakë është prezente atëherë kur politikanët ushtrojnë “një kontroll objektiv civil” mbi ushtrinë. Kontrolli objektiv civil kërkon maksimalizimin e profesionalizmit dhe autonominë si e kundërta e “kontrollit subjektiv civil”, e cila përpiqet të civilizojë ushtrinë ose ta përfshijë atë në procesin politik për ta bërë lehtësisht më të përkushtuar ndaj shtetit. Kontrolli subjektiv, në këndvështrimin e Hantingtonit, mund të çojë në kufizimin e pushtetit të trupave zyrtare, por ajo e bën këtë në kurriz të sigurisë kombëtare.

Duke besuar se funksioni i parë i ushtrisë është të ruajë sigurinë kombëtare, Hantingtoni natyrisht favorizon ato përgatitje që mund të maksimalizojnë efektivitetin e organizimit ushtarak. Ashtu si Klausewitz përpara tij, Hantingtoni pa nevojën për një ndarje të qartë ndërmjet politikanit dhe zyrtarit ushtarak: kreu i shtetit bën politikën dhe zyrtari ushtarak zbaton këtë politikë duke përdorur aftësitë dhe burimet më të mira që ai posedon. Aq sa, zyrtari ushtarak ka autoritetin mbi çështjet operacionale dhe taktike ndërsa kreu i shtetit ndërton strategjinë. Duke e marrë të mirëqenë se trupat e zyrtarëve mund të arrijnë profesionalizmin ideal të Hantingtonit, ekuilibri optimal i marrëdhënieve civilo-ushtarake do të arrihet, për arsye se ushtria do të ketë një kuptim të qartë dhe një pranim për rolin e tyre mbështetës.

Ndërsa shumica e studiuesve bien dakord se disa forma të kontrollit civil janë më të favorshme për sigurinë kombëtare, disa kanë arritur në konkluzione të ndryshme rreth ekuilibrit optimal civilo-ushtarak. Cohen e nis duke nxjerrë në pah probleme në konceptin e Hantingtonit të ndarjes ose “hendekut” ndërmjet lidërshipt politik dhe ushtarak. Në praktikë, Cohen thotë se shpesh ka një shkrirje të politikës “së lartë” të luftës, që është, vendimi strategjik i kreut të shtetit, me politikën e brendshme. Si rezultat, qëllimi i aktivitetit ushtarak bëhet i errët dhe sfidohet profesionalizmi i tij. Cohen beson se ekuilibri optimal do të derivojë nga nocioni i tij i

“dialogut të pabarabartë”. “Imperativat e politikës dhe profesionalizmit ushtarak të pandryshuara dhe të duhura, shkojnë në drejtime të kundërta”, shkruan Cohen, “gjithashtu në mënyrë të pashmangshme, gjykimet profesionale kërkojnë një ekzaminim kritik më tepër se sa një pranim të pamenduar”. Në kundërshtim me Hantingtonin, Cohen thotë se mosmarrëveshja ndërmjet profesionistëve politikë dhe ushtarakë është e nevojshme për të prodhuar vendimin politiko-ushtarak më eficient.

Në një studim më të vonshëm, Risa Brooks ndërton mbi punën e Cohen dhe argumenton se marrëdhënia ideale politiko-ushtarake është ajo që prodhon mjedisin më të mirë për një vlerësim strategjik (Brooks, 2008). Duke ndarë këndvështrimin e Cohen, sipas të cilit dialogu dhe bashkëpunimi ndërmjet lidërshpit politik dhe ushtarak është një përbërës esencial në vendimmarrjen efektive, Brooks na ofron një kornizë për të ndërtuar marrëdhëniet “më të mira” civilo-ushtarake. Brooks krijon matrica për të vlerësuar të dy variablat, por pika më e rëndësishme e studimit të saj është konkluzioni i saj se një ndarje e fortë e fuqisë politike nga ajo ushtarake jo vetëm që nuk është e mundur, por gjithashtu, në kundërshtim me Hantingtonin, është i dëmshëm për sigurinë kombëtare.

Argumente të tjera janë sjellë nga studiuesit që punojnë në kufij të marrëdhënieve civilo-ushtarake, puna e të cilëve nuk është më pak e rëndësishme në këtë fushë. Stanislav Andreski, një sociolog që ka shkruar më 1954 (përpara Hantingtonit), ekzaminon ndikimin e organizimit ushtarak në stratifikimin e shoqërisë (Andreski, 1954). Ndonëse marrëdhëniet civilo-ushtarake nuk ishin në fokusin primar të librit të tij, argumentet e tij përmbajnë kuptime të dobishme rreth ekuilibrit optimal të fuqisë politike dhe ushtarake. Për shembull, Andreskit i është atribuar shpikja e termit “Shkalla e Pjesëmarrjes Ushtarake”. SHPU ishte mënyra e Andreskit për të matur “përpjesëtimin e individëve të përdorur ushtarakisht në raport me popullsinë totale”. Ai bënte dallimin ndërmjet SHPU aktuale në çdo shoqëri të dhënë dhe SHPU optimale, të cilën ai e përcaktoi si shkallën e “kushteve të dhëna

tekniko-taktike që do t'i lejojnë një shteti të arrijë maksimumin e forcës ushtarake”. Prandaj, në këndvështrimin e Andreskit për ekuilibrin optimal, ka të bëjë më tepër me fuqinë totale të ushtrisë dhe jo sigurinë ushtarake në vetvete.

Së fundmi, Julian Schofield vlerëson implikimin e “teorisë së militarizimit” tradicionale në marrëdhëniet civilo-ushtarake (Schofield, 2007). Ai argumenton se ekuilibri optimal në influencën civilo-ushtarake qëndron në “polarizimin e mjedisit”, një term që ai e përdor për të përshkruar numrin e aleatëve vis-à-vis (përballë) numrit potencial të ndërhyrësve në një konflikt.

Mbi të gjitha, teoricientët e marrëdhënieve civilo-ushtarake kanë hezitur në dallimin e një “marrëdhënieje optimale”. Ky hezitim e ka origjinën, pjesërisht, në vështirësinë për të përkufizuar natyrën e profesionit ushtarak dhe rolit të tij në shoqëri. Por në mënyrë që të ndërtojë idealin, është gjithashtu e nevojshme të kuptohen forcat që përcaktojnë marrëdhëniet aktuale civile-ushtarake. Gjithashtu, studiuesit janë ndarë në kampe: ata që janë pjesërisht për përcaktuesit e jashtëm, ata që favorizojnë përcaktuesit e brendshëm, dhe ata që janë diku në mes.

## **Përcaktuesit e jashtëm dhe të brendshëm të marrëdhënieve civilo-ushtarake**

Shumica e studiuesve të shqetësuar nga variablat e jashtëm janë përqendruar në rolin e mjedisit kërcënues ndërkombëtar në marrëdhëniet civilo-ushtarake. Lasswell dhe Andreski ishin të parët që e prekën këtë pikë. Në modelin e Lasswell-it, mjedisi i jashtëm kërcënues në rritje prodhoi “shtetin ushtar” dhe dobësoi marrëdhëniet civilo-ushtarake duke vendosur ushtrinë në pushtet. Në këndvështrimin e Andreski-t, megjithatë, një rritje e kërcënimit të jashtëm do të përmirësojë kontrollin civil sepse ai fokuson energjinë ushtarake jashtë shtetit dhe prodhon një efekt shtresëzues në shoqëri. Gjithashtu Andreski argumenton se një ulje e kërcënimit të jashtëm do të ketë efektin e kundërt në fokusimin e energjisë në një drejtim të brendshëm duke përkeqësuar pabarazinë

shoqërore. Për Lasswelli-n dhe Hantingtoni-n kjo situatë nuk përbënte një shqetësim, sepse ata e shihnin ndjeshmërinë e kërcënimit të jashtëm si të pandryshueshëm.

Më 1999, Michael Desch ndërmori një studim duke ekzaminuar se si ndryshimet në mjedisin kërcënues ndërkombëtar preknin fuqinë e kontrollit civil të ushtrisë (Desch, 1999). Ai ishte i motivuar nga implikimet e “mjedisit të sigurisë ndërkombëtare më pak të sfidueshëm të epokës së post-Luftës së Ftohtë” për të ardhmen e marrëdhënieve civilo-ushtarake. Ndonëse ky supozim i veçantë ka nevojë për rikonsiderimin serioz, ai prezantoi një argument solid që shkrinte përcaktuesit e jashtëm dhe të brendshëm. Sipas Desch, struktura e sistemit ndërkombëtar prodhon ndryshime të brendshme në nivelet individuale, organizative dhe shoqërore. Kështu që, konkludon ai, “prototipat e kontrollit civil janë të formuara nga ndërveprimi i këtyre attributeve të brendshme me mjedisin e jashtëm”.

Argumenti i Andreski-t mund të konsiderohet gjithashtu “shkrirës” në atë që ai konsideron impaktin e “kushteve tekniko-taktike”. Ky term ndriçon një temë më të gjerë të argumentit të Andreski-t në lidhje me impaktin e fuqizimit dhe përdorimit të teknologjive të reja luftuese në marrëdhëniet civilo-ushtarake: “masa e superioritetit të forcave të armatosura mbi popullsinë e paarmatosur varet në radhë të parë nga cilësia e armatimeve”. Duke e mundësuar ushtrinë “për të qenë në gjendje të furnizojnë dhe të mbajnë veten e tyre”, Andreski beson se një SHPU e lartë do të prodhojë një efekt shtresëzues brenda shoqërisë. Ndonëse ky kontroll civil i fuqizuar varet ose jo në natyrën e kërcënimit të sigurisë.

Ndërsa pa harruar rëndësinë e forcave të jashtme, disa studiues janë fokusuar vetëm në përcaktuesit e brendshëm për të shpjeguar ekuilibrin e fuqisë civilo-ushtarake. Duke përdorur “teoritë ndërkombëtare”, Brooks pa tre faktorë primarë që ndikojnë marrëdhënien civilo-ushtarake: 1) pozicionin dhe influencën e establishmentit ushtarak në shoqërinë e brendshme; 2) bashkimin e trupave zyrtare ushtarake; 3) bazën e mbështetjes së lidërshiptit politik. Kështu që, në këndvështrimin e Brooks pozicioni relativ i ushtrisë në shoqëri varet së pari në çështjet politike të brendshme, jo nga forcat



strukturore ndërkombëtare. Ajo verën se “fuqia ushtarake në një shtet varet në kapacitetin e saj për të kultivuar dhe mbajtur aleatë socialë ose në influencën e opinionit të masës”.

Së fundmi, është e mundur të reduktohet më tej ekuacionin dhe të shohësh në nivelin individual të njësisë së analizës. Në pjesën e tij mbi Luftën II Botërore, Snyder argumentoi se: “strategjitë ofensive të 1914-s ishin gjerësisht të brendshme në origjinë, në thelb me shkaqe burokratike, sociopolitike dhe psikologjike”, ndërsa faktorët e jashtëm ishin zakonisht “sekondarë”. Snyder beson se “paragjykimi ofensiv” natyror i zyrtarëve ushtarakë mund të marrë përsipër në mënyrë efektive procesin e vendimmarrjes dhe të reduktojë inputin civil.

## Konkluzione

Ky artikull është përpjekur të hedhë dritë në teorinë komplekse të marrëdhënieve civilo-ushtarake duke rishikuar dijen e literaturës në këtë fushë. Ai organizon argumentet kryesore sipas tre pyetjeve primare që qëndrojnë në zemër të teorisë. Ndërsa shteti dhe ushtari i Hantingtonit qëndrojnë një kontribut teorik monumental, studime të mëtejshme kanë hapur argumentet e tij dhe kanë shfaqur dobësinë e fuqisë së tij shpjeguese dhe parashikuese. Diskursi Waltz-ian i bazuar në pikëpamjen realiste ka bërë vend për më shumë qasje të bazuara në faktorët politikë të brendshëm, modelet organizative dhe influencën individuale. Ende kuptimi thelbësor i marrëdhënieve civilo-ushtarake, siç është propozuar nga Hantingtoni, mbetet aq i aplikueshëm sot sa ka qenë gjatë Luftës së Ftohtë; pas kësaj periudhe ai karakterizoi “thelbin” e marrëdhënieve civilo-ushtarake si ekuilibrimi i “imperativave funksionale” të ushtrisë për të mbrojtur sigurinë e shoqërisë me “imperativat e shoqërisë” për të mbrojtur ideologjitë dhe institucionet e saj. Skena e politikës ndërkombëtare ka ndryshuar dhe studime të ardhshme do të përfitojnë nga një analizë se si roli në rritje i aktorëve jo shtetërorë përshtatet brenda kornizës teorike ekzistuese, por nevoja për të ekuilibruar dy imperativat e Hantingtonit do të vazhdojë.

Jonida Hoxha

## KRIMI I ORGANIZUAR NË BALLKAN SI NJË KËRCËNIM SERIOZ I SIGURISË NË BASHKIMIN EUROPIAN

Lëvizja mbarëbotërore drejt aleancave sociale dhe politike, e cila ka zgjeruar mundësitë për paqe botërore dhe aktivitet ekonomik, në mënyrë paradoksale gjithashtu ka krijuar mundësira për grupet ndërkombëtare të krimit të organizuar. Kërcënimi nga trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore dhe krimet ekonomike (si abuzimi me pronësinë intelektuale, spiunazhi industrial, tregtia në të zezë, falsifikimi i produkteve, krimi kompjuterik) janë duke u identifikuar gjithnjë e më shumë si një çështje e sigurisë kombëtare pothuajse për çdo shtet.

Pas rënies së Perdes së Hekurt, natyrshëm kartelet e krimit të organizuar “kapën” mundësinë e rritjes në Perëndim. Në një periudhë kohore relativisht të shkurtër u vendosën lidhjet kriminale, rrugët e tregtisë dhe rregullimet bankare. Zyrtarët europianë të drejtësisë kriminale raportuan një rritje të ndjeshme të aktivitetit kriminal me origjinë Europën Lindore dhe paralajmëruan që ky aktivitet shumë shpejt do të përhapej madje edhe në Shtetet e Bashkuara. Grupe të ndryshme të përfshira në trafikun e drogës dhe tregun e zi kishin operuar për vite në rajon. Megjithatë, gjithëprezenca e policisë së shtetit e bënte të vështirë veprimtarinë e karteleve të krimit të organizuar jashtë kufijve të Bashkimit Sovjetik ose vendeve të Paktit të Varshavës. Ndryshimet dramatike në Europë kontribuan në zgjerimin e mundësive kriminale; këto ndryshime përfshijnë implementimin e dispozitave të Komunitetit European nëpërmjet Aktit të vetëm European.

- Ndikimi sociopolitik i rënies së Paktit të Varshavës.
- Lëvizja e vendeve të Europës Lindore drejt ekonomive me bazë tregun.

- Ribashkimi i Gjermanisë dhe lidhjet e forta midis Europës Lindore dhe asaj Perëndimore.
- Paqëndrueshmëria qeveritare në Europën Lindore solli kontroll të reduktuar mbi krimin.

**Globalizimi:** Megjithëse krimi i organizuar gjithmonë i ka kaluar kufijtë shtetërorë, ai është bërë gjithnjë e më tepër ndërkombëtar në qëllimet e tij. Kjo formë e krimit është rritur në Europë me eliminimin e kontrollit të brendshëm të kufijve të Komunitetit European dhe hapjen e kufijve të Europës Lindore. Automjetet dhe mallrat e konsumit përbënin objektivat kryesore në fillim të viteve '90. Krimi ndërkombëtar përfshin biznese të vazhdueshme dhe shembujt më të mirë janë: trafikimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, pastrimi dhe falsifikimi i parave, si dhe tregu i zi. Ambienti i sigurisë i komunitetit transatlantik ka ndryshuar dramatikisht që prej mbarimit të konfliktit Lindje-Perëndim. Sfidat kryesore të sigurisë nuk janë më kërcënimi i luftërave të mëdha nga shtetet armike, por rreziqet e sigurisë të vendosura nga aktorë jo shtetërorë. Në ditët e sotme asnjë hartues i politikave të jashtme në komunitetin atlantik nuk flet më për sigurinë pa përmendur terrorizmin, krimin e organizuar apo dështimin e shtetit. Rreziqet e krimit të organizuar, trafikimit të qenieve njerëzore, armëve dhe drogës ndikojnë drejtpërdrejtë në Bashkimin European.

## Përkufizimi

Termi **Krim i organizuar ballkanik** i referohet grupeve të krimit të organizuar që kanë origjinën ose operojnë në Shqipëri, Bosnje-Hercegovinë, Kroaci, Kosovë, ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Serbi, Mali të Zi, Bullgari, Greqi dhe Rumani. Krimi i organizuar në Ballkan ka rrënjët e tij në strukturat tradicionale të klaneve. Në këto vende kryesisht rurale, njerëzit organizoheshin në klane me lidhje të mëdha familjare për mbrojtje dhe ndihmë reciproke. Duke filluar që prej shekullit XV, marrëdhëniet e klanit vepronin nën një kod apo kanun, i cili vlerësonte besnikërinë dhe besën

ose konfidencialitetin. Elementët e trashëguar në strukturën e klaneve siguronin mbështetjen kryesore për atë që konsiderohet në kohët moderne “Krim i organizuar ballkanik”. Kolapsi i komunizmit në fund të viteve '80 dhe fillimin '90, çoi në zgjerimin e aktiviteteve të krimit të organizuar ballkanik. Tregjet kriminale që dikur kishin qenë të mbyllura për grupet ballkanike, papritur u hapën dhe kjo udhëhoqi krijimin e një rrjeti ndërkombëtar. Brenda vendeve ballkanike, grupet e krimit të organizuar u infiltrovan në institucionet e reja demokratike, duke zgjeruar më tej mundësitë e tyre të përfitimeve. Rrathët e krimit të organizuar manipulojnë dhe monopolizojnë tregjet financiare ose institucionet tradicionale dhe legjitimojnë industrinë. *Vetëm ndikimi ekonomik është tronditës; llogaritet që krimi i organizuar global mbledh përfitime ilegale rreth 6 trilionë \$ të ardhura në vit (vlerësim jozyrtar), e cila përbën 2-5% të GDP-së botërore (Gross Domestic Product - Produkti i Brendshëm Bruto).* Forma më e vlefshme e kontrabandës që kalon në rajon është heroina. Europa Juglindore shtrihet përgjatë rrugës më të përshtatshme (e ashtuquajtura “linja ballkanike”), midis furnizuesit të 90% të heroinës në botë (Afganistanit) dhe tregut më fitimprurës dhe konsumues të tij (Europës Perëndimore). Vlerësohet se rreth 100 ton heroinë kalojnë nga Europa Juglindore drejt Europës Perëndimore, nga të cilat 85 ton përfundimisht i sjellin një fitim konsumatorit prej 25-30 bilionë \$ amerikanë. Kjo shumë është më e madhe se GDP-ja e shumicës së vendeve të rajonit dhe për pasojë ky kalim ka fuqi të lartë korruptuese.

## Masa ndërkombëtare

Trafikimi i femrave, drogës, armëve, kontrabandës dhe pastrimi i parave janë aktivitetet mbizotëruese të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar ballkanik. Krimi i organizuar në Ballkan tashmë ka dorë edhe në biznesin e energjisë në rajon dhe po bëhet gjithnjë e më tepër e vështirë për të dalluar ndërmjet grupeve kriminale dhe grupeve terroriste dhe ajo që theksohet tashmë, është nevoja për një përgjigje

ndërkombëtare ndaj arritjeve të krimit të organizuar. Krimi i organizuar është zgjeruar si në qëllime ashtu edhe në shtrirje. Ky fenomen nuk është vetëm një problem ballkanik por një përpjekje kriminale ndërkombëtare që përfshin grupe që nga Amerika Latine e deri tek Azia Qendrore, shumë prej të cilëve kanë lidhje me grupet kriminale në Ballkan. Me qëllim që këto grupe të krimit të organizuar të luftohen në mënyrë efektive, shumica e vendeve në rajon kanë bërë përpjekje në shkallë të ndryshme, për të përmirësuar legjislacionin e tyre, reformuar agjencitë e zbatimit të ligjit dhe për të krijuar rrjete rajonale për të luftuar krimin e organizuar.

Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar përbën një përpjekje për këtë problem global imediat. Kjo konventë, e cila hyri në fuqi më 29 shtator 2003, është instrumenti kryesor ndërkombëtar në luftën kundër krimit të organizuar ndërkombëtar. Konventa plotësohet më tepër nga tre protokolle; për trafikimin e qenieve njerëzore, për emigrimin e paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit. Shtetet, të cilat ratifikojnë këtë instrument, detyrohen të marrin një sërë masash kundër krimit të organizuar ndërkombëtar, duke përfshirë:

- Kriminalizimin e pjesëmarrjes në një grup të organizuar kriminal, pastrimin e parave, korrupsionin dhe pengimin e drejtësisë;
- Miratimin e marrëveshjeve gjithëpërfshirëse mbi ekstradimin, bashkëpunimin në zbatimin e ligjit dhe ndihmën ligjore të përbashkët;
- Promovimin e trajnimit dhe ndihmës teknike për ngritjen ose përmirësimin e kapaciteteve të nevojshme të autoriteteve kombëtare.

Të gjitha vendet e rajonit e kanë miratuar këtë konventë: Bullgaria dhe Serbia më 2001; Shqipëria, Bosnje-Hercegovina dhe Rumania më 2002; Kroacia më 2003; Moldavia dhe ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë më 2005, Mali i Zi, i cili e ratifikoi në vitin 2006.

## Paratë mbi nacionalizmin, rasti i shqiptarëve

Ndryshe nga kundërshtarët e tyre ligjorë, grupet e krimit të organizuar në Ballkanin Perëndimor janë shumetnikë, ndërkufitarë dhe të mirintegruar ndaj kundërshtarëve të tyre përkatës europianë. Grupet kriminale të organizuara ndërkombëtare nuk motivohen vetëm prej ideologjisë; ato motivohen prej së njëjtës gjë që ka motivuar kriminelët e organizuarë tradicional gjatë gjithë historisë; paratë. Trafikantët e drogës nga Kosova, Serbia, Bosnja dhe Kroacia janë të lumtur të punojnë së bashku, po ashtu si dhe prodhuesit afganë të drogës ashtu edhe me distributorët në Europën Perëndimore... Gjithashtu trafikantët e qenieve njerëzore në Ballkan veprojnë me minimumin e riskut, por shumica e suksesit të grupeve të krimit të organizuar në rajon rrjedh nga numri i partnerëve të gatshëm bashkëpunues brenda qeverisë, duke përfshirë anëtarë të policisë, doganierë, rojet kufitare dhe klasën politike. Luftërat civile në Jugosllavi dhe mosmarrëveshja e vazhdueshme në Shqipëri, siguruan një strukturë të përkryer mbi të cilën sindikatat e krimit u bënë më të forta dhe përfituan ndikim politik dhe social. Grupi kriminal i parë dhe kryesues, i cili mund të klasifikohet deri në një shtrirje si “Mafia”, është krimi i organizuar shqiptar. Përhapja e tij gjeografike gjendet midis trekëndëshit Prishtinë (Kosovë) - Tetovë (Maqedoni) - Tiranë (Shqipëri). Rëndësia e Prishtinës është e lidhur kryesisht me përdorimin e saj si pikë kalimi në linjën famëkeqe ballkanike të drogës. Tradicionalisht heroina është transportuar në Europën Perëndimore nga Turqia nëpërmjet Serbisë, Kroacisë dhe Sllovenisë. Kjo linjë u mbyll si rezultat i luftës dhe bandat shqiptare e gjetën veten në një pozicion ideal për të garantuar linja të sigurta nëpërmjet zonës së luftës. Në këtë pikë është interesante të përmendim se 4/5 e heroinës që hyn në Europë nga Azia (Afganistani), është transportuar nga shqiptarët, të cilët kanë vendosur baza përmes gjithë Europës. Ky rrjet kriminal shumë i sofistikuar ka qenë i aftë të kontrollojë shumicën e tregut të drogës në Europë dhe gjithashtu trafikimin e femrave dhe fëmijëve nga Ballkani drejt Europës Perëndimore.

E përjavshmjia belge TeleMoustique, në çështjen e 19 marsit 2008, i referohet klaneve të mafias shqiptare si dominuese, udhëheqëse të tregtisë së paligjshme, duke përfshirë trafikimin e qenieve njerëzore dhe shitjen e heroinës dhe kokainës. Sipas vlerësimit të policisë zvicerane, shqiptarët etnikë kontrollojnë rreth 80% të tregut fitimprurës të heroinës në vend. Bandat e mafies shqiptare besohet se ndodhen kryesisht pas trafikut të seksit në Mbretërinë e Bashkuar dhe janë po ashtu duke konkurruar bandat turke për tregun e heroinës.

Trafikimi i heroinës është droga që sjell njëkohësisht përfitimet më të mëdha dhe dëmin më të madh. Për këtë arsye, trafikantët shqiptarë të heroinës janë famëkeqët më të veçantë të fenomenit të krimit të organizuar ballkanik. Për shembull, një dekadë më parë Këshilli i Europës nënvijëzonte në raportin e tij të situatës së krimit të organizuar: “Ndërsa në vitet e mëparshme tregtia [e heroinës në Austri] dominohej nga organizatat turke, në vitin 1998 vërehej se atë tashmë e kishin marrë përsipër grupet etnike shqiptare... Organizatat kriminale të shqiptarëve etnikë kanë arritur të ndërtojnë një rrjet të shtrirë nëpër gjithë Europën dhe të mbajnë monopole në zonat urbane. Ata mbajnë baza operacionale në Austri, Bullgari, Republikën Çeke, Gjermani, Hungari, Poloni, Rumani, Sllovakia, Zvicër, Mbretërinë e Bashkuar si dhe në vendet nordike. Edhe në raportin e tij të situatës së vitit 2005, Këshilli i Europës theksonte: “Grupet kriminale të shqiptarëve etnikë janë sipas burimeve të pakonfirmuara përgjegjës për një pjesë të madhe të shkallës së përgjithshme të shpërndarjes së heroinës në Europë... Grupet kriminale të shqiptarëve etnikë përbëjnë një kërcënim të rëndësishëm për BE-në, për shkak të përfshirjes së tyre në trafikun e lëndëve narkotike, trafikimin e qenieve njerëzore dhe pastrimit të parave”. “Grupet kriminale të shqiptarëve etnikë” janë i vetmi grup kombëtar i diskutuar në publikimin e Europolit të vitit 2006, **Kërcënimi nga krimi i organizuar**: “Grupet e krimit të organizuar të shqiptarëve etnikë janë vendosur në shumë prej shteteve anëtare të Bashkimit Europian dhe përtej... grupet kriminale të shqiptarëve etnikë janë formuar për të zgjeruar rolin e tyre, nga transportues deri në marrjen e kontrollit të plotë të disa zonave të caktuara të krimit”.

Në ditët e sotme ekzistenca e furnizimit të rregullt nga Afganistani si dhe kontrolli nga “Mafia shqiptare” i linjës ballkanike, e ka lehtësuar atë për të siguruar një bazë të madhe kapitali, e cila pastrohet kryesisht nëpërmjet qendrës së ndërtimeve në Shqipëri si dhe përdorimit të qendrave financiare të dyshimta. *Aktualisht, sipërmarrja më e madhe në kuptimin e shitjeve dhe përfitimeve në Europën Juglindore, është krimi i organizuar shqiptar.* Një inspektor i policisë belge zbuloi në fillim të këtij viti, se ata janë tashmë dëshmitarë të pastrimit masiv të parave që shqiptarët po bëjnë përmes kimit të organizuar në Europën Perëndimore. Policia belge ka zbuluar se mafia shqiptare shpesh i dërgon paratë e saj nga emigrantë të tjerë në Shqipëri dhe në provincën serbe të Kosovës dhe Metohi, për “t’u investuar” në ndërtimin e shtëpive dhe pompat e gazit. Zgjerimi i sistemit bankar grek në Europën Juglindore do të adresojë sigurisht në të ardhmen e afërt çështjen e transferimit të aktiviteteve kriminale përmes këtyre institucioneve financiare.

Megjithëse fjalët në këtë rast janë bërë një shprehje standarde si në analizat e kimit të organizuar kombëtar ashtu edhe ato ndërkombëtare, roli i saktë i rrjeteve shqiptare dhe i grupeve të tjera nga Europa Juglindore në Europën Perëndimore, shpërndarja e heroinës duket të ketë ndryshuar thelbësisht me kalimin e kohës dhe ndërmjet rajoneve. Dhe megjithëse është vështirë për t’u vlerësuar, duket se, në përgjithësi, roli i grupeve të trafikimit të heroinës nga Europa Juglindore drejt Europës Perëndimore ka pësuar rënie vitet e fundit.

## Vendet e BE-së dhe Ballkani, rasti i Bullgarisë

Në një tjetër vend ballkanik - në Bullgari - aktivitetet e kimit të organizuar kanë shkaktuar tension të madh në jetën shoqërore dhe politike të vendit. Me hyrjen e shpejtë të Bullgarisë në BE, më 1.1.2007, shteti është duke u përballur me presion european me qëllim për të frenuar përhapjen e aktiviteteve të paligjshme të formës së organizuar. Midis viteve 2003 dhe 2005 janë regjistruar 50 vrasje të krerëve të botës së



krimit në Bullgari, një nga “Luftërat e Mafies” më famëkeqe në historinë europiane, me përjashtim të Italisë së Jugut. Megjithëse Samiti i Bashkimit European në Selanik krijoi bazat konkrete të cilat përcaktonin se e ardhmja e të gjithë vendeve ballkanike është brenda familjes, së cilës këto vende i përkasin gjeografikisht dhe në mënyrë të ndërgjegjshme, hyrja e Rumanisë dhe e Bullgarisë në 2007-n solli në jetë probleme, të cilat BE-ja teorikisht i kishte parashikuar, por me të cilat asnjëherë nuk ishte përballur realisht në të gjithë historinë e tij. BE-ja, entuziaste për të përmirësuar jetët e 7.5 milionë bullgarëve, ofroi në ndihma me 11 bilionë euro, ose pothuajse 15 bilionë euro. Duke qenë shumë larg ndalimit të krimit dhe dhunës, paratë realisht përhapën korrupsionin. Shumë nga reformatorët antikorrupsion të Sofjes thanë: “Kur tipat e këqij të biznesit të Bullgarisë kuptuan sa shumë para ishin në lojë, ato kaluan direkt në politikë duke blerë politikanët.” Në prill 2008, ministri i Brendshëm Rumen Petkov dha dorëheqjen, pas dy vrasjeve të profilit të lartë, që u kryen në Sofie dhe pas një skandali të vazhdueshëm që ka të bëjë me një hetim të lidhjeve midis Ministrisë së Brendshme dhe figurave të krimit të organizuar, me disa prej të cilët ish-ministri pranoi që kishte pasur kontakt personal dhe si pasojë, verën që shkoi, zyrtarët europianë ngrinë pothuaj 500 milionë • në financime dhe mund të pengojnë rrjedhjen e bilionëve të tjerë, të alarmuar nga kriminelët që qarkullojnë të lirë dhe praktikojnë të ashtuquajturin krim të “kollares” së bardhë dhe mbajnë lidhje edhe me nivelet më të larta të pushtetit. Bullgaria është duke rrezikuar shkurtimin e fondeve të BE-së pikërisht për shkak të problemeve të mëdha me korrupsionin. Korrupsioni, duke u përhapur në të gjithë nivelet e jetës publike, është duke u identifikuar gjithnjë e më tepër si një kërcënim jo vetëm për ekonominë, por gjithashtu për sigurinë kombëtare. Sipas Indeksit Botëror të Korrupsionit Global 2008 të Transparency International, nga 180 vende, vendet ballkanike listohen si më poshtë: Sllovenia në vendin 26, Turqia renditet në vendin 58, Kroacia 62, Rumania 70, Bullgaria dhe Maqedonia në vendin 72, Serbia, Shqipëria dhe Mali i Zi në vendin 85, Bosnje dhe Hercegovina 92. Krahasuar me të njëjtin studim, të gjitha

vendet e listuara më lart duket se kanë bërë përmirësim gradual në luftën kundër korrupsionit (me pozicionin e dukshëm të Sllovenisë, e cila renditet më lart se shumë vende të tjera perëndimore si Spanja që renditet në vendin 29, Italia 55 dhe Greqia 57). I vetmi paradoks i Indeksit Botëror të Korrupsionit 2008 është pozicionimi i vendit të ri të BE-së, Bullgarisë. Që prej hyrjes në BE, më 1.1.2007, arritja e Bullgarisë është kthyer mbrapsht. Në Indeksin e 2007-s për shembull, Bullgaria renditej e 64-ta me një rezultat CPI në 4,1 (Corruption Perception Index - Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit - CPI, lidhet me perceptimin e shkallës së korrupsionit ashtu siç ajo shihet nga analistët e vendit dhe njerëzit e biznesit, dhe varion midis 10 (shumë e pastër) dhe 0 (shumë e korruptuar) ndërkohë që në vitin 2008 rezultati i CPI ishte 3.6.

Tre sektorët kryesorë të aktiviteteve të krimit të organizuar - trafiku i drogës, qenieve njerëzore dhe armëve - janë të ndërlidhura dhe të ngulitura që të tria thellësisht në kulturën e përhapur të korrupsionit në rajon. Ata bashkëpunojnë në nivel ndërkombëtar dhe rajonal me më shumë efikasitet se qeveritë dhe organizatat ndërkombëtare që po përpiqen t'i shtypin ato. Dhe megjithëse tashmë krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor është evidentuar gjerësisht si kërcënimi kryesor kundrejt stabilitetit në rajon dhe në Europë, nuk ka një strategji gjithëpërfshirëse për të adresuar problemin, as lokalisht as në BE.

Nga ky këndvështrim Bashkimi Europian ka përkrahur vazhdimisht luftën kundër krimit të organizuar, ndonëse me pak efekt. Veprimet e tij janë më tepër në nivel retorik dhe BE dështon të kuptojë ndërveprimin e krimit të organizuar me jetën e brendshme politike dhe shoqërinë. Për më tepër ekzistenca e qelizave terroriste në Ballkanin Jugor është e lidhur gjithashtu me krimin e organizuar, meqenëse përfitimet e ndihmës së mëvonshme ndihmojnë mbështetjen e mëparshme. Nuk ka asnjë dyshim që krimi i organizuar i lidhur me korrupsionin publik është një çështje shumë e rëndësishme në Europën Juglindore. Tregu i heroinës në vetvete vlen bilionë euro dhe pamja mbizotëruese është që shumica e këtij trafiku kalon përmes Ballkanit. Megjithëse

shkalla e trafikut të qenieve njerëzore, vuajtja që shkakton është e thellë, ashtu siç është rreziku i paraqitur nga kontrabanda e armëve. Kërcënimet e reja që shqetësojnë komunitetin ndërkombëtar janë prirjet e kalimit të trafikut përmes rajonit të Detit të Zi. Portet e Kostanës, Varnës, Odesës dhe Stambollit po bëhen rruga më e sigurt dhe më e shpejtë për trafikantët që bëjnë marrëveshje me Europën Perëndimore. Droga, kryesisht heroina, janë sjellë në vend përmes anijeve tregtare në portet e Detit të Zi, përpara se pjesa më e madhe të lëvizen përmes Serbisë, Hungarisë, ose Greqisë drejt Europës Perëndimore.

Megjithatë, një rishqyrtim sektor më sektor i tregjeve të krimit të organizuar të Europës Juglindore, jep arsye të fortë për të besuar se situata po ndryshon për mirë. Megjithëse shumica e këtyre përpjekjeve janë të nxitura nga jashtë dhe jo nga ndërgjegjësimi i qeverive lokale për koston sociale dhe ekonomike të shkaktuar nga aktivitetet e kriminelëve të organizuar. Një përmirësim domethënës në ekonominë dhe qeverisjen, angazhimet politike nga brenda dhe jashtë rajonit, dhe asistencën multilaterale, duhet bërë në mënyrë që të ndihmohet zgjidhja e problemit në rajon. Në ditët e sotme grupet kriminale janë më tepër të ndryshme, krijojnë forma sistematike të bashkëveprimit, depërtojnë në bizneset legjitime, duke përdorur sistemin global bankar për të çuar përpara përpjekjet e tyre dhe duke e bërë shumë të vështirë për çfarëdolloj qeverie për të zhvilluar një përgjigje të përshtatshme pa marrë ndihmë nga vende të tjera. Pakti i Stabilitetit është përpjekja e parë serioze e komunitetit ndërkombëtar, për të zëvendësuar politikën e mëparshme të ndërhyrjes reaktive në Europën Juglindore, me një strategji gjithëpërfshirëse, afatgjate të parandalimit të konfliktit. Më 10 qershor 1999 u adoptua në Cologne, me iniciativën e BE-së, Pakti i Stabilitetit. Në dokumentin themeltar, më shumë se 40 vende partnere dhe organizata morën përsipër të forconin vendet e Europës Juglindore “në përpjekjet e tyre për vendosjen e paqes, demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut dhe prosperitetin ekonomik, në mënyrë që të arrihet stabilitet në të tërë rajonin”. Integrimi euroatlantik iu premtua të gjitha vendeve të rajonit. Pakti i Stabilitetit është i bazuar në

eksperiencat dhe mësimet botërore të nxjerra nga menaxhimi i krizave ndërkombëtare. Parandalimi i konfliktit dhe ndërtimi i paqes mund të jenë të suksesshëm vetëm nëse ato fillojnë paralel në 3 sektorë kyçë: krijimin e një mjedisi të sigurtë, promovimin e sistemeve të qëndrueshme demokratike, si dhe promovimin e mirëqenies ekonomike dhe sociale. Progresi në të tre sektorët është i nevojshëm për paqe dhe stabilitet të qëndrueshëm.

### **Sipas Këshillit të Europës dhe Komisionit European:**

Perceptimi i pranuar përgjithësisht është se krimet e organizuara dhe ekonomike në Europën Juglindore kërcënojnë demokracinë, shtetin ligjor, të drejtat e njeriut, stabilitetin dhe progresin social e ekonomik në rajon. Me gjithë këto shqetësime, investimet në Europën Juglindore vazhdojnë të jenë të fuqishme. Ndërkohë që FDI (Foreign Direct Investment - Investimi i Huaj i Drejtpërdrejtë) neto pësoi një rënie të shpejtë në 25 vendet e BE-së midis viteve 2000 dhe 2004, e kundërta ndodhte në shumicën e vendeve të Europës Juglindore, duke sugjeruar që këto vende janë duke u bërë aktualisht më tërheqëse për investitorët e huaj. Duke marrë të mirëqenë që shumica e procesit të privatizimit ka përfunduar, këto para ka shumë mundësi të përfaqësojnë tendencën e investitorëve për të hapur biznese nga e para në një rajon që eventualisht do të bëhet pjesë e BE-së. Perspektiva në një term afatgjatë duket të mbizotërojë shqetësimin në lidhje me krimin dhe korrupsionin.

## **Zgjidhja**

**Anëtarësimi në Bashkimin European:** Në teori, problemet e nacionalizmit dhe korrupsionit duhet të ndihmohen prej perspektivës së anëtarësimit në BE, si dhe procesi i reformave në rrugën drejt hyrjes në të. Sllovenia dhe Hungaria u bënë pjesë e BE-së në maj të 2004-s, dhe Bullgaria dhe Rumania vijuan në 2007-n, ndërkohë që të gjitha vendet e tjera në Ballkan (duke përjashtuar Greqinë, anëtare prej vitit

1981) janë në periudha të ndryshme të dialogut të tyre me Bashkimin Europian. Si rrjedhojë, BE-ja shihet nga shumë si një perandori dashamirëse, e cila mund të kthejë Ballkanin në një gjendje të bashkekzistencës produktive, ose e thënë ndryshe, të *deballkanizojë* rajonin. Ky vështrim optimist është përforcuar në disa vende me një sens që, vetëm duke e dorëzuar sovranitetin tek institucionet në Bruksel, shtetet në Ballkan mund të shpresojnë të shpëtojnë prej korrupsionit dhe varfërisë, për të cilat shumica fajëson liderët vendas. Bosnje-Hercegovina, Shqipëria, Serbia dhe Mali i Zi, të tëra vuajnë probleme të theksuara politike, ekonomike e sociale, të cilat e bëjnë BE-në, më tepër të prirur, për të dëshiruar që këto vende të mbesin jashtë bllokut, të paktën për tani. Ekziston një pohim i përgjithshëm se procesi i anëtarësimit në BE është një mjet i fuqishëm për të promovuar ndryshimin strukturor dhe një Marrëveshje e Stabilizim-Asocimit u nënshkrua me Shqipërinë më 12.6.2006, Malin e Zi më 15.10.2007 dhe me Serbinë më 29.4.2008; (megjithatë, u nënshkrua menjëherë pas bashkëpunimit me ICTY (International Criminal Tribunal for the former Yugoslavia - Gjykata Ndërkombëtare e Krimin për ish-Jugosllavinë) dhe dorëzimit të kriminelit të luftës Radovan Karadžić më 18 korrik 2008). Kosova, shteti më i ri në botë, përballet me një punë të gjatë e të vështirë për të fituar njohjen e përhapur duke lënë mënjanë integrimin, megjithëse rruga e saj përballet në mënyrë të determinuar me Perëndimin.

Z. Antonio Maria Costa, Drejtor Ekzekutiv i Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Drogën dhe Krimin, ka thënë: ***“Shoqëritë e hapura, tregjet e hapura dhe kufijtë e hapur janë mënyra më e mirë për të luftuar krimin në Ballkan”.***

Perspektiva e anëtarësimit në BE është gjithashtu faktori unik kryesor bashkues në Ballkan dhe përfaqëson një sistem të fuqishëm për reformat aq shumë të nevojshme. Por BE-ja duhet të drejtojë rrugën dhe të përcaktojë me saktësi synimet dhe metodat e saj. Me fjalë të tjera, BE-ja dhe aleatët e saj duhet të nisin një ofensivë kundër krimin të organizuar në Ballkan. Kriteret politike të Kopenhagenit: Demokracia, Shtet Ligjor, Të Drejtat e Njeriut dhe Respektimi i Minoriteteve,

nuk janë të mjaftueshme dhe kjo ofensivë duhet të adresojë tre fronte njëkohësisht:

- 1) Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të inkurajohen shumë, madje dhe të stimulohen, për të ndërmarrë reformat tërësore të sektorëve të tyre të sigurisë në mënyrë që t'i bëjnë ato më efikase, të përgjegjshme dhe të pakorruptuara dhe kjo duhet të vendoset në prioritetet e larta të axhendës së bisedimeve të bashkëpunimit. Njësitë e specializuara të zbatimit të ligjit, departamentet dhe agjencitë për luftimin e krimit të organizuar duhet të pajisen me burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale në mënyrë që t'i mundësojë atyre të përmbushin në mënyrë optimale dhe të veçuar nga ndërhyrjet politike.
- 2) Reformat e sigurisë duhet të kalojnë paralelisht me reformat e sistemit gjyqësor në rajon, të cilat gjithashtu duhet të jenë efikase, të pavarura dhe të harmonizuara rajonalisht aq mirë sa edhe ligjet dhe parimet e BE-së.
- 3) Trupat ekzistuese rajonale për luftimin e krimit të organizuar duhet të rishikohen dhe të ringarkohen.  
Ato që janë premtuese, si SECI (South East Europe Cooperation Initiative - Iniciativa e Bashkëpunimit të Europës Juglindore), formuar si një ndërmarrje e Paktit të Stabilitetit për Europën Juglindore, duhet t'u jepen fuqi dhe burime të mëtjshme, dhe të tjerët duhet të përfundohen; një mundësi e krijimit të ndër-agjencive të reja duhet të konsiderohet seriozisht.

Në të tre këto fronte, duhet të pritët rezistencë e fortë. Politikanët nacionalistë do të protestojnë kundër ndërhyrjeve të huaja në çështjet e brendshme të vendit të tyre; zyrtarët dhe burokratët e korruptuar do t'u rezistojnë reformave, dhe ata do të bashkohen me ata të cilët janë thjesht të paaftë, por të etur për të mbajtur pozitat e tyre. Sidoqoftë, në këtë luftë, luftëtarët kundër krimit të organizuar mund të mbështeten në një aleat të fuqishëm: *Njerëzit e Ballkanit janë të lodhur dhe të*

*mërzitur nga të qenit të shfrytëzuar nga kriminelë me lidhje të forta dhe ata urrejnë perspektivën se fëmijët e tyre mund të bëhen përdorues drogash ose mund të detyrohen të prostituohen. Kjo është ajo çka e bën të vërtetë perspektivën e fitores.*

## Bibliografi

- Zyra e Shteteve të Bashkuara për Drogat dhe Krimin (UNODC) “Krimi i organizuar në Ballkan”, mars 2008.
- Wikipedia, “Mafia shqiptare”
- David Binder, Korrespondenti i MSNBC dhe ish-korrespondenti i “New York Times” dhe Dr. John F. Markey, drejtor i Programeve të Asistencës së Zbatimit të Ligjit dhe koordinator i SECI në Departamentin e Shtetit të Shteteve të Bashkuara. “Duke luftuar krimin e organizuar në Ballkan”, për janarin 2003.
- Byroja Federale e Investigimit (FBI) “Rreth krimin të organizuar”
- Byroja Federale e Investigimit (FBI) “ Krimi i organizuar në Ballkan”
- Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare “Duke luftuar rrezikun në rritje të krimin të organizuar ndërkombëtar”, 23 prill 2008
- Lajmet e trafikut të drogës, 20 prill 2008
- Kontrolli i rrezikut të krimin të organizuar në BE, 2008 (OCTA)
- Raporti vjetor i Europol-it, 2007
- HUMSEC, prezantim nga Dejan Anastasijevic “Krimi i organizuar në Ballkanin Perëndimor”, nëntor 2006
- Transparency International, Indeksi i Korrupsionit Global, 2007, 2008
- Jane’s Sentine, “Kontrolli i riskut të vendit për Shqipërinë, Maqedoni, Mal i Zi, Serbi, Rumani, Bullgari, Kroaci”.
- Pakti i Stabilitetit për Europën Juglindore, Qendra SECI
- David L. Carter PhD, Fakulteti i Drejtësisë Kriminale, Universiteti i Michigan, “Krimi i organizuar ndërkombëtar”, shtator 1994
- Michael Ioannis, “Një pikëpamje mbi krimin e organizuar në Ballkanin Jugor”, Europa Juglindore pranë Fondacionit World Security, janar 2007
- International Herald Tribune, “Korrupsioni bullgar - shqetësim për Bashkimin Europian”, 15 tetor 2008

EDUART BALA

## REFORMIMI DHE KONTROLLI I SHËRBIMEVE TË INTELIGJENCËS NË DEMOKRACITË E REJA

Studimet për kontrollin e shërbimeve të inteligjencës përfshihen në fushën e studimeve të kontrollit civil mbi Forcat e Armatosura (FA). Kjo fushë (kontrolli i shërbimeve të inteligjencës) është ndoshta dhe më problematikja e veçanërisht për demokracitë e reja. Problemet që e shoqërojnë këtë, lidhen jo vetëm me trashëgiminë nga regjimet e mëparshme jo demokratike, ku inteligjenca ose aparati i sigurisë ishte një element kyç i kontrollit politik e për rrjedhojë abuzimi me të drejtat e njeriut shpesh ishte i lejuar, por në thelb është gjithashtu edhe një tension përditësor midis inteligjencës dhe shoqërisë demokratike në tërësi. Për rrjedhojë, që një shoqëri të jetë demokratike krahas të tjerave është e domosdoshme transparenca dhe dhënia e llogarisë e qeveritarëve tek ata që qeverisen prej tyre. Në kundërshtim me sa u përmend më sipër, detyrat e shërbimeve të inteligjencës për të qenë sa më efektive duhet të kryen në fshehtësi, pra, në kontrast me rregullat e dhënies llogari e të transparencës. Ndërsa në demokracitë e konsoliduara janë ngritur dhe veprojnë në mënyrë permanente institucione që merren me zgjidhjen e kësaj dileme (të kontrollit mbi shërbimet e inteligjencës), në demokracitë e reja, që janë akoma në procesin e shpërbërjes të institucioneve të ngelura nga sistemi i shkuar dhe të krijimit të atyre të reja, ka mungesa dhe probleme.

Dy janë arsytet që kontrolli demokratik i shërbimeve të inteligjencës i përket fushës së studimeve të marrëdhënieve civilo-ushtarake. Arsyeja e parë është se në shumicën e regjimeve autokratike, duke futur këtu edhe ato të regjimeve të ish-blokut komunist, shërbimet e inteligjencës ishin të



militarizuara, një formë që këto regjime kishin përcaktuar dhe ndërtuar vetveten; dhe së dyti edhe në ato shtete ku ishin krijuar shërbime të inteligjencës civile, FA kishin shërbimet e tyre të veçanta të inteligjencës.<sup>1</sup>

Çdo diskutim për kontrollin e inteligjencës është një problem e njëkohësisht një sfidë dhe kjo për disa arsye. Së pari, termat dhe konceptet mbi inteligjencën janë me shumë kuptime dhe shpesh të diskutueshme. Së dyti, në përgjithësi veprimtaria e shërbimit të inteligjencës, pra procesi i grumbullimit, analizës dhe shpërndarjes së informacionit është i fshehtë; zotërimi i njohurive mbi ambientin ku jetojmë ka fuqinë e pushtetit, pra kush zotëron informacionin e mban atë për vete. Për analogji informacioni i mbledhur nga këto shërbime është pushtet, gjë që rezulton se ata, të cilët e zotërojnë, dëshirojnë ta ruajnë dhe përdorin vetëm për interesa të tyre. Punonjësit profesionistë të shërbimeve të inteligjencës janë anëtarë të një komuniteti të veçantë, i identifikuar si brenda FA-së ashtu dhe në administratën civile. Kështu që specialistët e shërbimeve të inteligjencës i fshehin ose i ruajnë me qëllim, si njohuritë për shërbimin që ata bëjnë pjesë po ashtu edhe për procesin, aktivitetin dhe informacionin e prodhuar prej tyre nga nëpunësit e tjerë të shtetit që nuk bëjnë pjesë në këtë komunitet. Së treti, pak është shkruar rreth shërbimeve të inteligjencës dhe marrëdhënieve të tyre me procesin e demokratizimit të shoqërisë. Shumica e këtyre studimeve është prodhuar në shoqëritë e stabilizuara demokratike si në SHBA, Kanada, UK ose Francë. Për këtë arsye, në këtë studim do përqendrohemi te strukturat, funksionet dhe veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës; do të analizojmë sfidat e kontrollit demokratik ndaj këtyre shërbimeve në kuadër të marrëdhënieve civilo-ushtarake, kryesisht për demokracitë e reja, duke nënvizuar edhe rëndësinë e inteligjencës si profesion.

Si do të shihet në këtë material vetëm një numër i veçantë shtetesh kanë ndërmarrë një reformë të sistemit të tyre të

---

<sup>1</sup> Alfred Stepan, "The Brazilian Intelligence System in Comparative Perspective", Ch. 2, in *Rethinking Military Politics: Brazil and the Southern Cone* (Princeton, NJ: Princeton University Press, 1988), fq.12-29.

inteligjencës dhe duke bërë këtë, ato kanë përfshirë dhe gjeneruar debatin publik për funksionet dhe përgjegjësitë e këtyre shërbimeve në kuadër të një shteti demokratik. Ndërsa për këtë fushë në vendin tonë nuk ka shumë literaturë e studime dhe për rrjedhojë materiali do të ketë vlera, si për dhënien e njohurive mbi këto shërbime ashtu dhe thyerjen e mitit të fshehtësisë së tyre. Për më tepër, ky studim grupon së bashku tre probleme, të cilat zakonisht analizohen të veçanta: procesi i demokratizimit, marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe studimet për shërbimet e inteligjencës.

Shumica e specialistëve, që merren me kërkime ose shkruajnë për demokracinë, nuk janë të ndërgjegjësuar e të gatshëm që të merren me implikimin e shërbimeve të inteligjencës në procesin e konsolidimit të shoqërisë demokratike. Po ashtu, studiuesit e marrëdhënieve civilo-ushtarake fokusohen më tepër te subjektet e kësaj shkence se sa në inteligjencën si profesion. Por edhe ata që janë specialistë në fushën e inteligjencës nuk janë marrë me studime në fushën ushtarake ose në format e procesit të demokratizimit ose së paku nuk janë marrë me rolin e veprimtarisë së inteligjencës në procesin e konsolidimit të shoqërisë demokratike.

## I. Ç' duhet të kuptojmë me inteligjencë?

Shërbimet e inteligjencës kryejnë një rol shumë të rëndësishëm në një shoqëri demokratike, por më kryesorja është informimi i qeverisë për çfarë ajo ka nevojë që të dijë për kërcënimet e jashtme ose atyre të brendshme ndaj sigurisë kombëtare.<sup>2</sup> Qëllimi dhe llojshmëria e veprimtarisë së shërbimeve të inteligjencës krijon një mospërputhje me termin “inteligjencë”. Si thekson Mark Lowenthal, “ky term ka së paku tre kuptime. Së pari, “inteligjencë” mund ta përkufizojmë si një proces që prej të cilit çdo qeveri kërkon, mbledh, analizon

---

<sup>2</sup> Theodor H. Winkler and Leif Mevik, “Foreword,” in *Who's Watching the Spies?*, ed. Hans Born, Loch K. Johnson and Jan Leigh (Washington D.C.: Potomac Books, 2005), fq. 9.

dhe shpërndan një lloj informacioni të kërkuar, duke përfshirë këtu edhe operacionet e fshehta që janë planifikuar dhe kryen. Së dyti, me “inteligjencë” mund të kuptojmë produktin e procesit të grumbullimit, analizimit si dhe atë të operacioneve të fshehta. Dhe së fundi me “inteligjencë” mund t’i referohemi organizatës, domethënë, atyre agjencive të cilat kryejnë këtë funksion”. Pra **procesi, mbledhja dhe përdorimi i informacionit** për disa qëllime është elementi më i spikatur në të tre përcaktimet e mësipërme që përbëjnë qëllimin e diskutimit tonë.

Shumica e diskutimeve në komunitetin e inteligjencës përqendrohet në profesionin (tradecraftin), domethënë “si ta bëjmë”, pra në burimet, metodat dhe analizën e informacionit, se sa me atë se “çfarë është” inteligjenca. Kështu, ana e padukshme apo karakteri i veçantë i saj është realizuar qëllimisht, pra, për të ruajtur informacionin që nga embrioni deri te personat që nuk u takon të njihen me të. Punonjësit e shërbimit të inteligjencës janë të kualifikuar që të mbledhin informacion dhe ta ruajnë atë duke përjashtuar nga ky rregull vetëm pak drejtues sipas parimit “nevoja për t’u njohur” (need to know). Duke qenë se ky material do të përpriqet që të trajtojë funksionimin e shërbimeve të inteligjencës në demokracitë e reja, ne duhet të pranojmë një kuptim më përgjithësues për inteligjencën me synim që të përçojmë qëllimin për të cilin po e shkruajmë këtë material.

Studiuesi Glen P. Hastedt, në librin e tij “Kontrolli i inteligjencës”, përcakton saktësisht dhe me pak fjalë: “Katër elementët e inteligjencës janë: mbledhja klandestine e informacionit, analiza dhe vlerësimi i tij, operacionet e fshehta si dhe kundërinteligenca”.<sup>3</sup> Tjetër studiues, Loch K. Johnson përshkruan marrëdhëniet reciproke ndërmjet këtyre katër funksioneve: “Inteligjenca në përgjithësi ka dy kuptime të përgjithshme. I pari, agjencitë sekrete që grumbullojnë dhe interpretojnë informacionin rreth kërcënimeve dhe problemeve që përballet kombi, në një përpjekje jo të plotë

---

<sup>3</sup> Glenn P. Hastedt, “Controlling Intelligence: Defining the Problem” in *Controlling Intelligence*, ed. Glenn P. Hastedt (Cass Series-Studies in Intelligence. London: F.Cass, 1991), fq. 6-8.

për të zvogëluar boshllëqet dhe informacion me dy kuptime që merren nga burimet e hapura rreth botës. Një komb e kërkon veçanërisht informacionin e fshehtë me qëllim që ta ndihmojë atë të triumfojë në kohë lufte me sa më pak dëme që të jetë e mundur. E dyta, bazuar në informacionet e mangëta të burimeve të hapura, politikëbërësit u kërkojnë agjencive të tyre të inteligjencës të ruajnë kombin nga dëmet (kundërinteligenca si proces), ndërsa përpiqen të realizojnë interesat e tyre kombëtare nëpërmjet manipulimit të fshehtë të ngjarjeve dhe personaliteteve të huaja (operacionet e fshehta). Inteligenca i përfshin të dyja, si informacionin ashtu edhe përgjigjen”.<sup>4</sup>

Në studimin tonë me inteligjencë do të kuptojmë katër funksionet e përshkruara nga Hastedt: grumbullimi i informacionit, analiza, kundërinteligenca dhe operacionet e fshehta. Megjithëse me termin inteligjencë ne i referohemi të dy koncepteve, si organizatës që grumbullon informacion ashtu edhe informacionit të mbledhur. Por informacioni në vetvete nuk është karakteristika dalluese dhe përcaktuese e inteligjencës. Karakteristikat themelore të funksioneve të inteligjencës janë: a- që mbledhet për qëllim shtetëror dhe b- që është sekret. Ne do të shqyrtojmë shkurt secilin prej tyre, por është e rëndësishme që të kemi parasysh se ato operojnë në mënyrë shumë efektive si pjesë e një procesi bashkëveprues dhe në lidhje të ngushta me njëra-tjetrën. Roy Godson në parathënien e librit të tij “Inteligenca dhe Politika” përmend në mënyrë të përmbledhur se: “Është e vështirë të imagjinosh një sistem efektiv grumbullimi të inteligjencës pa një analizë që prodhon një udhërrëfyes efektiv ose “dhënie detyrash” për grumbulluesit. Kundërinteligenca është e nevojshme për të ruajtur mbledhësit e inteligjencës nga zbulimi, neutralizimi dhe shfrytëzimi nga shërbimet e inteligjencës armike. Në mënyrë të ngjashme, një program i suksesshëm i operacioneve të fshehta duhet të jetë bazuar në një mbledhje, analizë dhe kundërinteligjencë efektive. Natyra e inteligjencës është e tillë

---

<sup>4</sup> Loch K. Johnson, *Secret Agencies: U.S. Intelligence in a Hostile World* (New Haven, CT: Yale University Press, 1996), fq. 119.

që disa elementë të saj të jenë pjesë e një sistemi të unifikuar, ku sukcesi varet në punën efektive të të gjitha pjesëve. Shkurt, ai duhet të jetë një “shërbim i plotë i sistemit të inteligjencës”.<sup>5</sup>

### **a-Grumbullimi**

Një nga detyrat e shërbimeve të inteligjencës është mbledhja e informacionit. Pyetjet dhe kundërshtitë që shpesh rrethojnë këtë aktivitet kanë të bëjnë me llojin e informacionit që shërbimet mbledhin dhe mjetet që përdoren për mbledhjen e tij. Në kuptimin më të ngushtë ato (shërbimet) përdorin informacionin e atyre që quhet “burim i hapur” (OSINT), i cili përmbledh periodikë të ndryshëm, internetin dhe World Wide Web, seminare dhe konferenca, pra çdo lloj informacioni i vlefshëm për publikun.<sup>6</sup> Ka gjithashtu një debat të hapur për vlerën reale të burimeve të hapura në raport me burimet e klasifikuara, kjo për arsye se në ditët tona një sasi shumë e madhe informacioni për një mori të mëdha çështjesh është tashmë e vlefshme nëpërmjet mediave publike. Mbledhësit e inteligjencës për më tepër bëjnë dhe dallimin: a- e inteligjencës njerëzore (human intelligence, HUMINT) dhe tipave të ndryshme të inteligjencës shkencore dhe teknike, b- inteligjencës sinjalore (signal intelligence, SIGINT, interceptim nga komunikimi elektronik, radarët dhe telemetria),<sup>7</sup> c- inteligjencës shëmbëllyese (imagery intelligence, IMINT, që përfshin imazhet nga ajri, sateliti dhe toka),<sup>8</sup> d- inteligjencës nëpërmjet matjes dhe shenjave (measurement and signatures intelligence, MASINT),<sup>9</sup> e cila është një inteligjencë teknike e ndryshme nga inteligjencat e mbledhura nga IMINT dhe SIGINT. Pra, HUMINT është

---

<sup>5</sup> Roy F. Godson, “Intelligence and Policy: An Introduction,” in Roy F. Godson, ed., *Intelligence Requirements for the 1980s: Intelligence and Policy* (Lexington, MA: Lexington Books, 1986), fq. 2.

<sup>6</sup> Jeffrey T. Richelson, *The U.S. Intelligence Community* (Westview Press, A Member of the Perseus Book Group, 1999), fq. 273-279

<sup>7</sup> Jeffrey T. Richelson, *The U.S. Intelligence Community* (Westview Press, A Member of the Perseus Book Group, 1999), fq. 180-205

<sup>8</sup> Po aty, fq. 150-173

<sup>9</sup> Po aty, fq. 214-235

informacioni i mbledhur direkt nga njerëzit, që përfshin informacione të siguruara nga ambasadorët ose atashetë e mbrojtjes si pjesë e punës së tyre normale dhe rutinë, informacionet e mbledhura në ngjarje të ndryshme publike dhe sociale si dhe informacionet e grumbulluara në mënyrë klandestine nëpërmjet punonjësve operativë, të cilët lexojnë postën e të tjerëve dhe marrin në mënyrë sekrete dokumente. HUMINT është spiunazhi tradicional, i realizuar kryesisht prej agjentëve që operojnë në vende të ndryshme për të mbledhur informacion për shefat e tyre, të cilët e dërgojnë në shërbimet reciproke të vendit.<sup>10</sup>

### **b-Analiza**

Informacionet dhe të dhënat e papërpunuara janë jo shumë të vlefshme në qoftë se nuk analizohen. Analiza, ose procesi i analizës, përgatit dhe kërkesat informative. Vështirësia në këtë fazë qëndron, jo vetëm në nevojën e përpunimit, të analizuarit e një sasive gjigande të dhënash, por më shumë në atë të përcaktimit se çfarë konkluzioni del nga kjo sasi informacioni. Produkti i analizës është vetëm hapi i parë i inteligjencës, hapi i dytë është “shitja në treg”<sup>11</sup> e tij. Analiza me pak fjalë, nuk është thjesht një çështje teknike, por përfshin përzgjedhjen e metodave të përpunimit dhe preferencat politike të të dyja palëve, “të prodhuesit” dhe “të konsumatorit”. Shumica e literaturës që analizon veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës merret kryesisht me përcaktimin se për çfarë e duan dhe si e konsumojnë vendimmarrësit politiko-ushtarakë informacionin që shërbimet e inteligjencës kanë prodhuar për ta.

Nga pikëpamja e sigurisë kombëtare, inteligjenca në kohë dhe e saktë bëhet një mjet i fuqishëm për shumëfishimin e saj. Çdo plan strategjik është bazuar në përfundime, të cilat, veçanërisht ato që lidhen me shqetësimin që kanë vendimmarrësit për aftësitë, mundësitë dhe qëllimet e kundërshtarit potencial, duhet të jenë të bazuara në vlerësimet

<sup>10</sup> Po aty, fq. 257-286

<sup>11</sup> Me shitje të produktit do të kuptojmë shpërndarjen e informacionit tek agjencitë ose institucionet që u nevojitet dhe e kërkojnë këtë lloj informacioni.

e një inteligjence të besueshme dhe profesionale. Procesi i prodhimit të një inteligjence strategjike të besueshme dhe të saktë është proces dinamik.<sup>12</sup> Ky proces shpesh i referohet konceptit të një cikli inteligjence, që fillon kur politikëbërësit dhe anëtarët e stafit të tyre planëzues si p.sh. në SHBA, presidenti dhe Këshilli i Sigurisë Kombëtare, ose në Shqipëri, presidenti apo kryeministri, si dhe këshilltarët e sigurisë kombëtare, kërkojnë një informacion inteligjence që t'i ndihmojë ata në marrjen e një vendimi objektiv për probleme të sigurisë kombëtare. Menaxherët e inteligjencës, në shembullin tonë Central Intelligence Agency (CIA) ose Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) në nivel kombëtar, e kthejnë këtë kërkesë në një plan për grumbullimin e informacionit. Informacionet dhe të dhënat e papërpunuara, që janë mbledhur prej llojeve të ndryshme të metodave, përpunohen dhe u jepen analistëve për t'i integruar, vlerësuar dhe analizuar, duke rezultuar në një produkt përfundimtar inteligjence (raport i shkruar ose brifing me gojë). Këto informacione përfundimtare, produkte të analizës, shpërndahen te konsumatorët (në shembujt tanë, në SHBA, te presidenti ose stafi i tij në Këshillin e Sigurimit Kombëtar, në Shqipëri, te presidenti ose kryeministri dhe këshilltarët e tyre për sigurinë kombëtare). Këta konsumatorë mund t'u kërkojnë shërbimeve të inteligjencës që të thellohen më shumë në informacione që kanë prodhuar ose të prodhojnë inteligjencë të mëtejshme për ta thelluar njohjen (feedback)<sup>13</sup>.

### **c-Kundërinteligjenca**

Në thelbin e vet, qëllimi i kundërinteligjencës është të mbrojë shtetin dhe sekretet e tij nga shërbimet e zbulimit të shteteve të tjera.<sup>14</sup> Ky koncept bëhet akoma më i qartë dhe i drejtpërdrejt nga James Angelton, për një kohë të gjatë drejtuesi i kundërinteligjencës në CIA, me aksiomën e tij "Labirinthi i

---

<sup>12</sup> Jeffrey T. Richelson, *The U. S. Intelligence Community* (Westview Press, A Member of the Perseus Book Group, 1999), fq. 315-329

<sup>13</sup> Mark M. Lowenthal, "Tribal Tongues: Intelligence Consumer, Intelligence Producer" (Washington Quarterly, Winter, 1992), fq. 157-168

<sup>14</sup> Po aty, fq. 332-345

pasqyrave” (The wilderness of mirror),<sup>15</sup> ku përcakton se: “defektorët janë fals, gënjeshttrat janë të vërteta, e vërteta është e gënjeshtër dhe ky pasqyrim ju lë juve të verbuar dhe konfuzë”.<sup>16</sup> Ndërsa studiuesi Abram N. Shulsky e përcakton: “Në kuptimin e saj të përgjithshëm, kundërinteligenca i referohet informacionit të mbledhur dhe të analizuar si dhe veprimtarisë së ndërmarrë në mbrojtje të një kombi (përfshirë këtu edhe veprimtarinë e shërbimeve të inteligjencës) nga një veprimtari e një shërbimi inteligjence kundërshtar. Në këtë përcaktim, qëllimi i kundërinteligençës në vetvete, është po aq i gjerë sa dhe i vetë inteligjencës, pra është një veprimtari mbrojtëse nga të gjitha teknikat e aktivitetet e shërbimeve të inteligjencës kundërshtar”.<sup>17</sup>

Shulsi, si shumica e autorëve amerikanë që kanë shkruar për inteligjencën, veprimtarinë e kundërinteligençës e lidh kryesisht me masat e marra kundër kërcënimeve të huaja. Në përdorimin e përditshëm, termi “kundërinteligençë” përdoret edhe për ato veprimtari informative me qëllimin e kundërvënies dhe mbrojtjes nga kërcënimet e brendshme. Studiuesit britanikë preferojnë të përdorin termin “Security Intelligence” (Inteligjencë Sigurie) për të përcaktuar misionin e shërbimeve të inteligjencës që kanë për detyrë mbrojtjen nga kërcënimet e brendshme. Peter Gill e përkufizon inteligjencën në fushën e sigurisë si një “mbledhje të informacioneve nga ana e shtetit për mbrojtjen nga kërcënimet që cenojnë sigurinë e tij dhe kryesisht nga spiunazhi, sabotimi, influenza e veprimtarive të huaja, dhuna politike dhe subversioni”.<sup>18</sup>

---

<sup>15</sup> Fraza “wilderness of mirrors” është marrë nga poema “Gerontion” e T. S. Eliotit që u botua për herë të parë më 1920. Shumë komentatorë besojnë se James Jesus Angelton e kishte marrë këtë frazë nga kjo poemë kur ai kishte përshkruar konfuzionin midis spiunazhit dhe kundërinteligençës si “labirinthe i pasqyrave”.

<sup>16</sup> Peter Wright and Paul Greengras, “*Spycatcher: The Candidat Autobiography of a Senior Intelligence Officer*” (New York: Viking, 1987), fq. 305.

<sup>17</sup> Abram N. Shulsky, “*Silent Warfare: Understanding the World of Intelligence*” (Washington: Pergamon-Brassey’s International Defense Publisher, 1993), fq. 111.

<sup>18</sup> Peter Gill, *Policing Politics: Security Intelligence and the Liberal Democratic State* (New York: Fran Cass, 1994), fq. 6-7.



Si në materialet e botuara të shumë specialistëve me eksperiencë në fushën e inteligjencës por edhe në botimet e studiuesve të kësaj fushe për studentët e inteligjencës theksohet se kundërinteligenca dhe veprimtaritë e sigurisë kanë një ndikim të madh negativ për arsye të mbikëqyrjes së fshehtë ndaj qytetarëve të vendit të tyre. Këto implikime janë shumë më evidente për demokracitë dhe veçanërisht në vendet e sapohyra në këtë proces, ku si do përshkruajmë në vijim, kundërinteligenca dhe siguria ishin funksionet kryesore të shërbimeve të inteligjencës në regjimet e vjetra. Këto shërbime të kthyer në vegla dhune të regjimit kërkonin të gjenin armiq të realë dhe imagjinarë të shtetit, që kryesisht rezultonin të ishin kundërshtarët politikë të tij, dhe ushtronin represion ndaj tyre. Ky imazh shfaqet ndonjëherë edhe në demokracitë e stabilizuara ndonëse në një masë të vogël. Ndërsa në vendet e botës së tretë, të cilët janë shumë më pak institucionalë dhe demokratikë, ky qëndrim rezulton në shkeljen më ekstreme të të drejtave dhe lirive njerëzore si dhe në mosdënimin e punonjësve të këtyre shërbimeve që i kryejnë ato.

#### ***d-Operacionet e fshehta***

“Operacionet e fshehta” (Cover Operation) në SHBA, “veprimet politike speciale” (special political actions) në Britaninë e Madhe dhe “masat aktive” (active measures) në ish-Bashkimin Sovjetik, janë veprimtari që kanë për qëllim të ndikojnë te shtetet e tjera me mjete dhe mënyra që nuk identifikojnë shtetin që qëndron prapa këtij veprimi.

Operacioni i fshehtë si veprimtari nuk është në vetvete pjesë e procesit të inteligjencës. Inteligenca, e konsideruar si një produkt, mbështet operacionet operative të shërbimeve, si ato që janë të hapura apo të fshehta. Që operacioni i fshehtë të quhet ose identifikohet si funksion i shërbimeve të inteligjencës është një zgjedhje strukturore e çdo shteti. Qeveri të ndryshme përzgjedhin shërbimin që do ta kryejë këtë funksion (operacionet e fshehta). Disa shtete preferojnë që ky funksion të jetë pjesë e përgjegjësive të FA-së, d.m.th. “përgjegjësi ushtarake” (military responsibility), ndërsa të tjera si ajo e SHBA-së e ka vendosur atë në shërbimin e inteligjencës

civile, CIA-s. Se ku qeveritë përcaktojnë të jetë i vendosur ky funksion ka mundësi të ketë edhe një efekt të thellë dhe të gjatë të dorës së dytë, për vetë shërbimet e inteligjencës. P.sh. duke e vendosur me ligj<sup>19</sup> funksionin e operacioneve të fshehta të CIA, qeveria e SHBA-së modeloi kulturën dominuese të inteligjencës në CIA për më shumë se një brez. Veç kësaj, duke e vendosur funksionin e operacioneve të fshehta në të njëjtën agjenci, që është përgjegjëse për analizën e inteligjencës kombëtare, qeveria e SHBA-së krijoi një konflikt të brendshëm interesash brenda kësaj agjencie e cila mbizotëron edhe sot e kësaj dite.

Operacionet e fshehta ndahen në disa kategori duke filluar nga agjitacioni dhe propaganda e deri te veprimet paramilitare. Mark Lowenthal i kategorizon ato në bazë të marrëdhënies me nivelin e dhunës dhe “shkallës së mundësisë për të mohuar” (degree of plausible deniability). Historia e termit lidhet me investigimin që ndërmori komiteti i senatit të SHBA-së, Church Committee,<sup>20</sup> më 1975-1976, ndaj agjencive të inteligjencës. Në rrjedhën e investigimeve, u zbulua se CIA që nga koha e administratës së presidentit Kenedi, kishte komplotuar për të vrarë një numër udhëheqësish të vendeve të tjera, duke përfshirë edhe Fidel Kastron, presidentin e Kubës. Por, vetë presidenti (i SHBA-së), i cili qartësisht ishte në favor të këtyre veprimeve, nuk ishte i përfshirë direkt në to, kështu që ai mundet të mohonte që kishte njohurinë për to. Kjo mënyrë e të mohuarit nga presidenti krijoi konceptin politik “mundësi për të mohuar”.

Niveli i parë i operacioneve sekrete është propaganda, që përfshin përdorimin e mediave të një shteti për të përcuar një mesazh propagandistik të caktuar kundrejt një vendi tjetër. Ky operacion karakterizohet si operacioni me nivelin më të ulët të dhunës dhe me mundësinë më të madhe për ta mohuar. Niveli i dytë është veprimtaria politike, e cila përfshin

<sup>19</sup> Ligji “Për Sigurinë kombëtare” i vitit 1947 (shënimi i autorit - E. B.).

<sup>20</sup> Church Committee ishte komisioni i zgjedhur i Senatit të SHBA-së në vitet 1975-1976 për studimin e operacioneve shtetërore të kryera nga shërbimet e inteligjencës. Ky komision mori emrin e senatorit demokrat Franc Church, përfaqësues i shtetit Idaho.

financimin ose të tjera mbështetje të drejtuesve të qeverive, partive politike, sindikatave, grupeve fetare, forcave të armatosura të një vendi tjetër, për t'i nxitur ato që të ndjekin një kurs të caktuar veprimi. Shumë afër me këtë nivel është edhe ai i veprimtarisë ekonomike, me të cilën qeveritë përdorin armën ekonomike, si shkatërrimi i të mbjellave, ndërhyrja në tregje, vënien në qarkullim të monedhave të falsifikuara, me qëllim destabilizimin e regjimit. Të dy nivelet e tjera (i katërti dhe i pesti) i operacioneve të fshehta, kanë më shumë shkallë dhune dhe për pasojë japin më pak mundësi për t'i mohuar. Rrëzimi i qeverive me grusht shteti, niveli i katërt, është një metodë e dhunshme me të cilën ndryshon regjimi dhe ka një shkallë më të ulët mundësie për ta mohuar. Kurse operacionet paraushtarake janë shkalla më e lartë e përdorimit të dhunës në operacionet e fshehta dhe për pasojë ato ofrojnë edhe mundësinë më të ulët për ta mohuar për qeverinë që po e kryen këtë. Operacionet paraushtarake përfshijnë përdorimin e forcës, zakonisht duke përdorur elementë të armatosur vendas, që kryejnë një sulm direkt kundër qeverisë së tyre (p.sh. mbështetja që SHBA-ja i dha rebelimit të *koutrasve* në Nikaragua gjatë vitit 1980). Edhe operacionet paraushtarake mund të renditen brenda vetes, nga një shkallë e vogël aksioni, si p.sh. vrasjet, armatimi dhe trajnimi i një grupi disidentësh deri te veprimet shumë të mëdha si ka qenë edhe pushtimi i Gjirit të Derrave (Bay of Pigs) në Kubë gjatë vitit 1961. Sa më i madh operacioni ushtarak, aq më e pakët është mundësia për ta mohuar atë nga shteti që e sponsorizon.<sup>21</sup> Richard Bissel, një specialist amerikan i operacioneve të fshehta, e ka përshkruar me mjeshtëri dhe drejtpërdrejt thelbin e operacioneve sekrete: “Ajo që bëhet tepër e qartë është që ne (SHBA-ja - shënim i autorit - E. B.) jemi thellësisht të lidhur me problemet e brendshme të kombeve të tjera dhe deri sa jemi, ne bëjmë çdo përpjekje të inkurajojmë zhvillimin e komunitetit ndërkombëtar në akord me vlerat tona dhe për këtë arsye ne do të përpiqemi me qëllim të influencojmë në këto çështje. Ky argument mund të ngrihet jo për atë nëse do

---

<sup>21</sup> M. Lowenthal, vepër e cituar, fq. 157-173

të influencojmë apo jo në punët e brendshme të të tjerëve, por si do ta bëjmë atë. Diplomacia e hapur ka kufizimet e saj si një mekanizëm i politikës. Ka momente kur Fuqitë e Mëdha mund t'i realizojnë më mirë objektivat e tyre duke vepruar totalisht në mënyrë sekrete. Në të tilla raste, Fuqitë e Mëdha mund të kërkojnë të influencojnë në punët e brendshme të një kombi tjetër pa dijeninë e tij, ose pa dijeninë e komunitetit ndërkombëtar. Në këto rrethana kërkohet përdorimi i operacioneve të fshehta”.<sup>22</sup>

Pra, e thënë thjesht, jo çdo komb ka mundësi të konsiderueshme që të mbajë shërbime që kryejnë të katër funksionet e inteligjencës, por vetëm disa shtete me interesa globale i kanë këto mundësi. Inteligjenca është krijuar për të mbrojtur shtetin nga armiqtë potencialë nga shtetet e tjera, nga aktorët e tjerë jo shtetërorë, duke marrë në konsideratë që këto vende i kanë të gjitha instrumentet që i përmendëm. Çdo vend është i ndërgjegjshëm për shkallën dhe mundësitë e inteligjencës së vendeve të tjera gjithashtu janë të ndërgjegjshëm se edhe vetë ato do të përfshihen në këtë proces si objekt i mbledhjes së informacionit apo dhe në raste të veçanta i operacioneve të fshehta.

## II. Inteligjenca e sigurisë dhe kundërinteligjenca e shtetit

Pothuajse në të gjitha regjimet autoritare (duke përfshirë edhe ish-bllokun sovjetik) aparati i inteligjencës ka qenë një mjet kryesor për mbajtjen e pushtetit. Në vendet me regjime ushtarake, shërbimet e inteligjencës ishin të vendosura direkt nën kontrollin ushtarak, ndërsa në shtetet ish-komuniste, aparati i inteligjencës ishte një përzjerje e shërbimeve ushtarake dhe civile.

Në studimin e Kieran Williams dhe Dennis Deletant për tre shërbime të inteligjencës së shteteve ish-komuniste të Europës Qendrore (të Republikave Çeke, Sllovake e Rumune)

---

<sup>22</sup> Richard M. Bissell Jr., with Jonathan E. Lewis and Frances T. Pudlo, *Reflection of a Cold Warrior: From Jalta to the Pigs* (New Haven, CT: Yale University Press, 1996), fq. 216.

rezulton se këto shtete kishin një demokraci të re e të pakonsoliduar. Ato, si demokraci të reja, ishin shoqëri të shartuara e që vuanin akoma nga mungesa e besimit tek institucionet e shtetit në përgjithësi dhe te shërbimet e inteligjencës në veçanti. Reformat në sektorin e inteligjencës kanë qenë të vështira jo vetëm për arsye të një mosbesimi të gjerë të popullit ndaj këtyre shërbimeve, por edhe të problemeve të tjera si p.sh. politizimit të burokracisë, të mungesës së kulturës demokratike të bashkësisë dhe të një tradite të tillë në sektorin publik. Veç kësaj, shtetet ish-komuniste të Europës, të dominuara për një kohë të gjatë nga Bashkimi Sovjetik ose kultura bolshevike, kishin pak eksperiencë në vlerësimin e kërcënimeve të jashtme dhe renditjen e tyre sipas rëndësisë së nevojave të sigurisë kombëtare.<sup>23</sup> Studimi ynë tregon që këto pengesa gjatë reformës në sektorin e inteligjencës nuk janë unike vetëm për vendet e Europës ish-komuniste, por janë me nivele të ndryshme e pothuajse të ngjashme te shumica e demokracive të reja që ndërtohen pas sistemeve autokratike. Sfida kryesore për demokracitë e reja është transformimi i institucioneve duke përfshirë edhe sistemin ligjor e aktet e tjera nënligjore të regjimeve autokratike për krijimin e institucioneve të reja, të cilat duhet të mbështesin regjimin e ri demokratik dhe të operojnë nën kontrollin demokratik civil. Në këtë vështrim, sfida është e njëjtë si te shumica e sfidave të përgjithshme të marrëdhënieve civilo-ushtarake në demokracitë e stabilizuara.

Në vendet e stabilizuara demokratike, si janë SHBA dhe Britania e Madhe, shërbimet e inteligjencës kombëtare ekzistojnë për një qëllim: të informojnë dhe mbështesin drejtuesit në bërjen e politikës së jashtme, pra roli më esencial i tyre është që të zbulojnë qëllimet dhe mundësitë e kombeve kundërshtarë dhe të paralajmërojnë për këto kërcënime potenciale lidhshme. Në të vërtetë të gjitha këto shërbime merren me probleme të strategjisë dhe pjesa e luanit e resurseve njerëzore dhe aseteve të tyre është e fokusuar në aftësitë dhe

---

<sup>23</sup> Kieran Williams and Dennis Deletant, *Security Intelligence Services in New Democracies: The Czech Republic, Slovakia and Romania* (London: Palgrave, 2001), fq. 226-227.

vlerësimin e kërcënimeve, duke mbështetur zhvillimin e planeve dhe duke identifikuar problemet emergjente që influencojnë në planifikimin afatgjatë dhe në atë të mjedisit strategjik. Kundërinteligenca duket qartë që është një mision i dorës së dytë në shërbimet e inteligjencës, si ushtarake ashtu dhe civile. Shërbimi i brendshëm i inteligjencës së sigurisë është një funksion në shkallën më të madhe “kryesisht politik” dhe në shumicën e demokracive moderne, ky shërbim është i vendosur në një agjenci civile të ndarë nga shërbimi i inteligjencës si p.sh. në SHBA, Byroja Federale e Investigimit (FBI),<sup>24</sup> ose Shërbimi Sekret (MI5) në Mbretërinë e Bashkuar.<sup>25</sup>

Ndërsa në regjimet autoritare kemi një mbivendosje të misionit dhe të funksioneve të shërbimeve të inteligjencës, civile apo ushtarake, me të shërbimeve të policisë dhe që i bën ato të padallueshme nga njëri-tjetri. Kjo ndodh se regjimet autoritare janë ndërtuar dhe bazohen jo në zgjedhje të lira. Ato kanë nevojë që të mbështeten në shërbimet e sigurisë për të identifikuar kundërshtarët e mundshëm politikë, neutralizuar opozitën si dhe kërkojnë me mjete të ndryshme duke përfshirë edhe kontrollin mbi median, që të prodhojnë së paku një apati në popull. Në shumicën e rasteve, këto shërbime e realizojnë këtë detyrë të kërkuar nga regjimi. Për këtë besnikëri të verbër dhe vartësi të drejtpërdrejtë nga pushteti, aparati i inteligjencës rritet si numër dhe në influencë e për pasojë ai bëhet shumë i fuqishëm. Në këto regjime jo demokratike, inteligenca ka kuptimin e kundërinteligençës ose të një shërbimi sigurie. Misioni i tyre është të mbrojnë shtetin dhe sekretet e tij nga personat e huaj dhe me këta të fundit, ata nënkuptojnë çdo individ që është jashtë bërthamës së pushtetit të tyre. Kjo është arsyeja që diktaturat e konsiderojnë pothuajse çdo gjë çështje sekrete shtetërore e të lidhura me sigurinë kombëtare duke rritur në një masë shumë të madhe objektin e kontrollit. Për pasojë, shërbimet e inteligjencës e lidhin ose e quajnë opozitën e brendshme në

---

<sup>24</sup> Jeffrey Richelson, vepër e cituar, fq. 141-143

<sup>25</sup> Michael Herman, *Intelligence Power in Peace and War* (Cambridge & New York: Cambridge University Press, 1996), fq. 31-32-48.

mënyrë retorike “armik të jashtëm” që cenon sigurinë kombëtare dhe fokusojnë pothuajse të gjithë veprimtarinë e tyre ndaj saj dhe jo ndaj kërcënimeve reale të jashtme.<sup>26</sup>

Në kuptim të përgjithshëm, shërbimet e inteligjencës së sigurisë funksionojnë më shumë si një “polici politike” se sa si një shërbim i brendshëm inteligjence, i ngjashëm me atë të një shteti demokratik. Për këtë arsye këto shërbime shtojnë influencën e tyre në kohë duke fituar një autonomi edhe më të madhe nga kontrolli administrativ dhe njëkohësisht janë të shkëputura pothuajse tërësisht nga kontrolli legjislativ dhe juridik. Këto shërbime kanë prirje që të varen dhe të japin llogari direkte te pushteti në fuqi, i cili u ngarkon misionin dhe detyrat që duhet të kryejnë duke zvogëluar deri në zhdukje mandatin e tyre ligjor. Ndërsa ato bëhen përgjegjëse vetëm përpara regjimit në fuqi e në këtë mënyrë përpiqen të përfitojnë autoritetin nga ai, si dhe për të rritur në mënyrë abuzive pushtetin dhe kompetencat e tyre. Pashmangshmërisht ato grumbullojnë informacione të karakterit politik për veprimtarinë e një numri shumë të madh njerëzish dhe e lidhin zakonisht me ndonjë figurë penale krimi politik. Pra, këto shërbime bëhen mjete me të cilin regjimet autokratike ushtrojnë veprimet e tyre agresive kundër opozitës në vend. Në disa raste, si p.sh. në Afrikën e Jugut, gjatë periudhës së drejtimit të presidentin F. W. de Klerk, shërbimi i inteligjencës ushtarake përngjante me atë që W. W. Keller dhe Peter Gill e kanë quajtur “shtet brenda shtetit”. Kjo formë ekstreme e një shërbimi sigurie është e karakterizuar prej pothuajse një mungese totale kontrolli nga organet e tjera shtetërore për veprimtarinë e tij. Ky model shërbimi ndryshon nga shërbimet e quajtura “polici politike” sepse ai i përcakton vetë objektivat dhe axhendën, të cilat edhe mund të mos koincidojnë me ato të drejtuesve të regjimit. Si financimet ashtu dhe politikat e tyre mbeten të fshehta nga pjesa tjetër e procesit të politikëbërjes dhe në këtë mënyrë këto shërbime përzgjedhin individët që do të survejojnë si dhe masat që do të merren ndaj tyre.<sup>27</sup>

<sup>26</sup> John J. Dziak, “*Chekisty: A History of the KGB*” (Lexington, MA: Lexington Books, 1988), fq. 1-2.

<sup>27</sup> Peter Gill, vepër e cituar, fq. 60-61.

Në pamje të jashtme, regjimet autokratike përpiqen që në rastin më të mirë të duken si një demokraci formale. Por edhe në këto raste legjitimiteti i regjimit i tyre është në pikëpyetje, sepse të drejtat e njeriut janë të kufizuara dhe konflikti politik i brendshëm kthehet në ushtarak. Për rrjedhojë, shërbimet e inteligjencës së sigurisë, si një nga organet kryesore të ushtrimit të dhunës nga ana e pushtetit e lidhin veprimtarinë e tyre me ushtrinë, madje në disa raste ato vihen edhe nën kontrollin e FA-së duke marrë një fuqi shumë më të madhe. Historia ka treguar se shumica e regjimeve autokratike mbështeten në një polici politike ushtarake si për mbledhjen e informacionit ashtu edhe për t'u ruajtur nga kërcënimet e brendshme dhe kryesisht nga opozita.

Duke marrë këtë formë ekstreme, një regjim autokratik, shqetësohet akoma më shumë për kërcënimet që ka për pushtetin e tij politik si ato reale ashtu edhe ato imagjinare. Për pasojë, ai zhvillon një formë tjetër pushteti, atë të një shteti totalitar ku ushtria dhe strukturat e inteligjencës së sigurisë dominojnë mbi organet e tjera, ku veprimtaritë politike vihen nën kontroll, opozita del jashtë ligjit dhe regjimi që drejton ruan pushtetin mbi popullin e tij me masa të jashtëligjshme, pra me ushtrimin e dhunës dhe terrorit. Klasa në pushtet bëhet gjithnjë e më shumë paranojake për kërcënimet e brendshme, për këtë ajo i jep më shumë pushtet ushtrisë dhe aparatit të sigurisë, duke e çuar atë në një lindje të një shteti sigurie brenda shtetit.

Qartë, një shtet sigurie brenda shtetit është totalisht i papajtueshëm me natyrën e demokracisë moderne. Në një shtet demokratik, politikëbërësit balancojnë kërkesat për nevoja në fushën e sigurisë me mirëqenien sociale të pritshme, duke kërkuar atë që ushtria, policia dhe shërbimet e inteligjencës të jenë subjekte të kontrollit civil. Vetë qeveria jep llogari tek institucionet e tjera të shtetit demokratik. Demokracitë e konsoliduara janë të afta të mbajnë nën kontroll të rreptë demokratik shërbimet e tyre të inteligjencës. Megjithatë, në qoftë se një qeveri preokupohet më shumë për perceptimet, për kërcënimet e brendshme, si p.sh. terrorizmi ose revoltat kundër shtetit, ajo ka një tendencë të vërë në plan të parë më



shumë problemet e sigurisë kombëtare mbi ato të politikave ekonomike e për rrjedhojë krijon parakushtet për lindjen e një shërbimi të sigurisë më shumë autonom dhe më pak të varur nga shtetit. Në demokracitë e reja, aty ku institucionet janë të sapongritura dhe ende në fazën e krijimit të tyre, bëhen veçanërisht vulnerabile nga ky lloj deformimi.

### III. Sfidat e konsolidimit demokratik

“Konsolidimi” është një koncept i njohur nga të gjithë në shkencat politike dhe është i vlefshëm sepse ai reflekton idenë që proceset e ndërtimit të strukturës të pushtetit të ri janë duke u bërë të qëndrueshme. Duhet thënë se një regjim demokratik është i konsoliduar atëherë kur elita e tij politike dhe masat e pranojnë atë “si e vetmja lojë në fushë” dhe mbështesin institucionet e tij.<sup>28</sup> Ky pranim nuk është një punë e lehtë, veçanërisht nëse ne marrim në konsideratë se çfarë karakteristikash esenciale një regjim duhet të ketë, me qëllim që të jetë demokratik. Ndërsa Philippe C. Schmitter e Terry Lynn Karl, me konceptin e demokracisë bashkëkohore përcaktojnë: “Një demokraci politike moderne është një sistem qeverisjeje në të cilin sundimtarët japin llogari për veprimet e tyre te qytetarët, duke vepruar indirekt nëpërmjet konkurrencës dhe bashkëveprimit me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur”.<sup>29</sup>

Në demokracitë e reja, aparati i inteligjencës së regjimit të shkuar është jo shumë i gatshëm të vendoset nën kontrollin demokratik të qeverisë dhe nga ana tjetër ose ruan të njëjtin pushtet mbi zyrtarët civilë ose vepron akoma në bazë të planeve të tij. Kjo duket qartë, p.sh. në Peru, nën drejtimin e presidentit Alberto Fujimori dhe në Afrikën e Jugut gjatë periudhës së

---

<sup>28</sup> Juan J. Linz and Alfred Stepan, “Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America and Post-Communist Europe” (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1993), fq. 5-6.

<sup>29</sup> Philippe C. Schmitter and Terry Lynn Karl, “What Democracy is ... and is Not” in *The Global Resurgence of Democracy*, ed. Larry Diamond and Marc F. Plattner ( Baltimore : Johns Hopkins University Press), fq. 40.

presidencës së De Klerk. E parë në tërësi ky është një problem që qëndron në shumicën e këtyre vendeve që janë në hapat e parë të demokracisë. Në qoftë se qeveritë demokratike të zgjedhura nuk i kontrollojnë strukturat e inteligjencës, do të thotë se ato nuk janë demokraci të konsoliduara, sepse konsolidimi demokratik kërkon, si ngritjen e shërbimeve të inteligjencës ashtu edhe kontrollin demokratik të tyre. Ligjshmëria është thelbësore në kontrollin demokratik. Në qoftë se një qeveri është monitoruar ose e kërcënuar nga shërbimet e inteligjencës, për pasojë, përfaqësuesit e zgjedhur do të dyshonin në legjitimitetin e demokracisë, kurse besimi i qytetarëve tek institucionet e demokracisë do të dëmtohej. Konsolidimi demokratik është një sfidë shumë e madhe për demokraci të reja e çdo handikap, veçanërisht mungesa e ligjshmërisë, është një pengesë e vështirë për t'u kaluar.

#### IV. Shërbimet e inteligjencës dhe demokracia

Të gjitha shtetet i mbajnë aparatet e tyre të inteligjencës për interesat e tyre kombëtare si dhe me një aftësi të caktuar. Një pyetje që ngrihet për demokracitë e reja është se për çfarë lloj strukture inteligjence ato kanë nevojë dhe si mund të kontrollohen ato? Për këto demokraci sfida është e qartë: kontrolli demokratik i inteligjencës. Ky kontroll është subjekt i një debati të gjerë së paku për katër arsye:

Së pari, si pohon është Pat Holt, “sekreti është një armik i demokracisë”<sup>30</sup> kjo për arsye se fshehtësia inkurajon abuzimin. Në qoftë se ka një veprim të fshehtë, si mund të ketë pastaj dhënie llogarie për të, pra, të veprjës mekanizmi i kontrollit demokratik, e veçanërisht kur të dy, si furnizuesi po ashtu edhe përdoruesi i fundit i informacionit sekret kanë përfitime reciproke nga përjashtimi i mbikëqyrjes. Për arsyen se shërbimet inteligjente veprojnë në fshehtësi, ato i shmangen shumë parimit “checks and balance” në të cilin demokracia është bazuar.

---

<sup>30</sup> Pat M. Holt, *Secret Intelligence and Public Policy. A Dilemma of Democracy* (Washington D.C.: CQ Press 1995), fq. 1-3.

Së dyti, agjencitë e inteligjencës mbledhin dhe analizojnë informacione, dhe informacioni do të thotë pushtet.<sup>31</sup> Zyrtarë të lartë në organizatat e inteligjencës kanë mundësinë ta përdorin aksesin tek informacioni i klasifikuar për të caktuar kërkesat dhe qëllimet në interes të tyre, duke përfshirë edhe përfitimet e “miqve” të tyre në qeveri. Në këtë mënyrë strukturat e inteligjencës mund të bëhen autonome nga kontrolli i shtetit nëpërmjet përdorimit të informacionit që të tjerët nuk e disponojnë, madje mund edhe të përcaktojnë politikën e shtetit.

Së treti, shërbimet e inteligjencës në mënyrë rutinore thyejnë ligjet e shtetit tjetër ku ata veprojnë, pra spiunimi është një aktivitet ilegal kudo. Oficerët e shërbimeve të inteligjencës, rregullisht nxjerrin fonde për të paguar në mënyrë të fshehtë: a) shtetas të huaj për të vepruar si agjentë, b) përgjojnë telefonat, c) vjedhin dokumentacion, veprime këto që janë të gjitha kundër ligjit. Në shumicën e rasteve, operativët nuk pranojnë se kush janë në realitet dhe për cilën organizatë punojnë, pra qëndrojnë ilegalë. Kjo kulturë, ku këta inspektorë janë të paguar që të operojnë jashtë ligjeve dhe pa u ndëshkuar, mund krijojë problem për mosbërjen e dallimit nga thyerja e ligjit jashtë vendit me atë të thyerjes në vendin e tij.

Së katërti, oficerët e shërbimeve të inteligjencës gjithmonë pretendojnë se puna e tyre është shumë e rëndësishme për mbrojtjen e vendit. Ata lehtësisht mundet të zhvillojnë perceptimin se e njohin më mirë se kushdo tjetër çfarë ndodh jashtë vendit dhe sa i rrezikshëm është ky kërcënim, pra kanë mundësinë që të njohim informacione që të tjerët nuk e kanë këtë mundësi. Ky fakt i kombinuar me “licencën” *de facto* për të operuar jashtë rregullave të shoqërisë, lehtësisht mundet t’i çojë ata në një ndjenjë mbivlerësimi për vetveten dhe punën e tyre, madje mund të çojë deri në një sjellje armiqësore ndaj atyre që nuk janë anëtarë të këtyre shërbimeve. (*vijon në numrin e ardhshëm*)

---

<sup>31</sup> Robert Jervis, “Intelligence, Civil-Intelligence Relations, and Democracy” in *Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness*, ed. Thomas C. Bruneau and Steven C. Boraz (Austin: University of Texas Press, 2007), fq. 7.

## ENGLISH SUMMARY

**Enri Hide**INTERNATIONAL TERRORISM  
AND EUROPEAN SECURITY

Terrorism does not consist in a new phenomenon and notably the European countries are not unconscious for the terrorism activities. Not going far in time, it is sufficient to mention that in the past European countries have sheltered various internal terrorism organizations. But terrorism of the “left extreme”, which have caused a continuous headache for the political and diplomatic chancelleries of the West Europe countries during the 1970-'80, has not shown signs of revival, except some left terrorists organizations in Greece the last months, which violence was revived in the political scene after the turbulence in the capital of this country almost one year ago. This means that this category of violence almost has been neutralized. On the other hand, during the 20<sup>th</sup> century in Europe (especially after the Second World War) emerged other forms of violence which have been considered (by the respective countries) form of terrorism. They were exercised by separatist groups or those related to national liberations groups, like Basque in Spain and IRA [Irish Republican Army].

However, terrorist attacks in Madrid (March 11<sup>th</sup> 2004) and in London (July 7<sup>th</sup> 2005) have pointed out a threat old but also new at the same time in its nature, and with striking capacities in each corner of the globe, by bringing European security issues toward new pathways. European institutional structures have admitted the fact of internationalization of terrorist violence that is why they have enforced coordination

among them. But, as the security environment can not be clearly defined, the “enemy” remains an abstract phenomenon which sometimes involves even economical refuges that overflow European countries (or at least pretend forces and fixed security structures.)

**Barry J. Ryan**

**THE EU'S EMERGENT SECURITY-FIRST AGENDA:  
SECURING ALBANIA AND MONTENEGRO**

This article forms a critique of security sector reforms implemented in Albania and Montenegro between 2000 and 2007 by and on behalf of the European Union. It argues that within these reforms it is possible to discern a tension between a more holistic development approach and a security-based approach that is top-down and largely founded on the self-referential security concerns of the European Union. Drawing on research conducted by the author in Albania and Montenegro, the article utilizes public surveys to point out the distance between internal security reforms funded by the EU and the everyday security concerns of residents living in ineffectively policed states. The article concludes that a security-first agenda has slipped into the EU's aim to create an area of 'freedom, security and justice'. Thus, while the rims of the Western Balkans are being secured, lack of reform in the interior hampers the socio-economic development and democratization of states engaged in the EU enlargement process.

**Ilir Kalemaj**

**EU DISCOURSE IN ELECTORATE POLITICS:  
THE PERCEIVED THREAT OF ALBANIAN  
ORGANIZED CRIME AND THE EUROPEANIZATION  
OF ALBANIAN ELITE**

The organized crime in and from the Western Balkans has become a threatening problem for the European Union. The EU view on organized crime is that it poses a “major threat to internal security and the democratic process.”<sup>1</sup> Subsequent reports, threat assessments and statements addressing this threat have arisen in several occasions from various EU officials. This paper deals primarily with how the Albanian organized crime threat, in tandem with related phenomena, such as corruption of Albanian officials and the risk of ‘state capture’ has shaped the EU rhetoric toward Albania and how the Albanian elite has counter-reacted. In other words, how has Albania internalized the EU discourse and how this has impacted Albania’s electorate politics and public debate?

The main argument that this paper elaborates is that organized crime threat discourse is purposefully conceptualized in a stereotypical fashion, giving an ethnic embedded to the crime, so that the EU can maintain its normative cohesiveness, notwithstanding a distance from an objective reality that this discourse has produced. Seen in this perspective, the article seeks to emphasize several substantial misconceptions that the EU annual analyses, which empirically measure the level of crime and corruption in Albania, essentially have. The paper takes a critical viewpoint in this double rhetoric that goes both ways and seeks to pinpoint at perceptions and misperceptions that this process of ‘internalization’ of EU in the Albanian domestic sphere has produced. This “Western” discourse has reproduced a boomerang effect, where the Albanian political elites articulate

---

<sup>1</sup> The EU’s response to Organized Crime. Taken from: C:\Documents and Settings\new user\Desktop\Org. crime\_files\The EU’s Response To Organized Crime.mht, (12 March 2007).

the same critical negating rhetorical discourse, treating crime, Mafia and corruption as the biggest problem that country faces, although this does not correspond to the reality that the majority of the Albanian population percept.<sup>2</sup>

This essay is composed of four main parts. First, the paper starts with a general overview of the Europeanization literature, most specifically looking at the diffusion of ideas and internalization of EU norms, values and political rhetoric from countries that aspire to be part of the Union, specifically at Albania. Second, it focuses particularly on the role of the perceived threat from Albanian Organized Crime.<sup>3</sup> In this regard, it analyses the EU discourse, as embedded in various reports to Albania's main problems and/or obstacles in its path to European integration. It mainly focuses on primary sources, like threat assessment reports from Europol and statements from the European Union Council which serve as guidelines that lead to the subsequent EU actions. Third, it discusses the EU policies and strategy to deal with this threat. Fourth, the paper aims at analyzing public perceptions of societal and political Albanian elites<sup>4</sup> in relation to the European rhetoric of the threat that Albanian organized crime poses. The methodology focuses on discourse analysis and an epistemological and ontological treatment of primary and secondary sources to the effects of EU rhetoric in the domestic politics of Albania.

---

<sup>2</sup> For the main problems of Albanian electorates, see Table 2, at Blendi Kajsii, *Integration as an obstacle for democratization* Polis 2, (Tiranë, 2006), p.16. Empirical evidence shows that the main concern of Albanian population are unemployment, infrastructure, wages and pensions.

<sup>3</sup> I use the 'Ethnic Albanian' term in this paper to refer to Albanians in general, cutting across state borders, in a similar fashion with the threat assessment reports of Europol and other official documents that used the same connotation. Nevertheless, it is my understanding that this term is mostly used to refer to the Albanians outside the Albanian state, because of historical, linguistic and other implications.

<sup>4</sup> Since the EU documents often refer to 'ethnic Albanian' danger, without any distinction, as pointed out above, the essay looks both on Albania proper and Kosovo domestic sphere, to analyze the Europeanization of the public debate.

**Florina Cristiana (Cris) Matei****COMBATING TERRORISM AND ORGANIZED CRIME:  
SOUTH EASTERN EUROPE COLLECTIVE APPROACHES**

The end of the Cold War triggered an inexorable bloom of democracy and freedom in a multifarious and perilous security environment. Post-Cold War security challenges and threats no longer come from organized, hierarchical state actors, but rather from non-state, easily adaptable, network-centric groups and organizations (such as terrorist, organized crime (OC), money laundering and human trafficking groups), which have progressively succeeded in altering the traditional geographic borders between countries, as well as between domestic and foreign threats. The breakup of Yugoslavia in the early 1990s and the terrorist attacks in the US (2001), Turkey (2003), Spain (2004) and London (2005), etc. have clearly illustrated how instability and war involving failing states, on the one hand, or specific ideologies and religious convictions of small groups of people (yet very well prepared and organized), on the other hand, can impact the peace and security of an entire region or continent.

These developments have prompted governments and nations to investigate the dynamics of networked decision-making and adopt a more network-like behavior in order to better understand and tackle terrorism and organized crime networks.<sup>1</sup> In addition, nations have deepened cooperation with countries with common and shared security goals by establishing “interagency cooperation” tools and mechanisms, developing and consolidating “partnerships”, and joining various “collective/cooperative security” organizations and alliances.

South Eastern Europe (SEE) is no stranger to terrorism and organized crime. These menaces, along with poverty, political instability, corruption, isolation of minorities, pandemic disease, natural disasters and others, shape the spectrum of security threats to the South Eastern European region. In their search for effective responses, nations have



gradually developed an array of bilateral, subregional and regional cooperation mechanisms and/or joined existing international cooperative organizations and alliances. One question remains: with all these instruments in place, has SEE shifted from the “Powder Keg of Europe” to a stable, terrorism- and organized crime-free region? This paper investigates South Eastern Europe’s developments with regard to combating terrorism and organized crime cooperation.

### **Jonida Hoxha**

#### **BALKAN ORGANIZED CRIME AS A MAJOR SECURITY THREAT TO THE EUROPIAN UNION**

“As the worldwide shifted in social and political alliances which have expanded the possibilities for global peace and economic activity, paradoxically also opened up new opportunities for international organized crime groups. The threat from drug trafficking, trafficking in human beings and economic crimes (such as theft of intellectual property, industrial espionage, black marketeering, product counterfeiting, and computer-related crime) is increasingly recognized as a matter of national security for almost every country. International organized criminals are not motivated by ideology; they are motivated by the same thing that has motivated traditional organized criminals over history; money. Kosovo Albanian, Serbian, Bosnian and Croatian drug smugglers are happy to work together, as well as Afghan heroin manufacturers and as with Western European distributors... Human traffickers in the Balkans also operate at minimum risk but much of the success of organized crime groups in the region results from the large numbers of willing partners within the government, including members of the police, customs, border guards and the political class... The prospect of the EU membership is also the single major unifying factor in the Balkans, and it represents a powerful leverage for the much needed reforms. But the EU must lead the way and

clearly define its goals and its means. In other words, the EU and its allies need to launch an offensive against the organized crime in the Balkans. The political criteria of Copenhagen, Democracy, Rule of Law, Human Rights and Respect for Minorities, are not enough and this offensive needs to simultaneously address these fronts”.

### **Michael Healey**

#### **“MILITARY MAN”, SOCIETY AND CIVIL-MILITARY RELATIONS THEORY: A REVIEW**

This article has as the main focus the theory of civil-military relations at its most basic level the theory examines the relationship between political and military leadership. At its core, it seeks to answer three fundamental questions regarding:

1) the inherent nature of the military profession and officer corps in society;

2) the optimal balance of political and military power in the decision-making process and;

3) the relative effects of external and internal factors in shaping the balance of civil and military power.

This article provides a review of the extant literature relating to the disagreements over these central questions and assesses the validity of the various arguments by focusing in different academics which have been focused on the civil-military relations such as Huntington, Lasswell, Cohen, Snyder and Posen, Andreski, ect.

### **Eduart Bala**

#### **REFORMING AND CONTROLLING THE INTELLIGENCE SERVICES IN NEW DEMOCRACIES**

This paper will focus on analyzing the challenges of the reforming and controlling the intelligence services in new

democratic states. It also sees this process as a subset of the civil-military relations realm. The problems around these issues are not only to the legacy of prior non-democratic regimes, in which intelligence or security services were a key element of control and where the human right abuses were often allowed, but also to the inherent tension between the intelligence services and the democratic states and especially in the new ones. In this study we pay attention to the problems that unreformed intelligence organizations left over from previous non democratic states can influence and undermine efforts to democratize the governmental institutions. Meanwhile the paper emphasizes the importance of professionalism of intelligence officers and their functions as a means to mitigate those dangers.

The new democratic societies should not wait for better conditions to vigorously consolidate the reform of the intelligence and the system for controlling, directing and coordinating these services. The intelligence reform on one hand will improve the mechanisms of accountability and control, as well as legislative and judicial oversight over intelligence and security services working under the rule of law, and accelerate the process of integration in new world. In the other hand it would reflect the western standards of transparency and accountability in a modern democracy, but also the efforts of the intelligence and security domain for combating new threats. In this difficult work and without a clear scheme as how to do it, the experience of the consolidated democratic states that have achieved this objective is useful.

INSTITUTI PËR DEMOKRACI DHE NDËRMJETËSIM  
ÇËSHITJE TË SIGURISË - 14

---

Formati: 15.5x24 cm  
Shtypur në Shtypshkronjën TOENA  
Tel: + 355 4 240116  
Tiranë, 2009

